HISTORI
E
SHQIPERISE

BKSH

BKSH

BKSH

Dhuruar prej

Hassan Qerim Ismailit

për Bjelmenin

Shqipetare

Bibliotekës Herbert

Tiranë 25/7/39

H. Ismail

BKSH

BKSH

BOTIME TE FEDERATES
PANSHQIPTARE "VATRA"

HISTORI
E
SHQIPERISE

Prej
M. A. ÇEKREZIT

BOSTON
Shtypshkronja e DIELLIT
1920

BKSH

BKSH

PARETHENIE

Sot po u jap shkóllave shqip historin' e shkurter po te plote te Shqiperise qe ne kóherat e vjetra gjer ne diten e çpalljes s' independences se Shqiperise. Mé tej se ajó dite s' eshte gje e urte qe te veje njerin, se mejtimet e kujtimet e kohes se sotme jane shume here te perzjera me ndjenja qe s' kane pjese ne historin' e vertete, mé teper ne historine q' u dishet mosnar djemve e çúpave te shkóllave te vogla.

Nga pikepamja e lendes, dhe e sistemit te perdorur, kjó libre eshte krejt e ré dhe origjinale. Nga pikepamja e lendes do te them vetem qe kjó histori ka mé teper lende se çdo tjater qe ka dale gjer sot. Historine time te mepárshme, te botuar me 1915, s' dua t'a ze ne goje, se s' ka monjé vlere, per shume arsye. Nga historit' e tjera, e vétema qe mund te quhet histori eshte "Historia e Shqypnies", prej D. N. Nikajt, botuar ne Shkodre, me 1917, ka mjaft lende, ndofta mé teper se kjó histori, po ajó lende u detyrohet hollesive qe s' kane vent ne nje histori te shkurter.

Dykó putur parasysh qellimin e kesáj libre shkollare, nemundova mjaft kohe qe te gjenja nje sistém te kenaqshem, e mé ne funt vendosa qe te vinj pas sistemit te historianit frenk "*La Deuxiéme année d' Histoire de France*", per femije qe ne 11 gjer me 13 vjetsh. Nga ný mora shembell kur vendosa qe te ve, ne funt te çdo kaptine, nje permbledhje qe te mesohet me goje dhe pyetje per sherbimje. Kjó permbledhje e ató pyetje per sherbimje jane édhe mé te nevojshime per shkollat shqipe, po te marim ne sy qe nder neve mesónjesi ka mé teper nevoje per udhehqje se sa nxénesi.

Veç ketyre, kendónjesit e tritur do te shikojne edhé nje gjé tjater: qe ne shume vende kam qene i shtrenguar qe te largohem nga historia e Shqiperise,

dhe te merrem me historin' e disá kombeve a Shteteve te ndryshme, si, per shembell, me historin' e Romes, me até te Venetise, me Kryqesatat, me Feudalismin dhe me te tjera. Ky largim dhe ató shpjegime qe jap per historin' e kombeve te tjere jane teper te nevojshime per te kuptuar mire ngjarjet qe perkasin Shqiperine, se pa ditur ató esht' e pamundur qe te hidhet drite mi ngjarjet e vendit tone.

Nje gje tjeter qe do te heqe verejtjen e cilitdó jane "Kendimet" ne funt pothua te çdo kaptine. Ne ketó kendime kam vene disá gjera qe jane shume te nevojshime osé t' interesaçme po qe s' munt te hyjne aqe mire ne tekstin e libres, se a jane hollesi a jane gjera qe s' kane te bejne aqe shume me tekstin, sidó qe pa ató s' munt te kuptohet mire historia. Nje pune tjeter qe mbarojne kendimet eshte qe plotesojne, nga njera ane, historine, dhe nga ana tjater, neshtypin ne mendjen e nxénesit ngjarjet historike. Po eshte gje e kotte qe te zgjatem mé teper mi keté pike, se arrin qe kendónjesi te hedhe nje sy ne ketó kendime e do te bindet vetin per nevojen e tyre.

Nje e mete e madhe e historise shqiptare pergjitherisht eshte pashiguria e dátave dhe e vendeve, gje qe vjen nga qe historia jone s' eshte leruar prej nonje shkencetari expért, e me vjen keq te them, se ndonesé bera até qe munda, as une vete s' jam i shigurte per shume data, per shume vende. Nga ana tjeter, s' duhet harruar qe kjó barre kaqe e rende, e permbledhjes s' historise shqiptare ne forme libre per shkolla, me ra mua te parit.

Prape, nga shkaku i mungeses se nje fjalori te perdóreshme, isha i shtrenguar qe te shtronj ne funt te kesáj libre edhé nje fjalorth te shkurter.

E quanj per detyre qe te them se kam perdorur mjaft lende nga Historia e Shqypnies se D. N. Nikajt ne keté histori.

K. A. Ç.

Washington, D. C., Nentór, 1919.

TRYEZA E LENDES

PIESA E PARE

Qe ne kohcrat me te vjetra gjer me 167 perp. Kr.

I. CILET JANE SHQIPTARET ..... 1—14
1. Pellasget 1
2. Feja e Pellasgeve 4
3. Deget dhe fiset e Pellasgeve 6
KENDIME:
POPUJT E VJETER TE BOTES .. 11
EGJYPTIANET 11
ISRAELITET 12
GREKET A HELENET 12
II. MBRETERIT' E VJETRA TE SHQIPERISE ..... 14—22
1. Fillimi i mbreterisë s' Ilirisë 14
2. Fillimi i mbreterisë se Mollosisë 15
3. Mbreteria e Maqedonise 16
KENDIME:
FATTHENA E DODONES DHE ALEKSANDRI I MOLLOSISE ... 19
III. ILIRIA DHE MOLLOSIA PAS VDEKJES S' ALEKSANDRIT TE MATH 22—33
1. Pirua i Epirit 22
2. Teuta e Ilirisë 24
KENDIME;
PIRUA I EPIRIT 29
NJE BETEJE ANIETARE NE MES T' ILIRIANEVE E GREKEVE ... 32
IV. HYRJA E ROMANEVE NE SHQIPERI 33—45
1. Republika e Romes 33
2. Shqiperia dhe Maqedonia kunder Romes 35
3. Luftcrat e funtme dhe pushtimi i Shqiperisë prej Romanevе 37
KENDIME;
EPIR APO MOLLOSI? 40
USHTERIA ROMANE 42

PIESA E DYTË

Që më 168 përp. Kr. gjer më 1410 pas Kr.

I. SHQIPËRIA NËNË ROMANËT ..... 45—56
1. Zgjerimi i pushtimit roman dhe fillimi i perandorisë romane 45
2. Qyteteria romane në Shqipëri 48
3. Shërbimet q' i bëri Roma Shqipërisë . 50
KËNDIME:
GARDA PRETORIANE 54
JULIAN FILOSOFI 55
II. SHQIPËRIA NËNË BIZANTINËT .... 56—66
1. Ndarja dhe shkatërrimi i perandorisë romane 56
2. Shkeljet e barbarëve 57
3. Kryqëzatat 60
KËNDIME:
MESJETA 65
III. PRINCIPATAT E LIRA SHQIPTARE . 66—74
1. Despotati i Epirit 66
2. Mbretëria Shqiptare Angjevine 68
3. Familja e Balshajve 69
4. Gjin Bua Shpata 70
IV. SHQIPËRIA DHE REPUBLIKA VENETIKE ..... 74—83
1. Pushteti i Venetisë 74
2. Feudalizmi në Shqipëri 76
3. Feudalët Shqiptarë dhe Venetia 79

PIESA E TRETË

(1410-1501)

I. LUFTRAT E PARA ME TURQIT ..... 83—89
1. Shqipëria nënë sipëranësi turke 83
2. Zgjerimi i pushtimit turk 85

II. SHQIPËRIA NËNË GJERGJ KASTRIOTIN ..... 89—113
1. Në shërbim të Sulltanit 89
2. Kthimi i Skënderbeut në Shqipëri .. 91
3. Luftërat e para të Skënderbeut 94
4. Luftërat me Sulltan Mehmetin II dhe n' Itali 98
KËNDIME:
MARTESA E SKËNDERBEUT ... 107
NJË LETRË E SKËNDERBEUT PËR SULLTAN MEHMETIN II .. 109
VDEKJA E SKËNDERBEUT 112
III. LUFTËRAT E FUNTME ME TURQIT . 113—123
1. Kryezotnimi i Venetisë 113
2. Hyrja e Turqve në Shqipëri 115
3. Plotësimi i pushtimit turk 117
KËNDIME:
RRETHIMI I SHKODRËS MË 1479 . 120

PIESA E KATËRT
(1501-1878)

I. SHQIPËRIA NËNË PUSHTIMIN TURK . 123—134
1. Rrjedhjet e pushtimit 123
2. Kryengritjet kundra Turqve 125
3. Qeverimi i Shqipërisë nënë Turqinë . 128
KËNDIME:
SHQIPTARËT E ITALISË 131
USHTARË SHQIPTARË NË DHERA TË HUAJA 133
II. KRYEQEVERITARËT E LIRË TË SHQIPËRISË ..... 134—158
1. Bushtatsit e Shkodrës 135
2. Ali Pashë Tepelena 140
KËNDIME:
KARA MAHMUT PASHA 152
KËNGA E SULIOTEVE 154
VDEKJA E ALI PASHËS 154

III. RRJEDHJET E POLITIKËS
S' ALI PASHËS ..... 158—173
1. Gjendja e Turqisë 158
2. Kryengritja greke 159
3. Mbarimi i qeverimit të Bushátasve ... 161
4. Qeveritarë turq në Shqipëri 164
KËNDIME:
MEHMET ALI PASHA
I EGJYPTIT 168
SI SHPËTOJ ÇELO PICARI 170
KËNGA E GJON-LEKËS 171
KËNGA E RAPO HEKALIT 172

PJESA E PESTË
(1878-1912)

I. FILLIMI I ZGJIMIT KOMBËTAR ..... 173—185
1. Trazimet e 1875ës dhe Kongresi i
Berlinit 173
2. Formimi i Ligës së Prizrenit 175
3. Përhapja e mesimit 179
KËNDIME:
SHKRIMI I GJUHËS SHQIPE 183
II. KUSHTETA TURKE ..... 185—195
1. Mbretërimi i Sulltan Abdul Hamitit II 185
2. Shqiptarët e Turqit e Rinj 188
3. Kryengritjet e 1910ës 190
4. Lufta ballkanike dhe çpallja e lirisë .. 192

PJESA E PARË

Që në kóherat e vjetra gjer më 167 për. K.

I

CILËT JANË SHQIPTARËT

I. PELLASGËT

Sot do të nisim të mësojmë historín' e Shqipërisë, e më parë nga çdo gjë do të mësojmë cilët janë Shqiptarët, në janë t' ardhur apó vendës të Shqipërisë dhe sa kohë kanë që janë në këtë vent ku rrimë sot neve. Nuk është e vertetë se, kur na del një njerí përpara, duam të mësojmë më parë cili është, pak më von pyesim prej ç' soji është dhe pastáj duam të dimë cilet ishin gjýsherit e stërgjýsherit e tij? Kështú do të bejmë edhë me Shqiptarët, me kombin tonë, me ndryshimin që këtú nuk kemi një njerí të vetëm përpara, po një popull të tërë, pópullin tonë që përbehet prej disá miliunash. Do të mësojmë, pra, cili është dhe ç' ka qënë ky popull në të cilin jemi edhé neve brenda, cilët kanë qënë gjyshrit e stregjyshrit e këtij pópulli.

E para gjë që duhet të dimë është që stergjyshrit, nga të cilët zbresim neve Shqiptarët e sotmë, kanë qënë pópulli më i vjetër nga të gjithë popujt që gjenden sot në Ballkán, domethënë në

vendet ku rrojnë sot Greket, Serbet, Malziasit, Bullgaret, Rumanet; stergjyshrit e Shqiptárëve kanë qenë pópulli mé i vjetër nga të gjithë ketá popuj.

(Shko: Kendimin: POPUJT MË TË VJETËR TË BOTËS, faqe 11).

Po cilet ishin ketá stergjyshër të Shqiptárëve dhe sa kohë kishin që gjéndeshin në këtë vent? S' ka as njerí në botë, as libër, as shkrim që të tregonjë se kur erdhë në këtë vent stergjyshrit tanë, se ketá gjendeshin në këtë vent më parë se të dilte shkrimi, mé parë se të mësonin njerëzia të shkrúanin libra, me një fjalë atá gjéndeshin në këtë vent në një kohë që s' mbahet ment prej as njeriu. Për shumë kombe të tërë, si Grekë, Serbë, Bullgarë, Rumanë, Frenq, Inglizë, Gjermanë, dihet koha se kur ardhë në vendet ku janë sot, po për stregjyshët e Shqiptáreve s' dihet as farë, se ketá janë shumë mé të vjetër.

Të paren dije që kemi për stergjyshët tanë e kemi nga disá shkrime të vjetra, shumë të vjetra, të cilat thonë se mé tepër se tri mijë vjet më parë mbreteronte në Shkodrë një mbret i cili quhej *Hyll*. Po ç' tregón kjo fjalë kaqë e bukur, Hyll, për veshin e Shqiptarit? Nuk tregón se njérëzit që rronin n' atë vent ku mbreteronte ky mbret më emrin Hyll flisnin shqip, siç flasim edhé neve sot? Pastáj, kemi edhë një tjetër gjë në dorë. Mé tepër se tri mijë vjet më parë *Shkodra* quhej S h k o d r ë, ashtú siç quhet édhe sot. Gjith' ató shkrime të vjetra thonë se në Shqipërin' e

poshtme, ne Toskeri, nderohej si perendi prej vëndesve nje trim i vjeter, *Akileu*, te cilin ata e quanin *Shpejt*, domethene *I Shpejte*. Kjo na tregon prape q' edhé vëndesit e Shqiperise se poshtme, si edhé ata te Shqiperise se siperme, flisnin shqip.

Po cilet ishin ketá vendes te vjeter te Shqiperise qe flisnin shqip?

Shkrimet e vjetra thone se ne vendin qe quhet sot Gegeri rronin Ilirianet dhe se ne vendin qe quhet sot Toskeri rronin Pellasget. Po pak mé tutje, ató shkrime thone q' édhe Ilirianet ishin Pellasge. Me fjale te tjera, tere Shqiperia ish e ndenjur prej njérezesh qe kishin nje gjak dhe flisnin nje guhe. *Pellasget* jane, pra, stergjyshet e Shqiptáreve. Nga ana tjater, siç thame edhé mé siper, nuke dihet as fare se kur erdhe ne Shqiperi vëndesit e pare, domethene Pellasget, dhe keshtú Pellasget quhen qe jane ndénjesit e pare te Shqiperise. Dhe po t' ju pyese tani nonjé njeri ne jane vendes apó t' ardhur Shqiptaret, ç' duhet t' i pergjigji? Pa fjale, duhet t' i pergjigji qe Shqiptaret jane vendes e jo t' ardhur, se jane sterniprit e ndénjesve te pare te Shqiperise te cilet ishin Pellasget.

Po, nga ana tjeter, duhet te dini edhé nje gje: qe Shqiperia s' ish i vétemi vent i ndenjur n' até kohe prej Pellasgesh, se Pellasget ishin zgjatur edhé gjer ne Greqi dhe n' Itali. Mé von erdhe *Grekët* osë *Helenet* ne Greqi dhe Pellasget

u-trazuan me tá dhe u-bene nje; gjith' ashtú ngjau edhé n' Italí ku Pellasget u-bashkuan dhe u-bene nje me njérczit e tjerc qe vanc mé von n' até vent. Po ne Shqiperí Pellasget mbetne te patrazuar me nonjé race tjeter.

2.–Feja e Pellásgeve

Nofta ketó qe po themi ketú ju duken si pralla te vjetra, po, po t' ju behet nje pyetje do te shekoni se ketó s' jane pralla, po jane gjera te verteta. A ju ka rene nonjé here nderménd qe te pyesni persé ditet e javes quhen e *Diele*, e *Hene*, e *Marte*, e *Merkure*, e *Enjte*, e *Premte*, e *Shtune?* Persé valle? Pergjigjia eshte fare e lehte: ditet e javes quhen ashtú se ashtú i qúanin Pellasget, stergjyshrit tane. Po persé Pellasget u dhane ketó emra diteve te javes? Pergjigjia eshte prape fare e lehte: se ató emra ishin emrat e perendive qe besonin Pellasget, e per te nderuar perendit' e tyre u dhane diteve te javes emrat e tyre. Pellasget besonin qe *Dielli*, *Hena*, *Marsi*, *Merkuri*, *Enjti*, *Premtja*, dhe *Shtuni* ishin perendira.

Veç ketyre, Pellasget kishin edhé disá perendí te tjera, dhe qe t' ju kujtóuj nje nga ató do t' ju pyes se ç' farc bé bejne mé teper Shqiptaret, kur betohen per nonjé gje? Nuke thone *per Zotin?* Aý *Zot*, pra, per te cilin betóhemi edhé neve sot, s' eshte tjeter veç se aý mé i madhi i perendive ne te cilet besonin Pellasget e vjeter. Pellasget besonin, gjith' ashtú, qe *Zoti* ish i marrtuar me

njc perendeshc q' e qúanin *Erc*, e cila s' eshtc tjetcr veç se "era" qc rrethón dheuc. Pastáj, Pellasgct kishin e disá perendí tc tjerc mé tc vegjel per tc cilet besonin q' ishin si sherbetorc tc perendive mé tc medhénj. Siç shikoni, Pellasget s' ishin tc kenaqur vetem me njc perendí, siç jemi neve tc kenaqur sot, po deshin tc kishin mé shume; per Pellasget çdo gjc q' ish mé e fortc se njeriu, si era, dheu, deti, yjtc, ish pa fjalc perendí.

Nga Pellasget i muarr mé von ketó perendi odhé popujt fqinj, si Greket dhe Romanet, po mos harroni qc Pellasget ishin tc parct qc pagezuan ketó perendí me emrat qc shenuam mé siper.

Pellasget besonin qc perendít' e tyre rrinin nc majat e máleve, si nc Tomór e nc çdo tjetcr maje mali. Atjé nc majat e máleve rrinte Zoti i math, i cili, kur zemrohej per shtrembesirat qc benin njérezit e dheut, u dergonte q' andéj gjcmimet dhe rrufetc qc t' i lajmeronte tc mos benin ligesí, dhe kohc me kohc dergonte njc nga perendít' e tjera ner njérezit osé qc tc ndihmonte atá qc ishin besnikc tc mire, osé tc denonte atá qc sfleshin keq. Keshtú e bente Zoti fuqín' e tij tc njohur nc mes tc njéresve, me anc tc gjemimeve, tc shkreptimave e tc rrufeve, osé dyke derguar njc nga perendít' e tjerc, dhe per púnera tc ketilla dergohej mé teper *Merkuri*, i cili ish si lajmetár i Zotit.

Kohc me kohc, Zoti çfaqej ner njérezit dyke dalc nc Dodonc, ku Pellasget i kishin ngritur njc

tempull të math e të dëgjuar jo vetëm në Shqipëri po edhé në Maqedoní e Greqí. Shkaku që Zoti dilte atjé kohë më kohë ish se vinin njerëzia të pyesnin për fatin e tyre, me fjalë të tjera, vinin të shtinin *me fall*. Sikunder shëkoni sot që vijnë kohë më kohë Evgjitkat dhe për një copë bukë janë gatí që t' i refejnë *kesmetin* çdo njeriu q' i pyet, dyke shtënë më fall, ashtú edhé Pellasget e vjetër vinin në tëmpullin e Dodonës dhe shtinin më fall, jo n' Evgjitët, po tek Zoti vetë. Përgjígjen e merrnin nga një fetár, një prift i cili ish në shërbím të Zotit, i cili besohej që dinte se ç' kish në mendje Zoti vetë dhe u thoshi njëréstve që pyesnin, jo për një copë bukë, po për dhurata të çmúara, si desher, qé e të tjera, të cilat ia bënin *kurbán* Zotit dyke i therrur n' altarin e tij në Dodonë.

Dodona ish afer fshatit të sotmë Kastriez, dhe, për fat të keq, ky vent i shenjtë i Pellásgeve gjendet sot në duart e Grékeve.

3.—Degët dhe Fisët e Pellásgeve

Passi pamë se cilët ishin Pellasget, le të shohim tani se qysh qeveríseshin, në kishin një qeverí të vetëm apó më shumë, dhe n' ishin të bashkuar në mes të tyre.

Që të kuptoni mirë ató që do të mësoni më poshtë, duhet thënë që në krye se në kóherat e

vjetra s' kish asnjé popull osé komp qe t' ish i bashkuar, ashtú siç janc popujt dhe kombet e sotme. Me fjalc tc tjera, jo vetem qe s' kishin njc qeveri tc bashket po edhé ishin tc ndarc nc *degc* e nc *fise*.

Keshtú edhé Pellasget ishin tc ndarc nc *degc* e nc *fise*. Le tc shohim mé parc se cilat ishin *deget* nc tc cilat ndáheshin Pellasget. Ató *degc* ishin tri: dega e *Ilirianeve*, e cila rrinte nc Gegerin' e sotme, dega e *Epirótcve* dhe dega e *Maqedónasve*. Ilirianet dhe Epirotet ishin si vellezer prej njc babe dhe prej njc nene. Maqedónasit ishin si pak mé tc larkunc, le tc themi q' ishin si kusherinj tc parc me Ilirianet dhe me Epirotet.

Ketó ishin tc tri degct nc tc cilat ndáheshin Pellasget, dhe siciladó nga ketó tri dege qeverisej nc vete, me fjalc tc tjera nc kóherat e vjetra ishin tri mbreteri tc ndara: *Mbreteria e Ilirisc*, *Mbreteria e Mollosisc* osé e Epirit, dhe *Mbreteria e Maqedonisc*. Mé poshtc do tc mesojmc disá gjera mé teper per cilendó nga ketó mbreteri, po heperhé le tc shekojmc se ç' ishin *fiset*.

Fis i thonc njc togu femijesh qc janc prej njc gjaku osé zbresin nga njc stergjýsh i bashket, dhe tc cilat rrojnc sc bashku, tc lidhura nc mes tc tyré, si njc femijc e madhe. Pa fjalc qc asnjé fis s' munt tc jetc baras me njc tjeter; njc fis munt tc jetc i math, se permbléth mé teper femijc, e njc fis tjeter munt tc jetc mé i vogel se permbléth

mé pak femije. Fiset quhen sot *bajrake* ne Gegeri, dhe ne disá vise te Toskerise, si rreth Vlores, quhen *kabilé*. Cilidó prej jush ka fisin e tij i cili ka nje emer te bashket per tere femijet dhe shtepite qe jane te lidhura me até fis. Shume here godit qe nje fis permblidhet ne nje mehalle osé ne nje fshat.

Deget, pra, ne te cilat ndáheshin Pellasget, domethene *Ilirianet*, *Epirotet* dhe *Maqedónasit*, ndáheshin perseri ne *fise*. Sicilidó fis kish nje te parin, kryetár a prine, dhe qeverisej me vete, po prape ish i bindur nené mbretin e deges i se ciles ay fis ish nje pjese. Le t' a çkoqitim mé mire keté pune dyke numeruar disá nga fiset.

Ne Shqiperín' e poshtme fiset mé te njojtur ishin *Mollosianet*, *Thesprotianet*, *Kaonet*, *Athamanet*, *Dashareret*, dhe nja dhjete fise te tjere qe s' eshte nevoje t' i kujtojme nje-nga-nje. *Mollosianet*, te cilet perbenin fisin mé te forte ne Shqipeni te poshtme dhe te cilet ishin aqe te forte e te shume sa mposhtne fiset e tjera dhe mbretrit e tyre u-bene mbreter te Toskerise se tere, rrinin ne vendet qe permblidhen qe nga Gjinokastra edhé gjer ne Arte (Narte). *Thesprotianet* kishin zene vendet e anes se detit te Çamerise. *Kaonet* rrinin ne Kurveleshin e ne brigjet e Himares. *Athamanet* rrinin ne krahinen e Konitzes, dhe *Dashareret* rrinin ne krahinen e Korçes gjer ne ligenet e Prespes dhe te Ohrise.

Ilirianet ishin prape te ndare ne shume fise,

nga të cilët më të shënuar ishin *Taulantët*, të cilët rronin në krahinën e Dúrrësit dhe në fushën e Myzeqesë; Liburnët, të cilët rronin anës së detit, Ulqin, Tivar, Shkodrë; *Dardanët* (osé Dardharët), të cilët qendronin në viset e Kosovës së sotmë, gjer poshtë në Mat, Lumë, Dibrë, e shumë fise të tjerë.

Tanì, sikundër thamë mé siper, sicilidó nga këtá fise kish një farë qeverimi më vete, po, nga ana tjetër, ishin të shtrenguar që t' i bindeshin mbretit më të math t' atí vendi; me fjalë të tjera, fiset e Ilirisë ishin të shtrenguar t' i bindeshin mbretit t' Ilirisë, i cili e kish kryeqytetin e tij në Shkodrë, dhe fiset e Epirit ishin të shtrenguar që t' i bindeshin mbretit të Mollosisë, siç thamë edhé mé siper. Na mbetet tanì që të shkojmë cilët ishin këtá mbretër dhe ç' bënë.

PËRMBLEDHJE

(Të mësohet me gojë)

1. Vendosit e parë të Shqipërisë ishin Pellasgët dhe Shqiptarët janë sterniprit e tyre, e dykë qënë se Pellasgët ishin popull më i vjetër i Ballkanit, edhe Shqiptarët janë populli më i vjetër i këtij vendi. Që njerëzit e parë të Shqipërisë, do-më-thënë Pellasgët janë më të vërtetë stergjyshët e Shqiptarëve provohet nga gjuha.

2. Ditët e javës kanë emërat e sotme si për kujtim të perëndive pellasgjike, më i madhi nga të cilët ish Zoti. Pellasgët ndëronin si perëndi forcat e natyrës që janë më të fuqishme se njëriu.

3. Pellasgët besonin që perëndit' e tyre rrinin majë malëve, si në Tomor, dhe që rronin siç rronin edhe një-

rezia dhe shumë here u a benin që më parë të njoftur fatin njerëzve që vinin të pyesnin në tempullin e Dodonës.

4. Pellasgët ishin të ndarë në tri dege: *Iliriane*, *Epirote*, *Maqedonase*, dhe çilado nga ato përbente një mbretëri të veçantë.

5. Çilado nga ato dege ndahej përsëri në *fise*. *Fis* i thonë një togu familjesh që janë prej një gjaku dhe të cilat rrojnë së bashku si një familje e madhe nënë një të parë ose kryetar. Fiset e Iliris ishin nënë mbretin e Iliris, dhe fiset e Epirit ishin nënë mbretin e Mollosis.

PYETJE PËR STËRVITJE

1. Përse ishte nevoja që të mësojmë se çilët ishin stërgjyshët e Shqiptarëve?—Çili ishte populli më i vjetër në Ballkan?—Shqiptarët janë vendës apo t' ardhur?

2. Çili ish *Hylli* dhe ç' na jep të kuptojmë kjo fjalë?—Sa i vjetër është qyteti i Shkodrës?—Çili trim ndërrohej në Toskëri si përëndi me emrin *Shpejt*, dhe ç' na tregon ky emër?

3. Ilirianët dhe Pellasgët janë një popull a po dy?—Gjer ku ishin shtrirë Pellasgët?—Përse nuk janë edhe Grekët edhe Italianët prej një gjaku me Shqiptarët, dyke qenë se Pellasgët ishin të parët që zunë këto vende?

4. Shpiegoni emërat e përëndive të Pellasgëve më kuptimin e tyrë?—Përse Pellasgët kishin më tepër se një përëndi?—Ç' do të thotë fjala *tempull?*—Ç' bënej në tempullin e Dodonës, ku ish Dodona, e kush e ka tanë?

5. Në sa dege ndaheshin Pellasgët dhe çilat ishin ato dege? Maqedonasët a kishin një gjak me Ilirianët dhe Epirotët.?

6. Ç' është *fisi?*—Numëroni disa fise të Mollosisë e t' Ilirisë, dyke treguar se ku rrinin.

KËNDIME

POPUJT E VJETËR TË BOTËS—Veç Pellásgeve, gjéndeshin natyrisht në botë edhe shumë kombe të tjerë që s' i kujtón historia, se njérëzit janë të mérreshin me shkrim shumë më von. Nga këtá popuj atá që janë mé të vjetër dhe kanë historin' e tyre janë të poshtmit:

EGJYPTIANËT—Egjyptianët rrinin n' Egjyptin (Misír) e sotme dhe janë populli mé i parë i qyteterúar i botës. Ky popull qeverisej prej një sërë mbretërsh që qúheshin *Faraónj* dhe e qúanin veten e tyre *Bij të Diellit*. Pothuá se të gjithë Faraonjtë ishin luftëtarë të madhénj, dhe mé i çquári nga atí ish *Rámesi* II, i cili rronte 1400 vjet përp. Kr.

Shenjat që lanë prapa Faraonjtë janë *Pyramídat e Egjyptít*, ndërtesa nga mé të madhatë në botë. Në sicilëndó nga këtó ish varrosur edhé një Faraó. Egjyptianët besonin që kur vdes njerïu, shpirtí i tij flaturón, po kthehet mé von dhe hyn përsërí në trupin q' ish mé parë. Përandáj edhé ishin munduar gjerëá gjetnë një menyrë për të mbajtur pa tretur kufomat e njëreve të vdekur q' ashtú shpirti të muntë të kthehej kurdohërë që të desh. Shumë nga këto kufoma, të cilat taní

quhen *mumje*, janc gjendur tc patrétura édhe nc ditet tona.

Egjyptianet dinin gjith' ashtú qysh tc ndertonin pallate e tempuj; ishin tc paret qc gjetnc menyren e mbjelljes se grurit; dinin qysh tc venin, dhe gjetnc edhé menyren e shkrimit, dyke perdorur fletet e nje bime qc mbin pas lumit *Nil*, q 'eshtc lumi mé i math i Egjyptit, nc vent tc kartes. Bima quhet *papér*.

Egjyptianet ishin tc paret njeres qc zunc tc shkrûanin *historí*, domethenc tc vinin nc shkrim ngjarjet e ndryshme.

ISRAELITËT—Mé von duken edhé Israelitet ose Judenjtc, a Çifutet, tc eilet rronin tc ndarc nc *fise*, dhe nc krye tc çdo fisi ish ay mé plaku i eili quhej *patrik*. Mé i vjetri patrik qc kujtón historia eshtc *Abrahami* qc rronte 2000 perp. Kr., nip' i tc eilit ish Jakobi. Dyke qenc se nje urí e madhe kish renc nc Judé, Jakobi i shpuri njérezit e tij nc Egjýpt, ku kish plot tc ngrena. Po atjé Judenjtc rranc nc duart e Faraonjve tc eilet i perdorne si skllever, gjersá dolli *Moisiu*, i eili i shpuri pertseri nc Judé.

GREKËT A HELENËT—Mé pas nga kombet qc shenuam mé siper vijne Greket e vjeter osé Helenet tc eilet çvilluan qytetcrinc mé tc mbaruar e mé tc holle nc kóherat e vjetra. Helenet nxûarc shkrimtaret mé tc mirc, tc eilet e benc gjuhen greke mé tc mbaruar nga tere gjúherat e tjera.

Qytetet mé tc shennar tc Greqisc se vjeter

ishin *Athina* dhe *Sparta*. Nga ketó te dy, Athina esht' e degjuar per shkallen e larter ne te eilen arrijti qytetcria dhe mesimi ner ndenjesit e saj. Sparta esht' e degjuar per lavdín' e saj ushteriake. Qe te dy ketá qytete u-henger gjithmone ne mes te tyre gjersá Sparta e mundi dhe e zuri Athinen me 404 perp. Kr.

Nga te gjithe ketá popuj te vjeter i vétemi qe rron gjer sot e kesáj dite jane Israelitet, se te tjeret u-bashkuan e u-thethitne prej kombesh te tjere. Kjo eshte mé e vertete per Greket, se Greket e sotme kane te bejne vetem fare pak me atá te vjetrit. Ne kohen qe rrodhi qe kur rronin Greket e vjeter e gjer sot, Greqia u-shkel prej shume popujsh te tjere, dhe Greket e sotme kane dale nga gjaku i perzjere mé teper i Sllávéve dhe i Shqiptárve, me fare pak gjak te mbetur nga te vjetrit.

II.

MBRETERIT' E VJETRA TË SHQIPERISË

1.—Fillimi i Mbreterisë s' Ilirisë

Mbretëria e Ilirisë zgjatej në kóherat e vjetra që në Shkodrë edhe gjer në lumin Viosë, dyke përmbledhur tërë Shqipërín' e Siperme, Malin e Zi, një pjesë të Serbisë, Kosoven, Dibren dhe Shqipërín' e Mesme. Këtó ishin kufiret e zakóncshme të vendit ku mbretëronin mbréterit e Ilirisë; po kohë pas kohe, këtó kufire n-ndryshuan shumë herë, nga shkaku i luftrave të shpeshta që benin mbréterit e Shkodres për të zgjeruar mbretërín' e tyre.

Pa fjalë që s' kini haruar se mbreti i parë i Ilirisë që kujtón historia ish *Hylli*, i cili vdiq më 1225 për. Kr. Pas atí erdhe shumë mbreter, emrat e të cilëve s' eshtë aqë nevojë që t' i kujtojmë këtú.

Mbretrët e Ilirisë, emërat e të cilëve duhet t' i mbanjë mënt çdo Shqiptár, janë këtá që do të shënojmë mé poshtë:

Bardhylli (Hylli i Bardhë) që mbretërój në shékullin e katërt përpara Krishtit, eshtë një nga mbréterit mé të shënuar t' Ilirisë. Ky mbret i zgjerój kufiret e mbretërisë së tij aqë shumë sa

nε kohεn e tij Iliria zgjatej qε nga Trieshti gjer nε Toskerí, njε pjesε e madhe e sε ciles u-bashkua me mbreterine iliriane. Po shumε shpejt, Bardhylli u-godit me Maqedónasit, dhe mbreti i Maqedonise, *Filipi*, mundi tε shkeputε nga Iliria ató toka tε Maqedonisε q' ishin bashknar mé parε me Ilirinε. Tε hijt e Bardhyllit, *Kleiti* e *Glaukn*, u-mundnan mé von qε t' i merrnin prapε ató vende dhe njε luftε shumε e rreptε u-bε ner mes tε tyre e tε Aleksandrit tε Math afer *Pilurit*, nε krahinεn e Korçes. Ilirianet u-muntnε shumε keq nε keté luftε dhe u-shtrenguan qε tε bashkoheshin me Aleksandrin e Math nε luftεn qε nisi kundra Persiáneve, sikunder do tε shekoní mé poshtε.

2.—Fillimi i Mbreterisε sε Mollosisε

Prallat e vjetra thonε qε mbreteria e Mollosisε u-themelua prej Mollosit mε 1270 perpara Krishtit, do-nε-thenε ketú e 3190 vjet mé parε. Nε krye, mbreteria mollosiane permblithte vetem Mollosinet do nε thenε vendet qε zgjaten qε nga Gjinokastra nε Artε, po, sikunder thamε mé siper, mbréterit e Mollosisε u-treguan nqe tε zotεr sa vnε nε dore tere Shqiperia' e poshtme, qε nε Viosε e gjer nε Nartε.

Pas Mollosit erdhε mbreter tε tjerε, po neve do tε kujtojmε ketú vetem njε, *Aleksander Mollosin*, i cili hipi nε fron mε 342 perp. Kr. Ký mbret dubet mbajtur menτ se eshtε i pari qε u-kujtua tε

zgjeronte mbreterín' e tij me toka pertéj Adriatikut, dhe mε 337 u-hoth n' Itali, ku beri disá trimerira shume tε medhá dhe zuri njε pjesε tε madhe t' Italisε sε poshtme, gjer sa u-vra me tε pabesε prej njε Italiani pesε vjet mé von.

(Sheko kendimin: FATTHENA E DODONES DHE ALEKSANDRI I MOLLOSISε, faqe 19).

Pas vdekjes s' Aleksandrit, mbreteria e Molosisε mbet nε duart e motres sε tij, *Olimbise*, e cila eshtε nena e Aleksandrit tε Math tε Maqedonisε.

Le tε shohim tanί sε ç' behej nε Maqedoní dhe ç' púnera tε medhá nisi dhe mbarój Aleksandri i Math.

3.—Mbreteria e Maqedonisε

Ashtú si mbreterít' e Ilirisε dhe tε Mollosisε, edhé mbreteria e Maqedonisε ish themeluar qε nε kóhεrat mé tε vjetra, po nuk' kish nxjerrε nocá burra tε shenuar gjer nε shékullin e katert per. Kr., kur hipi nε fron *Filipi*, njε mbret fort i zoti dhe i mentshem. Filipi pregatiti njε ushterí tε forte dhe desh tε zinte tε tere Greqinε, dhe pasí dolli i fituar nga lufta me Greket, iu kethye Ilirisε dhe, sikunder pame mé siper, u-godit me Bardhyllin, nga i cili çkeputi krahinen e Prespes e t' Ohrisε si edhé njε pjesε tε krahines sε Korçes. Mε 356, Filipi u-marrtua me *Olimpin'* e Mollosisε, dhe disá kohε mé von, domethenε pas vdekjes s' *Aleksander Mollosit* n' Itali (332), Mollosia u-bashkua me Maqedoninε.

Po nuk shkoj shume kohe kur Filipi u-vra dhe vendin e tij si mbret i Maqedonise dhe i Mollosise e zuri i biri i tij, Alekandri i Math, i cili, siç shekoni, ish thjesht Shqiptár nga e ema, te paken. Pak mé siper pame se qysh Aleksandri i Math i mundi mbretrit e Ilirise, Kleitin dhe Glaukun, afer Pilurit te Korçes, dhe qysh i shtrengój qe te bashkoheshin me té ne luften kundra Persiáneve qe kish ndermént te niste.

Aleksandri i Math, i cili n' até kohe ish djale i ri, kish vene ndermént qe te pushtonte tere boten e keshtú nisi te mposhte fqinjet e tij mé pare qe te mos linte nocá armiq, te cilet munt t' a goditnin qe prapa ne kohen kur aÿ do te nisej per ne Persí. Me 334, Aleksandri mblodhi nje ushteri prej 35,000 shpirt, nje pjese e madhe e se ciles perbehej prej trúpave iliriane dhe mollosiane, dhe u-nis kundra Persise, e cila ahere ish Shteti m' i math ne bote. Beri tri luftra te medhá, ne *Granik*, ne *Ips* e n' *Arbele*, ne te cilat i mundi krejt Persianet dhe ne pak kohe perandoria e madhe e Persise ra e tera ne duart e tij. Aleksandri vajti edhe gjer n' Indi, po kur kethehej q' andej ne Babylone, e zune ethet dhe vdiq me 323 perp. Kr., kur nuk' ish mé teper se 33 vjetsh.

Pas vdekjes s' Aleksandrit, gjeneralet e ushterise se tij u-zune ne mes te tyre, se cilidó nga atá desh qe te zinte vendin e mbretit te vdekur, dhe leftuan njezét e pese vjet njeri me tjatrin. Atá qe s' u-vrane ne ketó luftra te gjákeshme, e

ndanc nc mes tc tyre mbreterín' e madhe qc kish themeluar Aleksandri i Math. Lafta mć e madhe nc mes tc kctyre gjeneráleve t' Aleksandrit u-bc n' *Ips* t' Asisc sc Vogel nsc 301.

PCRMBLEDHJE

(Tc mesohet nsc gojc)

1. Mbreteria iliriane zgjatej qc nga Mal i Zi edhe gjer nc Viosc, dyke marrc brenda edhe njc pjesc tc Serbisc, Kosoven, Dibren dhe Shqipcrin' e Mesme.

2. *Hylli* ish i pari mbret i Iliriscc. (1225 pcp. Kr.)

3. *Bardhylli* zgjeroj ca nc tepcr kufiret e Illirisc. (Shekulli i katrct pcrp. Kr.)

4. *Aleksandri i Math* i mundi Ilirianct *afcr Pilurit* tc Korçcs (335) dhe Ilirianct bashkohen me 'tc kundra Persiancve.

5. *Mollosi* ish i pari mbret i Mollosisc.

6. *Mollosia* pcrmblithte viset qc nc Viosc gjer nc Nartc.

7. *Aleksander Mollosi* hidhet n' Itali (337), ku gjen vdekjen nc 332. Vendin e tij e zc e motra, *Olimpia*, nena e Aleksandrit tc Math, dhe Mollosianet bashkohen nsc Aleksandrin kundra Persiancve.

8. *Aleksandri i Math*, bir i *Filipit* tc Maqedonisc, niset kundra Persiancve nc 334, mbreterin' e tc cilcve e zuri tc tcrc, nc ndihmcn e Iliriancve dhe tc Mollosiancve. Pas vdekjes sc tij (323), mbreteria e tij e madhe coptohet dhe Iliria e Mollosia çkcputen nga Maqedonia.

PYETJE PCR STCRVITJE

1. Qc kur e gjer ku zgjatej mbreteria iliriane dhe mbreteria mollosiane?—Cilat vende tc Shqipcrisc kane mbetur sot jashtc nga ato qc pcrmblithte Shqipcria e vjetcr?—Kufiret e Ilirisc dhe tc Mollosisc mbetnc gjithcnjc ato q' ishin apo u-ndryshuan nonjc herc?

2. Cili ish *Hylli?*—Cili ish *Bardhylli* dhe ç' beri—Ku u-mundue Ilirianet prej Aleksandrit te Math dhe ç' bene pastaj?

3. Cili ish Filipi dhe ç' beri Aleksandri i Math?—Ç'ngjau pas vdekjes se tij?

4. Cili ish Mollosi?— Cili ish Aleksandri Mollosi dhe ç' beri?—Cila ish Olimpia?—A kish nonje ushtrij mollosiane dhe illriane me vete Aleksandri i Math kur u-nis kunder Persise?

KËNDIME

FATTHËNA E DODONËS DHE ALEKSANDRI I MOLLOSISË—Një nga shkaket per te cilet Aleksandri i Mollosise nxitój që te hidhej që nga Epiri pertéj ne Taránt t' Italise ish se ish trembur prej nje fatthene që kish marre nga Zoti i Dodones.

Tarantinet, që gjer n' até kohe s' e kishin humbur krejt faren dhe gjakun e tyre pellasgjik, iu-drejtuan prindit te tyre, Aleksandrit te Mollosise, që t' i ndihmonte ne luften që kishin kunder fiseve te tjere t' Italise. Si pas zakonit e te vjétrve, Aleksandri vajti te pyete perendín' e Dodones se qysh do t' i vinte puna ne fushaten që kish nderménd te bente. Nga Dodona nori pergjigjen që te ruhej "nga újerat akeruasiane e nga qyteti i Pandosise, se atjé ishin kufiret e fatit tij." Keté fatthene Aleksandri e shpjegój me kuptimin që te largohej nga lumi *Akeron* e nga qyteti i Pandosise, te cilet që te dy ishin ne krahinen e Mollosise, dyke harruar që fatthenat kishin kurdohere shume kuptime, nga te cilet ay mori até

q' i erdhi më parë në mendje. E keshtú, Aleksandri vendosi që të largohej sa më shpejt nga Mollosia ku ishin të dy vendet e mallkuar që kufizonin fatin e tij, e u-hoth n' Itali.

Dyke arrijtur në Taránt, i vuri perpara armiqt' e Tarantínëve, po, dyke qenë se ish në vënt të hunj e n' até kohë s' gjéndeshin ató lehtësí që janë sot për të kapërxyer Adriatikun, lufta i vinte kur mbarë kur prapë. Një historiân román thotë se po t' i kish vajtur puna mbarë, s' kish dyshím q' Aleksandri do t' ish hedhur edhé gjer në Romë.

Sidó që të jetë, kur do të bënte luften e tij të madhe n' Itali, Aleksandri e kish ndarë ushtrín' e tij në tresh, dyke vendosur çdo copë në një brek. Po ató dit, kish rënë një shi i math, dhe újcrat e shuma e kishin bërë si det fushën që ndante njerin nga tjetri të tre brijet ku kish vendosur ushtrín' e tij, keshtú që kuntimet u-prenë në mes të trín trúpave. Dyke vënë re keté gjë, armiqt' e Aleksandrit u-sulën me rrembím kundra trupes që kumandonte vetë mbretí i Molloesë, të cilin dhe e rrethuan. Po trimi Aleksander çveshi shpatën e me disá pak njerës që mbante pas uderth përmés víjave t' armikut, shkoj nepér tá dhe arrijti perpara një lumi të vogel po i cili kish shfryrë nga újerat e shkut e s' kapërxehej lehtë. U-ndoth tanî që perkundréjt lumit ish një qytét i qúajtur *Pandosi*, dhe që atjé ku mbretí kish qendruar anës së lumit e po mejtohej se

ç' duhej tɛ bente, degjój njɛ nga ushtaret e tij qɛ po mallkonte lumin me ketô fjalɛ: "Edhé ti je i mallkuar si *Akeroni!*....." Kur i ranɛ nɛ vesh ketó fjalɛ, me njɛ herɛ Aleksandri kujtój fathenen qɛ tɛ "ruhej nga újerat akeruasiane e nga qyteti i Pandosisɛ, se atjé ishin kufiret e fatit tɛ tij."

Ç' duhej tɛ bente tani? Mbreti hyri nɛ mejtim tɛ thellɛ, po njɛ djalósh i ri qɛ mbante pas i tha qɛ s' duhej tɛ humbiste kohɛ mé teperr, se armiqtɛ po afróheshin. Aleksandri ngau kalin ahere nɛ valɛt e lumit, po kur do tɛ dilte pertéj, njɛ nga armiqtɛ e goditi me njɛ shigjetɛ dhe e rrezój nga kali. Valɛt e lumit e muarr trupin e vdékur dhe e nxuar larg.

E keshtú u-vertetua faithena e Dodones.

BKSH

III.

ILIRIA DHE MOLLOSIA PAS VDEKJES S' ALEKSANDRIT TË MATH

Një nga përfundimet e vdekjes s' Aleksandrit të Math dhe të copëtimit të mbretërisë së madhe që fillój aý ish që Iliria dhe Mollosia u-çkëputnë nga Maqedonia dhe u-bënë shtete të lira e më vete përsëri. Dhe kjo është koha kur u-dúkne në historín' e vjetër të Shqipërisë dý fytyra të shenúara e të shkelqýera, njëra në Mollosí dhe tjetra në Ilirí.

Fytyra më e çquar nga të dyja ish *Pirrua* i dëgjuar, mbret i Mollosisë dhe i Epirit.

(Shëko Kondímin: EPIR apo MOLLOSI? faqe 40).

1.—Pirrua i Epirit

Çdo Shqiptár duhet të mbahet më të math kur kujtón émërin e këtij mbreti të shkelqyer të vendit të tij, se Pirrua çuditi tërë botën me trimërín' e tij.

E para herë kur Pirrua u-çqua për trimërín' e tij ish kur mori pjesë, sidó që ish vetëm një djalósh nga mosha, në luftën e Ipsit, për të ëilën folmë më sipër.

Nga trimcrite dhe pûncrat e medhá qe beri Pirrua do te kujtojme ketú vetem disá pak.

Pirrua ish vetem dymbedhjete vjetsh kur hipi ne fronin e Mollosise me ndihmen dhe perkrahjen e mbretit t' Ilirise, i cili e kish rritur si djalin e tij qe kur ish foshnje. Nga kjo provohet se sa t' áferme ishin mbreterit t' Ilirise dhe te Mollosise, sa qe njeri mbret ndihmonte tjetrin kur gjente nonjé pengím ne mbreterín' e tij. Kur ish vetem njezét vjetsh, Pirrua nisi nje lufte kunder mbretit te Maqedonise i cili i kish dale i pabese. Me trimerín' e tij te çquar, mbreti djalósh i Mollosise i mundi krejt Maqedónasit, dhe ketú ngjau nje gje e çuditeshme: ne vent qe te zemróheshin se u-muntne, perkúndrazi Maqedónasit u-çuditne me trimerín' e Pirros i cili u dukej sikúr ish Aleksandri i Math i dyte, e muk shkoj shume kohe qe Maqedónasit vete e lane mbretin e tyre dhe zgjodhe per mbret Pirron.

Kjo lufte kunder Maqedónasve eshte per te mbajtur ment edhé per nje aresye tjeter. Kur u-kthye Pirrua nga lufta, ushtaret e tij ishin aqe shume te gezuar per trimerín' e mbretit te tyre sa e qúajtin "shqiponje" osé "shkabe". Pirrua u-pergjégj dyke thene: "Po, jam nje shqiponje me te vertét; se si te nos jem shqiponje kur ju kam juve si krahe me te eilet fluturónj?" Thuhet se q' ahere, véndesit e Shqiperise u-qúajtne "Shqiptare", domethene "shqiponja" osé "djem te shqiponjes", dyke qene se mbreti i tyre vete ish

aqe trim sa ushtarct e tij i dhanc emrin "shqiponjc".

Mé von, Pirrua hodhi syt' e tij nga ana e Italisc dhe vuri ndermént qc tc vinte t' i pushtonte ató vende, ashtú siç kish berc ungji i tij, Aleksander Mollosi. U-hoth, pra, m' at' an' Adriatikut dhe u-perpóq me njc herc me Romanct, tc eilet kishin zenc até kohc qc tc madhóheshin e tc zgjeronin vendin e tyre. Gjashtc vjet ndenji Pirrua n Itali; po, me gjithc qc leftój me trimcrí tc mandhe, e me gjithc qc i mundi Romanct disá herc, mé nc funt u-shtrengua tc hiqej, se fuqit' e tija po pakcsóheshin dita me ditcn.

Passí u-kthye nc Mollosí, Pirrua vendosi qc tc bente njc vollte me ushtcrín' e tij nc Greqi. Vajti mé parc tc pushtonte Spartcn, e dyke mos mundur qc t'a zinte, u-kthye n' *Argos* tc Morosc, ku njc plake Grekoshe e vrau dyke e goditur nc koke me njc tjegull (qeramidhe) (272 perp. Kr.)

(Sheko kendimin PIRRUA I EPIRIT, faqe 29).

2.—Teuta e Ilirisc

Ashtú siç kish ngjarc per Mollosinc edhé Iliria u-çkepút nga Maqedonia, pas vdekjes s' Aleksandrit tc Math, me Glaukun per mbret, i cili u-tregua q' ish i zoti, se nc pak kohc e ngriti prapc me kembc mbreterín' e tij dhe e forcój.

Pas Glaukut erdhe dy mbreter tc tjerc, i funtmi i tc cilcve, *Agroni*, e forcój aqe shumc mbreterín' e Ilirisc sa s' kish qenc kurre aqe e

forte. Ky mbret i dha Ilirise edhe nje flote te forte e te madhe, te cilen e dergonte kohe me kohe kunder Grékeve, dhe, pas nje lufte ku Ilirianet dermuan krejt fuqine greke, Agroni u-gezua aqe shume per até fitim sa vdiq nga gezimi. Vendin e tij e zuri tani ajó fytyre e shenuar e historise shqiptare, per te cilen bene fjale mé siper: e shoqja e tij, *Teuta*, e vétema grua qe ka mbreteruar ne Iliri, pas Olimpise qe mbreterój ne Mollosi.

Teuta vuri nje-me-nje ndermént qe te zgjeronte mé teper mbreterin' e saj, dyke perdorur foren e madhe q' i kish lene i shoqi.

E para pune qe desh te bente kjo mbretereshe e qquar ish qe t' i zbonte krejt Greket nga Shqiperia. N' até kohe, Greket tregetare kishin themeluar disá kolloni per-sc-gjati ances se detit te Shqiperise, ne mes te cilave mé te shenúarat ishin *Epidamna* (Dûrresi i sotme), *Apollonia* (Bolena e sotme e Kurveleshit), *Foenika* (permi humin Bistrica). Teuta dergój, pra, flloten e saj me urdher qe te zinte Epidamnen dhe Foeniken. Ilirianet hyne ne Epidamne, po s' qendruan dot gjer ne fund; nga ana tjeter, e zune Foeniken, pa shume mundime, po e leshuan prape, se papandehur u erdhi nje lajmetár nga Teuta e cila i urdheronte qe te niseshin me nje here per ne Dardani (Kosove), ku fisi i Dardaneve kish ngritur krye kundra Teutes. Po ne kohen kur flota iliriane kish qendruar ances se detit te Foenikes, detaret ilirianc u kishin rene me qafe disá lúndrave romane,

dhe kapedanet e tyre vanc dhe iu-qanc Senatit tc Romes. Senati vendosi, pra, me nje here qe tc dergonte dy ambasadore te Teuta qe tc qâheshin dhe tc protestonin per marrjen nepér kembe tc tregetisc romane nga ana e detáreve Ilirisanc.

Ambasadoret e Romes arrinc ne Skodre dhe u-pritnc me nder prej Teutes, e cila i ftoj qe tc çfaqnin qellimin per te cilin ishin lodhur gjer ne kryeqytetin e saj. Romanet çfaqne ahere qarjet e tyre, dyke thene se Ilirianet benin nje faj te math dyke u rrenc me qafe tregetâreve te Romes. Mbreteresha i degjój me kujdés dhe, kur mbaruan atá se fóluri, u tha qe ajó do tc merrte tere masat e dûhura qe te mos benin nonjé faj *zyrtaret* e saj dyke u rrenc me qafe tregetâreve romane, po qe, nga ana tjeter,—shtoj Teuta,—mbretorít' e Ilirise s' e kishin zakón qe te ndalonin *njérezit* e veçante, qe nuk' ishin zyrtare, te háheshin me tregetaret e Romes. Dhe kjo ishte e vertete, gjer me nje pike, n' até kohe. Per fat te keq, njeri nga ambasadoret e Romes, ay me i riu, njerí gjaknxehte dhe i pamatur, u-zemrua keq kur degjój pergjigjen qe dhá Teuta dhe i foli mbreteresha me menyren e poshtme: "O mbreteresha, Romanet kane nje zakón qe nuk' i lene njérezit e tyre qe t' i hien me qafe njeri-jatrit, dhe per se shpejti kane per te treguar mjaft fuqí sa t'a bejne dhe Ilirine qe t' a njohe até zakon."

Kctó fjale kaqe t' ashpra e te památura te ambasadorit román e zemruan fort Teuten, dhe

kur do tɛ hipnin n' aniet ambasadoret per t' u-kthyer nɛ Romɛ, aŷ qɛ kish perdorur ató fjalet e ashpra u-vra anɛs sɛ detit. Kjo vrasje ish njɛ gjɛ shumɛ e keqe, se ambasadoret, tɛ dergnar siç janɛ prej qeverisɛ sɛ tyre, nuk duhen ngarɛ me asnjɛ menyre, po duhen nderuar kurdohere. Per fat tɛ keq, fajin mɛ tɛ math e beri aŷ ambasadori gjaknxehtɛ qɛ harrój sjelljen fisnike me tɛ cilen duhet tɛ flasɛ njɛ njeri perpara njɛ mbreti, e veçanerisht perpara njɛ mbretereshe.

Kur vajti lajmi i kesáj vrasjeje nɛ Romɛ, Senati román i çpalli me njehere lufte mbreterisɛ iliriane, dhe dy ushterí tɛ medhá u-benɛ gatí qɛ tɛ vinin tɛ goditnin Iliriné.

Po nɛ kohen kur po bíheshin gatí ketó ushterí romane, Teuta nxitój tɛ merrte masat e dúhura, dhe dergój me njehere flloten e saj qɛ tɛ zinte Korfuzin. Nɛ gjirin e Korfuzit, flota iliriane u-perpóq mɛ parɛ me njɛ flotɛ greke; luften e fituan plotérisht Ilirianet dhe Korfuzi ra nɛ duart e tyre. Po nuk' nbet shumɛ kohɛ Korfuzi nɛ duart e Iliriánɛve, se pak mɛ von arrijti flota dhe ushtaria romane, dhe Ilirianet u-shtrenguan qɛ t' ikin, passi edhé njɛ nga gjeneralet e saj, Dimitri, Princi i Farit, i dolli i pabesɛ Teutes.

(Shiko Kendimin: NJɛ BETEJE ANIETARE Nɛ MES T' ILIRIANEVE DHE GREKEVE, faqe 32).

Romanet, passi muar Korfuzin, hynɛ nɛ Shqipeni me anɛ t' Apollonise, dhe, ndonsé Ilirianet leftnan me trimeri tɛ çquar, si nga hera,

organizimi i mbaruar i ushterisë romanë, e cila përbehej prej 23.000 ushtarësh dhe 200 anijesh, po i mposhtte forcat iliriane pak nga pak. Me gjith' atë, lufta mbajti dy vjet plot (229-227 perp. Kr.); më në fund, Teuta, dykë parë që s' ia dilte dot në' anë, u-shtrengua të kerkonte paqe nga Roma, një paqe shumë të rëndë.

Kjo ish hera e parë që Romanët hynë në Shqipëri dhe në Ballkán, dhe kjo ish, gjithë' ashtú, nisja e pushtimit të Shqipërisë dhe të Ballkanit përgjithërisht nga ana e Románëve.

PËRMBLEDHJE

(Të mesohet me gojë)

1. *Pirrua*, mbret i Molloisë e i Epirit fiton mbretërin' e tij me ndihmën e mbretit t' Ilirisë, i mund Maqedonasit dhe zgjidhet prej tyre mbret edhe i Maqedonisë, fiton emërin "Shqiponjë" nga i cili thuhet q' e kanë marrë emrin e tyre Shqiptarët, hidhet n' Itali (280) ku lefton kundra Romanëve, dhe më në fund vetë në Greqi ku edhe gjen vdekjen (272).

2. *Agroni* forcon mbretërin' e Ilirisë, dhe pas atij vjen e shoqja, *Mbretresha Teuta*, e cila mundohet që të ndjekë nga Shqipëria Grekët. Detarët Ilirianë u bien në qafë tregtarëve romanë, dhe Senati i Romës dërgon dy ambasadorë të Teutës. Njëri nga ata i flet ashpër mbretreshës dhe vritet kur do të hipte në anije. Nga shkaku i kësaj vrasjeje, Roma i çpall luftë Ilirisë. Flota e Teutës zë Korfuzin, po pak më von vijnë Romanët, e marrin Korfuzin, hynë në Shqipëri dhe e shtrëngojnë Teutën të kerkonjë paqe, (227) pas dy vjet lufte të rreptë.

PYETJE PËR STËRVITJE

1. Kush ë vuri në fron të Molloisë Pirron? Tregoni luftrat që bëri Pirrua.— Perse Pirrua u-quajt "shqiponjë"?—Si dhe ku vdiq?

2. Cili ish Agroni dhe ç' bëri?—Ç' gjëra kish vënë ndërmend Teuta që të bënte?—Përshkruani pjekjen e Teutës me ambasadorët e Romës dhe shpiegoni se përse kishin vajtur të Teuta ata ambasadorë.—Përse Roma i ëpalli luftë Ilirisë?—Ish gjë e mirë vrasja e ambasadorit romak?—Përse jo?—Ç' toka jashtë Shqipërisë zuri Teuta?—Përse kërkoj paqë nga Roma?

KËNDIME

PIRRUA I EPIRIT—Pirrua është i njohtur si një nga gjeneralët më të mëdhénj të botës. Në një bashkëfjalim që pati gjenerali román *Skipión* me generalin Annibal të Karthagjenës, kunder të cilit Roma e kish dërguar që të luftonte, Skipioni e pyeti Annibalin se cili ish më i madhi gjenerál, pas mendjes së tij. Annibali u-përgjéq q' ish Pirrua i Epirit.

Njërëzit e asáj kohe rrëfenin shumë gjëra të çuditëshme për Pirrón. E para ish që dhembët e tij s' ishin të ndarë, siç janë dhembët e njërësve të tjerë, po të bashkuar njëri me tjetrin dhe përbënin një ështrë të njëshmë. E dyta, q' është edhé për të qeshur, ish që kémba e djathtë e tij kish fuqi të shënjtë që munt të shëronte sëmundjen e shpretkës me menyrën e poshtme: I sëmuri shtrihej më kurrís dhe Pirrua, me kémben e tij të zbathur, fërkonte butë vendin e shpretkës dhe pastáj therrte një këndes të cilin e sillte i

scumri si dhurate. Ky ish sherimi i mrekullshem qe bente Pirrua, i cili duket q' ish jo vetem mbret, jo vetem gjenerál i math, po edhé mjek i mbaruar per shpretka. Te pakcn, keshtú besonin njérezit e ahéreshme.

Jeta e Pirros ish shume e turbull. Kur aý ish vetem foshnje, pópulli i Mollosise ngriti krye dhe e zbriti nga froni shtepín' e tij, dhe qe t'a shpetonin, nga duart e armiqve, miqt' e tij e shpune tek mbreti i Ilirise, i cili e mbajti, e rriti si nje nga djemt' e tij, dhe, kur u-be dymbedhjete vjetsh, e shpuri me ushterín' e tij ne Mollosí dhe e beri mbret. Kur ish vetem djalósh i vogel mori pjese ne betejen e *Ipsit*. Kur ish po-thua njezét vjetsh, u-nis nga Mollosia qe te vinte ne dasmen e njejt nga djemt' e mbretit t' Ilirise, me te cilin ish rritur tok, Mollosianet u-ngritne edhé nje here dhe ia muarr fronin dyke ia dhene nje tjetri, porsá pane qe dolli nga kufiret e Mollosise Pirrua. Keté radhe e vuri prapa ne dore mbreterine me ndihmen e mbretit te Maqedonise. Po nuk shkoj shume kohe kur u-zu edhé me mbretin e Maqedonise, dhe sikúr s' arrinin keto, e shoqja e tij, bije e princit ilirián Bardhyll, iku e zemruar dhe vajti u-marrtua me mbretin e Maqedonise.

E fitój mbreterín' e Maqedonise, mé teper me dinakerí, dyke derguar njeres te fshehur n' ushterine maqedonase te cilet benin propagande nepér ushtaret dyke u thene se sa bukur qeveriste Pirrua dhe sa keq sillej mbreti i tyre, aqe

sa ushtarët maqedonas e lanë mbretin e tyre, si robe të vjetër, e u-hodhë nga ana e Pirros, dyke thirrur "Rrofte Pirrua!" Po s' shkoj shumë kohë dhe Maqedonia i iku përsëri nga dora.

Po veç çilcsive të tjera, Pirrua ish shumë i zgjuar edhé në të tăllura. Kur e mundi mbretin e Maqedonisë, Antigonin, i çili kish si ndihmëtarë edhé trupa Galesh—Galet ishin ndénjësit e parë të Francës së sotme dhe n' até kohë ishin përhapur e në Shqipërí e Maqedoní—, Pirrua i dergój témpullit të perëndeshës s' Itonisë—vënë që s' dihet se ku bie sot—disá armë të zëna në beteje, me këtë mishkrím të shíjeshmë e të bukur:

Pirrua, sternip i mbrëterve të Mollosisë,
Këtó armë t' i blatón, o Perendësh' e Itonisë,
Të marra nga Galet trima që kur u-thyen,
Antigoni e ushtar't e tij hemhe-ljepur u-deftyen.
S' eshte vetem sot a die, a për të paren herë
Q' Eakidet për trimní në bote janë ndjerë.

Eakide qúheshin me një emër bijt' e *Eakut*, atës të Pirros.

Një herë tjetër, kur Ieftonte përpara Spartes, Pirrua pa endërr síkúr Ieshonte rrufé me duart e tij dhe që me këtë menyrë i vuri zjarr tërë Lakedemonës, krahinës së Spartes. U-ngrit nga gjumi me endrrën édhe të gjallë në mendjen e tij e dha urdhër me një herë që të gatitej ushtëria për të goditur Spartën, mbasí aý kuptonte nga endrra që do t'a merrte jo vetem até qytét po edhé krahinën e saj. Dolli ahere një nga kape-

danet e tij dhe e kujtój Pirron qe vendet ku bînte rrufeja ishin nenë mprojtjen e perendive, si pas besimit t' asáj kohe. Po Pirrua in pergjégj q' ató ishin pralla dhe gjépura, te mira vetem per te genjyer pópullin e paditur po jo Pirron.

NJE BETEJE ANIETARE NE MES T' ILIRIANEVE E TE GREKEVE (228 perp. Kr.)— Mbreteresha Teuta, dyke hipur ne fronin e Ilirise, kish ne kumanden e saj nje nga flotat mé te medhá t' asáj kohe, veç ushterise. Porsá i çpalli lufte Senati i Romes, Teuta dergój flloten e saj qe te zinte viset me rendesí, te cilat muunt t' i dúheshin si qendra ne kohen e luftes kundra Romes.

Nje nga ató vise ish Korfuzi. Admiralet Iliriane duall, pra, perpara Korfuzit papritur e papandehur dhe nisne rrethimin e qytetit. Korfuziotet te trembur keq derguan me nje here njeres ne Greqí per te kerkuar ndihme kunder Ilirianeve. *Akaia*, e cila ish ahere shteti mé i forte i Greqise, dergój luftaniet e saj ne Korfús kunder flotes iliriane. Po, nga ana tjeter, Teuta kish dísá kohe qe kish here nje lidhje me *Akarnanet*, popull detár grek qe rronte ne krahinen e sotme greke qe ka per kryevént *Mesollongjin*, pas se ciles lidhje Akarnanet ishin te detyruar qe te ndihmonin Teuten ne lúfterat e saj, dhe keta derguan tanî gjashte luftanie. Luftaniet akaike dhe ketó t' Akarnaneve u-perpoqne jashte Korfuzit, dhe miqt' e Teutes, Akarnanet, u-muntne.

Po ahere hyne ne mes Ilirianet, dyke perdorur nje mjeshteri te re ne luften anietare. Ilirianet lithne tok nga kater luftaniet e tyre dhe u-eule me rrembim kunder luftanieve akaike dyke i goditur kur t' i arrinin, e pa marre ne ey se ç' munt te peaonin aniet e tyre. Te dy flotat u-perleshne, me keté menyre, po Ilirianet kecyen qe nga aniet e tyre, te lidhura bashke nga kater siç ishin, e u-hodhe ne luftaniet akaike ku u-zune gryke per gryke me Grekct, te eilet u-thyen krejt, dhe disá nga aniet e tyre rrane ne duart e múndsve Iliriane.

Ndihma qe priste Korfuzi u-çduk dhe, pas disá kohe rrethimi, qyteti rra ne duart e Iliriáneve. Dyke lene nje ushteri qe te rúante qytetin, admiralet iliriane ngritne peluret e u drejtuan ne Durres, te eilin do t'a kishin marre keté radhe po te moe kishin arrijtur Romanet me flloten dhe ushterin' e tyre te madhe.

IV.

HYRJA E ROMANCVE NE SHQIPERI

1.—Republika e Romes

Perpara se te vemc mé tej qe te shekojme se ç' bene Romanet ne Shqiperí, eshte koha qe te mesojme se ç' ish Roma dhe ç' fuqi kish ne keté kohe.

Qyteti i Romes u-kthis me 754 perp. Kr. prej *Romulit*, dhe si tere bota tjeter, edhé Roma qe-

verisej mé parë prej një mbreti. Po nja dy qint vjet mé von, u-ndoth që mbreti *Tarquini*, ish shumë i egër dhe i ashpër për pópullin, dhe mé në funt Romanët u-ngritnë kundër tij, e zbritnë nga froni, dhe vendosnë që pasketáj Roma të mos kish mé mbret. Në vent të tij, pópulli román do të zgjidhte dy zyrtarë, të cilët qúheshin *konsuj* dhe kishin të drejtë që t' ishin zyrtarë vetëm për një vit. Nga ana tjetër, Roma kish edhé një mbledhje të përbërë nga të parët e familjeve dhe të fisëve, me të cilët duhej të keshillóheshin konsujt për çdo punë zyrtarë me rendesí. Kjo mbledhje quhej *Senat*, shqip: *Pleqësi*, si pleqtë të kanë fshatrat tona. Kjo formë qeverimi në të cilen pópulli merr pjesë në qeverimin quhet *Republikë*, kursé në mbretëritë mbreti dhe jo pópulli e ka fuqinë në dorë.

Romanët ishin nga ushtarët mé të mirë që ka parë gjer sot bota; detyra mé e parë dhe mé e shenjtë për ushtarin román ish që t' u bindej të páreve t' ushtërisë. Përandáj, Roma arrijti pak nga pak që të bëhej një shtet i math, dhe mé në funt mundi të zërë botën e tërë, siç do të shohim mé poshtë. Mé parë nga të gjithë, Romanët nisnë të mposhtnin popujt e tjerë t' Italisë, dhe, kur mbaruan me këtá, in-kthyen *Karthagjenes*, e cila ish një qytét tregtár, shumë i pasur e shumë i fortë, n' anedetin e Afrikës, afër qytetit të sotmë të Tunuzit. Luftrat që bëri Roma me Karthagjenen quhen *Luftra punike*, dhe u-

bene tri lufira te ketilla, te gjata e te gjákeshme, gjer sa Karthagjena rra ne duart e Románeve, 146 perp. Kr., te cilet e sheshuan krejt qe te mos mbetej gjyrme prej saj.

(Shiko kendimin: USHTERIA ROMANE, faqe 42).

Kjo ish Roma me te cilen Teuta pati fatin e keq te zihej dhe te hynte ne lufte. Ne kohen kur Romanet hyne ne Shqipéri per te paren here, siq pame mé siper, tere Italia kish rrene ne duart e Románeve dhe e para nga te tri lúfterat punike kish marre funt me fitimin e Romes.

2.—Shqiperia e Maqedonia Kunder Romes

Passi u-munt dhe pranój paqen e rende Teuta, Romanet s' e zgjatne mé teper hyrjen e tyre ne Shqiperi, se kishin hallet e tyre n' Itali, nga shkaku se Karthagjena po behej gati qe te godite perseri Romen. Teuta mbet prape si mbretereshe e Ilirise, po keté here Iliria nuk' permblithte gje tjeter veç krahinen se Shkodres dhe te Malit te Zi; tokat e tjera Romanet i vune nené qeverimin e Dimitrit te Farit, t' ati gjeneralit te pabese qe leshój Korfuzin ne duart e tyre.

Me gjith' até, Iliria nisi te perparonte e te forcohej perseri, dhe, me vdekjen e Teutes, Dimitri i bashkój nené qeverimin e tij te dy coprat e Ilirise. Po, nuke shkoj shume kohe kur edhé vete Dimitri u lojti nga besa Románeve, nga te cilet ay desh te çkeputej plotérisht e te rronte si

mbret me vete. Romanet i çpallne me njchere luftë Dimitrit, dhe i muar fuqine nga dora, pas një luftë të rreptë ne të cilen muar pjesë tere Ilirianet kunder Romes, se deshin të mos linin të huajt të shkelnin ne Shqipëri, dhe ne vent të tij vune *Pinnen*, të birin e Teutes, i cili ish një djalósh i pafuqishme dhe i pazoti.

Dimitri i Farit, dyke ikur nga Iliria, u-fut ne Maqedoni (216) ku mbretëronte Filipi V (i peste), të cilin Dimitri nisi t' a ndiste kunder Románëve. Per të larguar Romanet nga Shqipëria, ku ishin një rezik per Maqedoninë, Filipi rrahu që t' i bashkonte edhé Epirotet edhé Greket kunder Románeve, dhe, veç ketyre, beri edhé një marëveshje me *Kathargjénasit*, të cilet ne këtë kohe kishin nisur luften e dytë kunder Romes.

Per fat të keq,, nuke shkoj shume kohe pas vdekjes se Pirros, q' Epirotet u-përçane dhe fiset e ndryshme po qëverisesheshin tani sicili me vete, pa nonjé bashkim ne mes të tyre. Fisi më i forte i kesáj kohe po refehej aý i *Athamánëve*, per të cilin thame më siper që rronte ne krahinen e Konitzes dhe ne malet e Pindit, dhe mbreti i tij u-bashkua me Filipin e Maqedonisë; po disá fise të tjera u-bashkuan me Romanet.

Filipi mblodhi një ushtëri të madhe kundra Románeve dhe arrijti afer Vlosës që të goditej me tá. Po Romanet u-dukne papandehur dhe e çperndane fuqin' e Filipit. Një paqe u-nenshkrua

ahere ne Durcs (205 perp. Kr.) ne mes te mbretit te Maqedonise e te Romes.

Po nuke shkoj shume kohe qe lufta u-persecrit, dhe Romanet neuć gjeneralin e tyre *Tit Flaminin* e muntne edhé nje here Filipin ne grykat e *Trebeshinit*, afer Kelcyres se Tepelenes.

3.—Luftrat e Funtme dhe Pushtimi i Shqipcrise prej Románcve

Me vdekjen e Filipit te Maqedonise, vendin e tij e zuri i biri, *Perseu*, i cili desh te mbaronte punen qe kish nisur i ati, domethene te zbonte Romanet nga Shqipcria.

Ne keté kohe n' Ilirí mbreteronte *Gjenchi*, i cili eshte dhe i funtmi mbret i Ilirise. Po ne vent qe te rrinte ne Shkodré, Gjenchi kish ndertuar nje qendre ushtcriake ne *Lesh*, dhe atjé i erdhe nje dite ambasadoret e Perseut te Maqedonise te cilit ishin porositur prej mbretit te tyre qe te lithnin besé me Gjenchin kundra Románeve. Ne krye, Gjenchi tregohej shume i drojtur, po mé ne funt u-lith me mbretin e Maqedonise. Gjith' ne keté kohe, n' Epír mbreteronte nje prine i forte e i dashur nga pópulli, e keshtú ky mundi qe t' i bashkonte edhé fiset e Epirit me mbretin e Maqedonise kundra Románeve. Siq shekoni, keté radhe Iliria, Epiri dhe Maqedonia u-lithne ngushte ne mes te tyre per te leftuar fuqín' e madhe te Romes.

Po kjo beselidhje s' munt t' i pelqente Romes me asnjé menyre, edhé keshtú nisi nje lufte e trete. Me 168, Roma çoj dy ushterí te medhá nené kumanden e kónsullit *Paul Emil*, i cili zbriti ne Durres qe te drejtohej kunder Perseut te Maqedonise. Nje cope e ushterise, nené kumanden e gjeneralit román *Luk Anik* vajti te goditte Gjenchin ne Lesh, i cili keté radhe u-shtrengua qe te futej prape ne Shkodre. Atjé u-rrethua prej Románeve, po pas pak kohe u-shtrengua qe te jepej ne duart e gjeneralit román, i cili e shpuri si rob lufte ne Rome.

Keshtú mori funt mbreteria e Ilirise, e cila taní u-be si nje ngastre romane (168 perp. Kr.).

Ne kohen kur *Luk Aniki* po ndiqte Gjençin, Kónsulli Paul Emil hoqi drejt kunder Perseut, te cilin e dermój dhe e mundi ploterísht ne *Pydne* te Maqedonise (168). Perseu ra rop ne duart e Románeve e Maqedonia u-be nje ngastre e Romes. Qe nga Pydna, Paul Emili zbriti poshte qe te pushtonte Epirin me nje ushterí te madhe. Epirotet pane qe s' ia dilnin luftes kunder nje ushterie aqe te madhe, dhe ne deshperím e siper te paret e tyre, princet e fiseve, vrane veten qe te mos binin ne duart e Románeve, siç pane qe ra Gjençi dhe Perseu dhe u-shpune si rober ne Rome. Paul Emili hyri ne Shqiperín' e poshtme, dhe Epiri i shkrete pesój nje shkaterím dhe shkretím q' i shembellén shkaterimit dhe shkretimit qe bene Greket me 1914.

Me urdher nga Senati i Romes, Paul Emili beri rremujen mé të madhe n' Epír; prishi qytetet dhe fshatrat nga themelet, mori nepér kembe mallin e njéresve të cilet u-plaçkitne krejt dhe plaçkat u-dergjuan ne Rome, fortesat dhe keshtjellat u-sheshuan rafshe me dhene, dhe 150,000 shpirt u-burgosne dhe u-shitne si rober. Shkretimi ish aqe i math sa vendi s' ngriti dot krye per nje kohe të gjate.

Keshtú ra dhe u-be krahine e Romes edhé Shqiperia e poshtme.

Njemént tere Shqiperia ra ne duart të Románeve të cilet e ndane ne copra.

PËRMBLEHJE

(Të mesohet me gojé)

1. Roma u-kthis prej Romalit me 754 perp. Kr. Ne krye qeverisej prej mbreti, po me von e qeverisnin dy *konsuj*, të zgjedhur prej popullit, se bashku me Senatin. Romanet ishin ushtare të mire e të bindur, dhe perandaj Roma mundi të pushtonje boten. Romanet luftuan tri here dhe prishne *Karthagjenen*, pasi zune tere Italine.

2. Dimitri i Farit, qe zuri vendin e Teutes, u-muar vesh me Filipin e Maqedonise per të leftuar se bashku kunder Romaneve. Romanet e ndjekin Dimitrin, dhe pak me von, gjenerali roman Tit Flamini e mundi ushterin' e bashkuar me Filipin.

3. *Gjonçi* i Ilirise, i funtmi mbret, merret vesh me Perseun e Maqedonise kunder Romaneve, dhe ne kete marreveshje bashkohen edhe Epirotet. Konsulli roman *Paul Emili* zbret ne Durres me ushterin'e tij dhe munt Perseun e Maqedonise ne Pydne (168). Gjenerali roman Luk Anik munt Gjenchin dhe e shpie ne

Rome si rob. Nga Pydna, Paul Emili zbret n' Epir te cilin e shkreton dhe e ben romuje.

4. Shqiperia e tere hie ne duart e Romaneve dhe bebet ngastre e Romes (168).

PYETJE PËR STËRVITJE

1. Kur u-kthie Roma dhe prej kujt?—Si qeverisej me parc dhe si me pastaj?—Ç' do te thote "Republike"?—Ç' ishin *konsujt*?—Ç' ish *Senati*?—Perse Romanet muntne te pushtojne tere boten?—Sa e forte ish Roma kur nisi te leftonte kunder Shqiperise?—Cila ish *Karthagjena* dhe ç' pesoj?—Cilat dhe sa jane luftërat *punike*?

2. Ç' bene Romanet passi Teuta beri paqe?—Cili ish Dimitri i Farit dhe ç' beri?—Cili ish *Pinna*? Ç' pesoj Dimitri dhe ku vajti?—Ç' kerkonte te bente Filipi i Maqedonise?

3. Ç' kish ngjare n' Epir pas vdekjes se Pirros?—Cilet ishin Athamanet dhe ç' bene?—Ç' u-be ne Durres me 205?—Ku kish dale Filipi qe te leftonte Romanet?—Cili ish *Tit Flaminì* dhe ç' beri?—Ku u-mund Filipi i Maqedonise?

4. Cili ish *Perseu* dhe ç' desh te bente?—Cili ish *Gjerçi*?—Cili mbreteroj pas Gençit n' Iliri?— Ç' beri Iliria, Maqedonia dhe Epiri ne kete kohe?— Cili ish *Paul Emili*, ne ç' vent te Shqiperise zbriti me ushterine e tij, per ku ish nisur?

5. Cili ish *Lek Anikì* dhe ç' beri?—Ç' pesoj Gjençi?

6. Ç' ngjau ne Pydne me 168?—Ku vajti Paul Emili qe nga Pydna? Ç' bene te paret e vendit n' Epir?—Kur u-shkretua Epiri ne koherat tona?

7. Ç' tregon viti 168 perp. Kr. per Shqiperine?

KËNDIME

EPIR apó MOLLOSI?—Pame mé siper se mbreteria e Mollosise u-themelua prej Mollosit, dhe qe Mollosia ish krahina mé e madhe e Epirit dhe

Mollosët ishin fisi më i fortë i vendit. Kështú, mbretrit e parë kishin titullin "mbretër të Mollosëve", si Aleksander Mollosi. Mé von, shekojmë që Pirrua quhet "mbret i Epirit" po në mishkrimin që vumë në një kendim të shkuar vetë Pirrua perdór fjalët "sternip i mbréterve të Mollosisë."

Dhe tani vjen pyetja: ç' lloj fjale eshtë fjala "Epír" e persé u-perdór për Shqipërín' e poshtme dhe perdoret sot e kesáj dite? Le t'a shpjegojmë, pra, një herë e mirë këté punë.

Epír eshtë pa dyshim një fjalë greke, kuptimi i të cilës eshtë "steré", "toke e thatë". Këté emër ia dhanë Shqiperisë së poshtme ndénjesit Greke e nisive ioniane, si Korfuzi, Kefalonia, Lëukada, etj., që të tregonin se toka perkundréjt nisive të tyre s' ish nisí po ish "toke e thatë dhe e gjerë, tej së cilës s' kish det", dyke qenë se nisitë kanë det nga të gjith' anët. Arsya që fjala "Epír" i mbet Shqiperisë së poshtme gjer sot e kesáj dite eshtë se këté fjalë vetëm perdornin shkrimtaret e vjetër greke, të cilët ishin shkrimtaret e vetëm t' asáj kohe. Nga këtá shkrimtarë e muarë mé von edhé shkrimtaret romanë e pastáj e muarë edhé Evropianët, aqe sa perdorimi i fjalës "Epír" u-pergjithesua, dhe shumë herë tërë Shqiperia quhej Epír. Disá nga shkrimtaret dhe jetëshkrónjesit e Skenderbeut e qûajnë Gjergj Kastriotin jo "mbret të Shqiperisë" po "mbret t' Epirit". Në kohën e Bizantínëve vetëm krahína e Shkodrës

quhej "Ilirí" dhe tere Shqiperia tjeter quhej "Epír".

Nga ketó qe thame mé siper kuptohet se fjala "Epír" s' ka nonjé kuptim qe vendi qe quhej ashtú ish toke e ndenjur prej Grekesh. As fare. Kjo fjalë ish vetem nje emer i pergjithesheme i tokes se ndenjur prej fiseve te ndryshme te Shqiperise se poshtme te cilet s' kishin nje emer te bashket per tere vendin e tyre, osé ne kishin aý emer s' arrijti gjer ne kóherat tona.

Nga ana tjeter, Mollosia ish vetem nje nga krahinat e Shqiperise se poshtme, po me qene se mbretrit e saj muntne te bëheshin edhé mbretër te fiseve dhe krahinave te tjera, shume here tere Shqiperia e poshtme osé Epíri quhej Mollosí.

USHTERIA ROMANE—Romanet jane ushtaret mé te mire qe ka pare bota. Ushtaret romane jo vetem q' ishin trima, po kishin edhé durim te math, te forte n' udhe e ne mundime, te kenaqur me pak te ngrena, dhe kishin hindjen mé te plotte ner kapedanet e tyre. Ne vere (behár) munt t' eenin afró gjashte kilometra n' ore, te ngarkuar me armet e renda t' asáj kohe. Kurre s' e shkonin naten ne nonjé vent pa u-forcuar mire nga te gjith' anet, e keshtú armiqte s' i gjetne kurre te papregatitur.

Ushteria romane ish e ndare ne *legjione*. Legjión quhej nje trupe prej afró gjashte mije burra, te ndare ne tridhjete *togje*. Forca e legjióneve u detyrohej dy gjérave: trimerise s' ush-

tarit dhe shpejtesise se tij. Ne betejat, legjioni ndahej me tresh, ne vija qe vinin njera pas tjetres. E para vije goditte armikun, e dyta i mbante krahun se pares, dhe e treta, qe sherbente si *rezerve*, merrte piese ne betejen ne çastin e duhur.

Ushtaret romane kishin nje *helmé*, mi krye, nje *krahesór* (prej çelniku), qe mbulonte trupin dhe e mpronte nga goditjet e armikut, dhe nje shpate qe priste me dy anet. Veç ketyre, kishin edhé nje *shtize*, dy metra te gjate, me te cilen goditnin mé pare armikun. Oficeret e larter te tyre quheshin *tribune*, dhe kapedanet e tyre qúheshin *qintare*.

Ushtari román pritej qe te tregonte trimerine mé te madhe ne lufte, po edhé nderi e shperblimi qe merrte ish i math. Ushtareve qe leftonin mire, Roma u jepte nga nje kurore prej fletesh dafine osé lisi, dhe shume here u jepte edhé gjerdane te florinjte e t' ergjente.

Kryegjenerali i nje ushterie qe fitonte nje lufte kish te drejte qe te merrte nje nder édhe mé te math. Ky nder quhej *triúmf*. Ne diten e caktuar, gjenerali fitimtár hipte ne nje karroce te hequr prej kater kuajsh te bardhe, dhe hynte ne Rome dyke patur perpara tij róberit qe kish zene ne lufte. Me keté menyre u-shpune si rober ne Rome mbreti i Ilirise, *Gjençi*, dhe aý i Maqedonise, *Perseu*. Pas gjeneralit vinin oficeret dhe ushteria. Kjo parade shkonte permés údheve mé te mira te Romes ne mes te brohorive te pópullit e te

lúlevc qc hithnin qytetarct nga dritaret e shtepive tc tyre. Pastáj, qc tc gjithc vinin nc *Kapitól* ku ish qendra e qeverisc romane dhe njc tempull i perendive tc Romcs, dhe atjé gjenerali triumfatór bente therorite (kurbanet) e zakóncshme si shenjc mirenjóftjeje per fitimin e tij. Mé nc funt, jepej njc gosti e madhe ku bashkóheshin njérezit mé tc shenuar. E merrni me ment se sa lavdí e madhe ish per njc gjenerál román qc tc fitonte njc triúmf tc ketillc.

Me keté organizate tc bukur e tc mbaruar Romanet muntnc, dhe s' esht as fare çudi qc muntnc, tc fitonin kudó e tc zinin terc boten.

BKSH

PJESA E DYTË

Që më 168 perp. Kr. gjer më 1410 pas Kr.

I

SHQIPËRIA NËNË ROMANËT

1. Zgjerimi i Pushtimit Román dhe Fillimi i Perandorisë Romane

Pas pushtimit të Shqipërisë, Romanët nuk qëndruan gjer atjé po ngane édhe mé tutje. Hyrja e tyre në Shqipëri u dha shtegun e duhur nga i cili u-ulë të zinin tokë vendet në lindje të Shqipërisë. Më organizatën e tyre të mbaruar, me ushtërin' e tyre të fortë dhe krejt të bindur nenë komandatët e tyre, Romanët mposhtnë pak nga pak të gjithë armiqt' e tyre, faji i math i të cilëve ish që s' bashkóheshin dot në mes të tyre, po qëndronin si dhen të ndara njëra nga tjetra; e dhent' e ndara i ha ujku pa nonjé veshtiresí të madhe. Gjith' ashtú siç ben ujku, bënë edhé Romanët. Dhe me të vertét, do t' ish një gjë fort e veshtirë që të mpóshteshin aqe lehtë Shqiptarët, Maqedónasit, Grekët, po të mos ishin të perçarë e të ndarë në fise e në grupe të cilet leftonin në mes të tyre, në vënt që t' i binin së bashku armikut të bashkët.

Keshtú, pra, Romanet, passi vunë në dorë Shqiperinë dhe Maqedoninë iu sulë Greqisë, e cila ish, gjithë' ashtú, e ndarë në qytete që leftonin në mes të tyre, dhe njezét vjet pas pushtimit të Shqiperisë edhé Greqia rá nder kembet e Románeve. Mé von, Romanet múarë udhën e lindjes, zunë Stambollin, i cili quhej *Bizant* n' até kohë, pushtuan Asin' e Vogel, të cilën neve e njohim mé mirë nenë emerin *Anadóll*, vanë gjer në Syrí dhe Mesopotami, zunë edhé Egjyptin, të cilin neve e dimë mé mirë nenë emerin *Misir*; me fjalë të tjera e zgjatnë fuqin' e tyre po-thuaj se gjer atjé ku kish vajtur Aleksandri i Math.

Po Romanet vanë mé tej se sa Aleksandri. Nga ana e perendimit, zunë Franën, një pjesë të madhe t' Anglisë, dhe Spanjën. Me një fjalë u-bënë zotër të botës së tërë t' asúj kohe.

Po kur s' kish mbetur nonjé çip tjatër i dheut që të pushtonin, Romanet zunë të leftonin në mes të tyre. Tetedhjetë vjet t' historisë së Romës shkuan me lúftera civile, brenda në Romë dhe në viset e pushtúara grej Románeve. Këtó lúftera civile u-bënë shkak, mé në fund, që humbi lirin' e saj Roma. Gjeneralet e Romës zunë të háheshin në mes të tyre që cili të vinte në dorë fuqin' e mbretërisë së madhe.

Per dy nga ató lúftera civile Shqiperia sherbeu si fushë lufte, domethënë perpjékjet mé të medhá u-bënë në tokë të Shqiperisë. E para u-bë në mes të *Jul Qesarit dhe të Pompejit*. Këtá dy

burra kishin n' até kohe fuqinë mé të madhe në dorë. Jul Qesari, i cili numerohet si një nga burrat më të medhénj të botës, kish shtruar Francën e sotme nenë Romën, dhe po kthehej në Romë me qellim që të zbriste Pompejin nga zyra që kish si *konsull*. Pompeji iku nga Roma dhe u-hoth në Shqerí dhe q' andéj në Thesalí me qellím që të mblithte atjé një ushtrí. Jul Qesari dolli me një ushtrí prej 20,000 në *Palasë* të Himarrës dhe q'andéj arrijti në Thesalí ku dermój ushtrin' e Pompejit (48 perp. Kr.). Tre vjet më von (45), Jul Qesari u-vra me të pabesë.

Lufta e dyte civile plasi në mes të *Mark Antonit e t'Oktavit*, nipit e Jul Qesarit, të cilet hàheshin në mes të tyre perseri për të vënë në dorë qeverin' e Romës (43-30 perp. Kr.). Një perpjékje e madhe dhe e përfúndeshme në mes të dy fílótave kundreshtare u-bë në gjirin e Prevezës dhe Oktavi fitój jo vetëm luftën, po u-bë edhé *Perandori* i parë i Romës (28). Kështú, Oktavi fitoj kurorën e madhe të perandorisë romane n' anedetin e Shqiperisë.

Me çpalljen e Oktavit si perandór i Romës, republika e Romës vdiq dhe fuqia e tërë u-mbeshtuall në duart e një njeriu, të Perandorit, i cili mori titullin *August;* pas atij erdhë shumë perandorë të tjerë, disá nga të cilet do t' i kujtojmë kur të vinjë radha.

2–Qytetaria Romane ne Shqipeni

Dyke e vene Shqiperine ne dore, Romanet e ndane ne disá ngastra osé krahina te eilat i lane qe te veteqeverisheshin, arriute qe te njihnin Romen si zonje mi veten e tyre. Me fjale te tjera, Shqiperia nuk' e humbi per fare lirin' e saj, po kish te drejte qe te qeverisej me vete nesé kqyrjen dhe veshtrimin e Romes. Gjuha e vendit perdorej aqe lirisht saç perdorej dhe gjuha e Romes, gjuha latine, dhe njérezit ishin te lire qe te mesonin eilendó guhe qe t' u pelqente.

Nga ana tjeter, fuqia romane u dha funt zíhjeve te mallkúara qe kane nxire jeten e Shqiperise; Romanet nuk' i linin fiset e Shqiperise qe te hábeshin ne mes te tyre, dhe keshtú lúfterat e bréndeshme, qytet me qytet, fshat me fshat, fis me fis, dhe njerí me njerí, pushuan. Dhe me qe taní njérezit s' muntnin te punonin njeshterin' e vjeter, luften, nje kohe e ré perparimi dhe qytetérimi nisi ne Shqiperí. Zakonet e égera dhe barbare u-lane me nj' ane, dhe vendin e tyre e zune sjélljet e mira dhe njerezore. Me fjalen qytetérí kuptohet qe njerezia nisne te punonin arat, te nxirrnin metalet nga gjiri i dheut, te hapnin shkolla per mesim, te pushonin lúfterat ne mes te tyre, vrasjet, vjedhjet, gjakderdhjet, plaçkitjet dhe marrjen neper kembe e te drejtave e te pafuqishmit prej atij mé te fuqishmit. Kesáj i thone qytetérí, dhe nje komp qe nuk' i ka ató gjera qe numeruam

mé siper eshte nje komp *barbár*, i eger dhe i paqyteteruar. Romanet ishin te qyteteruar dhe shpune qyteterin' e tyre ne Shqiperí.

Qytetet e Shqiperise q' ishin mé te perparuar ne keté kohe ishin *Vlora, Dúrresi, Ambrakia (Narta), Shkodra dhe Leshi.*

Romanet ndertuan edhé nje udhe te gjate e cila niste ne Shqiperí dhe arrinte gjer ne Stambóll. Kjó udhe e degjuar quhej *Egnatia osé Aegitana.* Udha Aegitana kish dy krahe: njeri niste nga Dúrresi dhe tjetri afer Vlores; te dy krahet bashkóheshin afer Shkumbit, ne Kodane. Gjyrmat e saj munt te shihen e sot e kesáj dite. Ne keté udhe vizitonin ushterít' e Romes qe vinin ne Lindje si edhé tregetaret.

Po, ndonesé Shqiptaret hyne n' udhen e qyteterimit e te perparimit, nuk' munt te harronin se ishin nené zgjedhe te huaj, dhe kurdohere qe Romanet nisnin te tregóheshin te ashper, Shqiptaret ngrinin krye kundra tyre me shprese qe te liróheshin, po ató ishin mundime te kotta. Me gjith' até, Roma, dyke pare rrezikun e kryengrítjeve ne Shqiperi, kohe me kohe themelój kolloni romane, domethene togje Rmanesh me femijet e tyre, te cilet vendóseshin ne viset e ndryshme te Shqiperise, atjé ku ish nevoje mé teper, qe te rúanin véndesit te mos benin kryengritje. Nje nga atá qe u-kujtua te merrte masa te ketilla ish edhé Jul Qesari. Dhe thuhet qe Vellehet e Shqiperise jane sterniprit e atyre Románeve qe erdhe

dhe u-shtruan nε Shqiperi, bashke me femijet e tyre.

Per fat tε keq, kjó qytetεri e bekuar nuk' vonoj qε tε shuhéj perseri, siç dº tε shohim mé poshtε.

3—Sherbimet qε i Beri Romes Shqiperia

Si per shkembim e tε nurave tε qytetεrisε qε shpuri Roma nε Shqiperi, edhé Shqipéria i solli Romes, si per shperblim, disá sherbime shumε tε çmúara.

Sikunder treguam mé siper, pas perandorit tε pare, *Augustit*, erdhε shumε perandorε tε tjerε. Disá nga atá e qeverisnε perandorinε romane me drejtesí e zotesí tε madhe. Po, nga ana tjeter, esht' e pamundur qε njε njeri i vetem, siç ish perandori i Romes, me fuqí aqe tε madhe tε mos bente gabime nε kurrís tε pópullit. Keshtú, kohε nε kohε, dúallε disá perandorε q' u-treguan mé t' eger se bishat e égera, nε mes tε cíleve aý mé i degjúari per keq eshtε *Néroni*, i cili e mundonte pópullin me njε menyrε qε s' refehet. Nga shkaku, pra, i qeverimit tε lik tε perandóreve, perandoria romane nisi tε rrεzohet pak nga pak e tε bjerε per dhé.

Njε shkak tjeter i rénies sε perandorisε romane ish lindja e Krishterimit. Nε kohen e mbretérimit t' Augustit tε pare, lindi nε *Bethlehem* tε Judesε *Jesú Krishti*, dhe Krishterimi nisi tε perhapej nε perandorinε romane. Nε krye pe-

randoret e Romes e ndoqne me terbim te math Krishterimin, dyke urdheruar therrje te pergjitheshme per te Krishteret, dhe kjo gje solli trazira e trubullime me te kuter anet e perandorise romane, e cila nisi qe te tundej nga ketó ngatrime.

Ne keté kohe, Shqiptaret kishin zene te merrnin vende te larter ne qeverimin e perandorise romane. Shume Shqiptare u-bene gjenerale, dhe gjashte nga perandoret e Romes ishin Iliriane. Mé i fameshmi ne mes te ketyre esht *Diokletiani*, i cili u-tregua fort i zoti dhe mundi t'a perkembe perandorine Romane per ea kohe. Diokletiani vuri re q' ajó perandori asqe e madhe s' munt te qeverisej vetem prej nje njeriu e keshtú e ndau me dysh.

Gjith' ashtú, trupat qe rrinin pas perandorit ishin te perbera mé teper prej Iliriánesh.

(Sheko Kredimin: GARDA PRETORIANE, faqe 54).

Krishterimit Shqiperia i dha dy njeres te medhénj. Mé i shenúari nga ketá ish *Kostandini i Math*, perandór i Romes, i cili jo vetem qe i mori te Krishteret nené mprojtjen e tij, po edhé rrezój fare besen e vjeter dyke njojtur si fe zyrtare Krishterimin. Veç kesáj, Kostantini themelój edhé Konstantinopojen (Stambollin), te cilen e beri kryeqytét te ri te perandorise romane. *Nishi*, i cili ahere ish pjese e Shqiperise, ish vendi ku u-lint Kostantini i Math.

Njeriu i dyte ish *Shen Jeronimi*, i cili perkthen ne latinishten librat e shenjta e te Krishtéreve.

Po s' jane vetem ketá njeres te shenuar q' i dha Romes Shqiperia; ka edhé shume te tjere, émerat e te cileve munt t' i mesoni mé von.

(Shekó kendimin: JULIAN FILOSOFI, faqe 55).

PERMBLEDHJE

(Per te mesuar me goje)

1. Pasi zune Shqiperine, Romanet e zgjatne pushtimin e tyre ne Greqi, ne Ballkan, n' Anadoll e ne viset e tjera te botes se njojtur. Fitimi i Romaneve u detyrohet ndarjeve dhe perçarjeve te kombeve te tjere.

2. Romanet ziben ne mes te tyre, dhe nisim lufterat civile, dyké qene se gjeneralet e tyre zune te haheshin ne mes te tyre qe cili te merte fuqine ne duart e tij. *Jul Qesari* hyri ne lufte me Pompejin dhe dolli me ushterin' e tij ne *Palase* te Himarres; q' andej u-perpoq me Pompein ne Thesali. Niprit e tij, *Oktavi* dhe *Antoni*, e perseritin luften me von. Antoni mundet prej Oktavit ne gjirin e Prevezes, dhe Oktavi behet i pari perendor i Romes. Republika e Romes humbet.

3. Shqiperia eshte e lire te veteqeveriset nene Romanet, te cilet shpune *qyteterin'* e tyre ne Shqiperi. Nje kohe e ré perparimi nis per Shqiperine. Romanet hapne udhen *Aegitana* ose *Egnatia* qe shpinte prej Shqiperise ne Kostantinopoje.

4. Kohe me kohe Shqiptaret bejne kryengritje qe te lirohen nga Romanet, dhe perandaj Roma themelon *kolloni* ne Shqiperi. Vellehet e Shqiperise jane sterniprit e Romaneve q' u-vendosne atje.

5. Me hipjen ne fron e perandóreve, disá nga te cilet ishin shume te liq e t' eger si *Neroni*, nis renia e perandorise romane. Nga ana tjeter, lindja e Krishterimit sjell trazira dhe trubullime te cilat e tronditin ca mé teper perandorine Romane. Shqiperia i vete

ndihme Romes, dyké i dhene gjashte perandore, ne mes te cileve mé i fámeshmi eshte *Diokletiani* qe mundi te perkembe perandorine romane. Gjith' ashtu, Shqiperia i jep ushteri Romes.

6. Krishterimit Shqiperia i jep *Shen Konstandinin* (Kostandinin e Math) i cili mori nene mprojtjen e tij besen e Krishtere, dhe *Shen Jeronimin* i cili perktheu librat e shenjta ne latinishten.

PYETJE PER STERVITJE

1. Ç' bene Romanet passi zune Shqiperine?—Cila ish aresya qe Romanet i mposhtne aqe lehte popujt e tjere?—Gjer ku zgjatet perandoria romane?—Cila ish me e madhe: Perandoria e Aleksandrit te Math apo ajo e Romaneve, dhe perse ish me e madhe?

2. Ç' bene Romanet passi zune boten?—Ç' do te thote *luftera civile?*—Perse u-bene ato luftera civile?—Cili ish *Jul Qesari* dhe ç' beri?—Cili ish *Pompeji?*—Ç' kane te bejne me Shqiperine keta dy njeres?—Cili ish *Mark Antoni* dhe Oktavi dhe ç' kane te bejne me Shqiperine?—Ç' fitoj *Oktavi* n' anedetin e Shqperise dhe ku?—Ç' u-be pastaj Oktavi?—Ç' do te thote fjala perandor?—Cili ish perandori i pare i Romes dhe ç' titull kish?

3. Si qeverisej Shqiperia nené Romanet?—Ç' gjuhe perdorej ne Shqiperi n' ate kohe?—Dini noca kombe te paqyteteruar sot, dhe cilet jane?—Ç' gje ish *Egnatia ose Aegitana*, ku niste dhe ku mbaronte?—Cilet ishin qytetet mé te degjuar te Shqiperise ne keté kohe?

4. Si u-mundua Roma qe te mposhtej kryengritjet ne Shqiperi?—Cilet jane stergjyshet e Vellebeve te Shqiperise?—Ç' do te thote fjala *kolloni?*

5. Cilet ishin shkaket qe nisne prishjen e perandorise romane?—Ç'' ish *Neroni?* Ç' ka te benje lindja e Krishterimit me renien e Romes?—Si u-prit Krishterimi prej Romes?— Ç' sherbim i beri Romes Shqiperia? Sa perandore i dha? Cili ish me i fameshmi nga te gjithe dhe ç' beri?—Ç' i dha Krishterimit Shqiperia? —Ç' beri Shen Kostandini?—Cili ish Shen Jeronimi dhe ç' beri?

GARDA PRETORIANE—Trupa ushtriake që rrinte pas perandorit të Romes quhej "garde pretoriane" e përbehej nga ushtarët mé të zgjedhur që kish përandoria. Po nuke duhet të çuditi kur të dëgjoni se pjesa mé e madhe e asáj garde ish e përbërë prej ushtarësh Iliriane, mbassi me organizimin e bukur román, Ilirianët ishin bërë ushtarët mé të mirë të përandorisë. Nga ana tjetër, dyke qenë se Ilirianët ishin fort besnikë —gjë q' e kish kuptuar edhé Sulltán *Abdúl Hamiti II* i Turqisë, i cili mbante, gjith' ashtú, një gardë prej ushtarësh shqiptarë,—perandorët e Romës e kishin bërë zakón që t'a formonin gardën e tyre me ushtarë iliriane, q' ishin trima e besnikë.

Kur nisi të tronditej perandoria romane nga turbullimet e brëndëshme, garda pretoriane e mori për vete të drejtën që të hipte në fron e të zbriste perandorët q' i pëlqenin asáj, pa marrë as fare mundimin që të pyesë se ç' mendím kish Senati osé pópulli i Romës. Me këtë menyrë, hipja në fron e zbritja e perandórëve romanë prej gardës pretoriane u-bë një gjë e régullshme. Kurdohërë që dilte nonjé gjenerál i dashur ner ushtarët, osé që zotohej roga mé të mira për gardën, pretorianët e zbrisnin, pa një pa dy, perandorin që mbretëronte até kohë dhe në vent të tij vinin njerin' e zgjedhur prej tyre, keshtú që, mbassi garda pretoriane përbehej mé tepër prej Ilirianësh,

Ilirianet tanë ishin atá që qeverisnin Romën dhe perandorin' e saj.

Më këtë mënyrë hipi në fron *Diokletiani* dhe perandoroi e tjerë Ilirianë, ndër të cilët ishin *Valenti*, *Aurelliani*, *Deki*, *Probi* e *Klaudi*, e që të gjithë këtá u-treguan perandorë të zotër.

JULIAN FILOSOFI—Pak kohë pas vdekjes së Kostandinit të Math, i cili siç thamë mé siper, e njojti Krishterimin si fe zyrtare dhe e ngriti kryeqytetin nga Roma në Kostandinopojë, hipi në fronin e Kostandinopojës i nipi i tij *Julianë*, i cili ish, gjith' ashtú, ilirián siç ish edhé Kostantini.

Më të hipur në fron, Juliani rrahu që t'a rrëzonte Krishterimin dhe të ngjallte përsëri fen' e vjetër pellasgjike, e dyke qënë se ish njeri i mësuar dhe merrej me dituri u-quajt *Julian Filosofi*. Një luftë më ehkrim u-ndez, ahere, në mes të Julianit që kërkonte të ngjallte fen' e vjetër dhe t' atyre që mpronin fen' e re, Krishterimin. Kundërshtarët e tij, që t'a goditin mé mirë Julianin e t'a çnderonin në syt' e pópullit e qûanin "një barbár nga Iliria" dhe q' aý dyke ërdhur nga një vënt i utillë s' kish nonjë punë që të merrej më çështjen e fesë së re. Juliani u-përgjégj, ahere, q' aý ish vertét Ilirián, po nga ana tjetër s' ish e mundur që të mohohej që "Ilirianët ishin trimat mé të mëdhénj ndër burrat e botës."

Nga kjo deshirë e Julianit që të rrëzonte Krishterimin e të sillte përsëri fenë e vjetër,

Juliani mori émerin edhé "Apostát", domethémc kryengritcs dhe femohonjes .

Po Krishterimi ish hapur shumc n' ató kohc, dhe ish e pamundur qc t'a mposhte Juliani.

II
SHQIPERIA NËNC BIZANTINËT

1.–Ndarja dhe Shkaterimi i Perandorisc Romane

Mé siper thamc se perandoria romane kish nisur prej kohe qc tc rrezohej, dhe qc perandori *Diokletian* desh t'a perkembte dyke e ndarc me dysh. Qellimi i tij nuk' ish qc t'a ndante fare njeren copc nga tjetra, po vetem qc t'a ndante nc dy krahina tc medhá dhe nc kryen e cilesdó prej tyre tc qeveriste nje zevendes-perandór. Po ndarja qc beri Diokletiani me qellim tc mirc nisi shumc shpejt tc bchej nje perçarje e plotte nc mes tc dy krahinave tc medhá. Njera nga ketó krahina permblihte Evropen, me kryeqytét Romen, dhe tjetra permblihte Ballkanin dhe Anadollin, me kryeqytet *Bizantin*. Po dyke hipur nc fron Kostandini i Math (306 pas Kr.), perandoria romane u-bashkua persecri dhe u-bc nje, me ndryshim qc tani kryeqytét s' ish mé Roma po Bizanti, tc cilin Kostantin e ndertój dhe e emeroj *Konstantinopoje* (Qytét i Konstandinit). Po nukc shkoj prapc shumc kohc dhe me 395 pas Kr. tc dy

krahinat u-ndanc perseri, dhe nc vent tc njc perandorie u-benc dy, sicila me perandorin e saj tc veçantc. Shqiperia, si pjesc e Ballkanit, u-lith me perandorin' e Lindjes, e cila quhet *Perandori Bizantine*. Keshtú, pasketáj Shqiperia do t' ish nenć úrdherin e perandorit tc Konstantinopojes.

Nga ketó dy perandori mć e dóbcta u-tregua q 'ish ajó e Perendimit qc kish Romen per kryeqytét dhe nuke vonój shumc qc tc bînte e tc shdukej. Nc shékullin e katert pas Krishtit, valet e fiseve Gjermane qc rronin pertéj lumenjve *Danub* dhe *Rhin* dhe tc eilat s' ishin mposhtur kurre prej Románeve, çfrync nc fushat e Italisc sc síperme dhe mbytnc vendet me númurin e tyre tc math. Mć nc funt, Gjermanet zbritnc gjer nc Romc, e cila ra nc duart e tyre mc 476 pas Kr., dhe perandoria romane e Perendimit u-çduk per fare.

(Shcko Kendimin: MESJETA, faqe 65).

Tani mbet vetem Perandoria Bizantine, e sc eilcs Shqiperia ish njc pjesc. Mć tutje do tc shohim se ç' i ngjau edhé kesáj perandorie.

2.—Shkeljet e Barbáreve

Gjermanet s' u-mjaftuan dyke marrc Romen. Me mizerit' e tyre i ranc Evropes mc tc katcr anet, dyke rrezuar mbreterite qc ishin mc kembe e dyke ngritur mbreterí tc reu, tc qeverisura prej

tyre. Gjer n' até kohe bota kish degjuar fare pak per ketá Gjermane, q' ishin barbare dhe te paqytetcruar, po tani pati rastin qe t' i shekonte prej s' áfermi. Pothua se asnjé vent i Evropes s' mbet pa u-shkelur prej fiseve te ndryshme ne te cilet ndáheshin Gjermanet.

Edhé per Shqiperine ish shkrojtur qe te shkelej ne keté kohe jo vetem prej Gjermáneve po edhé prej shume fisesh te tjere barbare, sidó q' ish e lidhur me perandorín' e Konstantinopojes, e cila as qe mundi as qe u-tregua e zonja t' a mpronte ven' din tone nga shkeljet e ndryshme. E verteta eshte qe Shqiperia ish vetem ne emer dhe jo me te vertét nené qeverimin e Konstantinopojes. Here pas here dhe kohe pas kohe, Shqiperia humbi nené valet e mizerive te shkélesve vetem qe te ngrinte koke per pak kohe dhe gjer sa te zinte te merrte veten vinte nje vale tjeter dhe e permbyste.

Barbaret e pare qe shkelne Shqiperine ishin *Gothet*, nje nga fiset mé te forte te Gjermáneve e gjith ay fis qe kish zene Romen. Gothet ndenjne ne Shqiperí mé teper se nje qint vjet. Po ne 535. *Justinian*, perandór i Konstantinopojes, i cili vete ish nga Shkupi, i zboj Gothet nga Shqiperia dhe qe te mpronte keté krahine nga shkelje te tjera ndertój per-se-gjati te kufireve te saj nje sere fortesa e keshtjella.

Me 639, *Hunet*, nje popull shume barbár dhe i eger qe ish nisur qe nga Asia, hyne dhe zune tere Shqiperine. Po Hunet nuk ndenjne shume

kohe ne Shqipení, se pas pak arrijtin *Avaret*, tjeter popull barbár i Asise, te cilet vune perpara Hunet dhe i nxúare jashte Shqiperise te cilen e perlane vete. Ne keté kohe, perandori i Konstantinopojes, *Heraklí*, u dha leje *Sérbeve*, q' ishin édhe ne Rumanín' e sotme n' até kohe, qe te nxirrnin Avaret jashte Shqiperise. Serbet e mbarnan porosín' e Heraklit, dhe, si shperblím mbajtne per vete vendet qe ka sot Mali i Zi dhe nje pjese te madhe te Bosnjes si edhé te Serbise te cilat ishin mé pare toka t' Ilirise.

Me 861, Shqiperia u-shkel perseri prej nje pópulli barbár te ri, prej *Bullgáreve*, te cilet duken per te paren here. Bullgaret e shkretnan dhe e plaçkitne vendin, ashtú siç kishin bere mé pare barbaret e tjere. Nje vale e dyte Bullgaresh mbyti perseri Shqiperine pak mé von. Emerat bullgarishte te disá fshátrave dhe véndeve te Shqiperise kane mbetur qe ne keté kohe kur Bullgaret shkelne vendin tone. Gjith ashtú, ne keté kohe u-vendosne Bullgaret qe gjenden sot ne disá vende te Shqiperise.

Ne funt te shékullit te njembedhjete (1081), Shqiperia e Mesme dhe e Poshtme u-shkel prej *Normánezve*, tjeter popull prej gjaku gjermani, po te larkme. Vendi i pare nga i cili ishin nisur ne krye Normanet eshte *Skandinavia*; q' andéj atá u-hodhe ne France, n' Ingli, n' Italí, dhe qe nga ky vent i funtme arrine ne Shqipení me aniet e tyre. Shkaku qe i shtyti te hidheshin ne Shqipení

ish se kishin njc zihje me perandorin e Konstantinopojcs.

Shkeljet e barbáreve nc Shqipcrí patnc njc perfundim shumc fatkéq per vendin tonc. Pervéç qc tokat e Shqipcrisc u-shkretuan dhe njc shumicc e madhe njercs u-therrc prej barbáreve osé humpnc nc lufterat qc benc kundra tyre, dcmi mé i math qc iu-bc Shqiperisc ish qc ketó shkelje çrrcnjosnc krejt dhe mbytnc qyteterinc qc kish nisur tc lulezonte dhe perparimin e kombit tonc. Shqiperia ra prapc nc lcngím dhe mbet pas nga shoqet e saj.

3.–Kryqesatat

Shkeljet dhe perbapja e barbáreve po-thua se kishin marrc funt nc keté kohc, dyke qenc se eilidó nga atá kish zenc nga njc vcnt ku edhé qendrój-Evropa kish shpetuar, pak a shumc, nga kesí lloji turbullimc, veçanerísht passí barbarct e ndryshmc hodhc poshtc fen' e tyre tc vjetcr dhe perqafuan Krishterimin, i cili po zbutte pak nga pak zakonet e tyre t' égera.

Po taní nisi, nga ana tjeter, njc levizje e çuditeshme dhe e re nc mes tc pópujve tc Krishterc t' Evropcs, njc levizje q' e mbajti Evropcn mc kcmbc per tre shekuj; levizja e *Kryqesátavé*, mc fjalc tc tjera *Lúfterat e Kryqit*.

Qc t' i kuptojmc mé mirc ketó lúftera, eshtc nevoje qc tc shekojmc mé parc cilet ishin shkaket

qe shtyne popujt e Evropes ne këtó lúftera te rea.

Qe kursé nisi te perhapej Krishterimi, besniket kishin zakón qe te ngrîheshin nga te gjith' anet e te vinin ne vendet e shenjta te Krishterimit, ne *Jerusalém* te Judese, ku eshte varri i Jesú Krishtit. Me fjalë te tjera vinin ne *haxhillék*. Po, ne shékullin e shtate, dolli ne *Meke* te Arabise profeti *Mohamét*, dhe Arabet lane fen' e tyre te vjeter dhe perqafuan fen' e re, e cila u-quajt *Mohamedanizme* osé *Islanizme*. Mé von, Arabet nisne te zgjatnin pushtimin e tyre dyke u-shtrirë ne Syrí, ne Mesopotami e ne vende te tjere. Një nga fiset e tyre mé te forte, qe qúheshin *Sarakene*, zgjati pushtimin aráb ne Misír, ne tere anedetin e Afrikes e q' andéj u-hodhe ne Spanjë, te cilen e zune te tere, e deshin te zinin edhé Francen, po nuk' munde. Gjithe këtá Sarakene kishin shtene ne dore edhé Jerusalemin. Po këtá Arabe Sarakene ishin shume te qyteteruar, mé te qyteteruar se kombet e Evropes s' asáj kohe, dhe jo vetem qe nuk' ngíanin te Krishtere qe vinin per haxhillék ne Jerusalém, po edhé i mpronin. Një nga shenjat mé te çquara te qytetërise eshte nderimi i fese se tjetrit, dhe Sarakenet ishin, siç thame, te qyteteruar dhe nderonin te gjitha fet' e tjera, sidó q' atá vete ishin Mohamedane.

Po nuke shkoj shume kohe kur dolli ne shesh, nga viset e Turqestanit, nje fis i Turqve, te cilet qúheshin *Selxhuke*, dhe te cilet ishin prej një fjaku me *Turqít Osmanllínj* te cilet duall ne

shesh mé von, siç do tɛ shohim mé poshtɛ. *Selxhukɛt* ishin njerɛs t' egɛr dhe barbarɛ, *Mohomedanɛ*, edhé kɛtá, nga feja. Puna e tyre e parɛ ish tɛ zbonin Sarakenɛt e qyteterɛvɛ nga vendet qɛ kishin zenɛ kɛtá mé parɛ dhe tɛ eilat i muarɛ tani Selxhukɛt. Njɛ nga ató vende ish edhé *Jerusalemi*. Haxhinjtɛ tɛ Krishterɛ zunɛ tɛ vinin prapɛ nɛ Jerusalém, po kɛté radhɛ jo vetem qɛ s' gjetnɛ nonjé mprojtje prej Selxhukɛvɛ t' egɛr, po edhé shumɛ nga atá u-therɛ, u-perdorɛ liksht, e shekuan se Selxhukɛt u shanin fenɛ dhe benin edhé shumɛ gjera tɛ papelqýera tɛ eilat tregonin barbarin' e tyre.

Disá nga tɛ Krishterɛt muntnɛ tɛ ktheheshin nga Jerusalemi n' Evropɛ, dhe atjé nisnɛ tɛ refenin mɛ ngjyra tɛ **zeza vojtjet** e tɛ Krishtérɛvɛ q' ishin nenć zgjedhen e Selxhúkɛvɛ dhe sjelljet e papelqýera tɛ tyre. Kető refime ndezɛ zemrat e pópujvɛ tɛ Krishterɛ t' Evropɛs, tɛ eilɛt nisnɛ mɛ njɛ herɛ tɛ pregatiteshin per tɛ vajtur nɛ lufte kunder Turqvɛ Selxhukɛ. Nga çdo vent i Evropɛs arrinin trupa ushtaresh, tɛ eilɛt u-qúajtnɛ *Kryqtarɛ*, mɛ qɛ eilidó nga atá mbantɛ njɛ kryq tɛ vogɛl tɛ qepur nɛ robat e tij. Trupat e bashkúara hiqnin pastáj per nɛ Jerusalém. Kető levizje prej Evropɛ nɛ Jerusalém quhen *Kryqesata*. U-benɛ shtatɛ kryqesata tɛ ketilla qɛ mɛ 1103 gjer mɛ 1328, dhe shumɛ prej ketyre kryqtarevɛ shkuan permés Shqiperisɛ dykɛ udhetuar per nɛ Jerusalém. Qyteti i shenjtɛ i tɛ Krishterevɛ rá

në duart e kryqtarëve që në të paren kryqëzatë, po atú s' qenë të zotërit që t'a mbanin për shumë kohë, se u-zunë në mes të tyre. Në zëmën e qytetit, kryqtarët u-suall aqë barbarisht saç ishin sjellë më parë Selxhukët.

Njëra nga këtó kryqëzata, e *katërta*, ka një rëndësi të veçantë për Shqipërinë, siç do të shohim më poshtë.

PËRMBLEDHJE

(Për të mësuar më gojë)

1. Perandoria romane të cilën Diokletiani e kish ndarë me dysh, për të lehtësuar qeverimin e saj, bashkohet përsëri nga Kostandini e Math, i cili e ngriti kryeqytetin që nga Roma në Kostandinopojë. Pak më von, (395), perandoria romane ndahet përsëri dhe për të funtmen herë në dy copë: në Perandorinë Bizantine, me kryeqytet Kostandinopojën, dhe në Perandorinë e Perëndimit me kryeqytet Romën. Perandoria e Perëndimit humbet dhe çfaqet më 476 pas Kr. kur Gjermanët muar Romën.

2. Valët e barbarëve çfryjnë dhe mbytin tërë Europën, me të gjith' ato. Shqipëria shkelet prej një sërë barbarësh. Të parët që shkelë Shqipërinë ishin *Gotët*, fis gjermanë, po *Justiniani* i nxori nga Shqipëria më 535, dhe forcoj kufirat e saj.

3. Më pas vijnë *Hunët*, të cilët zbohen prej *Avarëve*. Perandori Herakli dërgon *Serbët* që të nxjerin Avarët nga Shqipëria dhe, si shpërblim, i le që të kapsin nga ajó vendet që ka sot Mali i Zi, Bosnja dhe Serbia (640).

4. Më 861 Shqipëria shkelet prej Bullgarëve, të cilët lanë si për kujtim një sërë emrash bullgarë në shumë vise të Shqipërisë dhe një numur Bullgarësh që kanë mbetur gjer sot.

5. Më 1081 *Normanët*, të cilit ishin nisur në krye që nga *Skandinavia*, shkelin Shqipërinë e Mesme dhe të Poshtme duke u-bedhur që nga Italia.

6. Këto shkëlje të barbarëve mbytnë qytetërimë e cila kish nisur të lulëzonte në Shqipëri që në kohën e Romanëve.

7. Kur u-mbaruan shkëljet dhe luftа barbare, nisi n' Europë një levizje e re, *levizja e kryqëzatave*, e cila kish për qëllim çlirimin e Jerusalemit nga Selxhukët Turq, të cilët nuk linin të Krishterët që të vinin të falëshin në varrin e Krishtit. Selxhukët Turq kishin abuar q' andej Sarakenët, Arabët Mohamedanë, q' i-shin shumë të qytëtëruar.

PYETJE PËR STËRVITJE

1. Cili dhe përse e ndau në krye perandorinë romane me dysh?—Kur u-bashkua përsëri dhe cili e bashkoj?—Ç' ndryshime solli Kostandini i Math në perandorinë romane?—Cili ish *Bizanti* dhe cila Konstandinopoja, e përse u-quajt kështu kŷ qytet?—Kur u-nda më dysh e për të fundmen herë perandoria romane?—Cilët ishin kryeqytetet?—Ç' ngjau në vitin 467?—Kush e rrëzoj perandorinë romane të perëndimit dhe kush e mori Romën?—Cilët ishin Gjermanët dhe ku rrojnë më parë?—Me ç' anë mbet Shqipëria pas ndarjes së perandorisë romane? Cila .ishte *Perandoria Bizantine* dhe përse quhet ashtu?

2. Ç' pësoj Europa në kohën e renies së Romës?—Ç' pësoj Shqipëria?—Cilët e shkelë Shqipërinë më parë?—Cilët ishin *Gothët*?—Kush edhe kur e shpëtoj Shqipërinë nga Gothët—Cili ish dhe nga ish *Justiniani*?—Ç' bëri Justiniani për Shqipërinë?—Cilët ishin *Avarët* dhe kush i nxori jashtë nga Shqipëra?—Cili ish *Heraklí*?—Ç' i muarë Shqipërisë Serbët?—Ku gjendeshin Serbët n' atë kohë?—Kish më parë Serbë afër Shqipërisë?

3. Kur e shkelë Shqipërinë Bullgarët?—Që kur janë në Shqipëri vendet e ndenjura prej Bullgarësh dhe vitet që kanë emrin bullgarë?

4. Cilët ishin Normanët, që nga ishin nisur në krye-përse dhe kur e shkelë Shqpërinë?—Ç' vise kishin zë-në më parë se të hidheshin në Shqipëri?

5. Ç' pësoj Shqipëria nga këto shkëlje?—Ç' pësoj qytetërimi dhe përparimi i saj?

6. Ç' ishin kryqesatat?—Ç' ishin *kryqtaret?*—Perse quheshin ashtu?—Ç' ishin shkaket qe shtytne Europen ne keto kryqesata?—Cilet ishin *Sarakenet* dhe ç' fare lloj populli ishin?—Si shkonin Sarakenet me te Krishteret?—Kush e kish me pare Jerusalemin dhe kush pastaj?—Cilet ishin *Selzhuket?*—*Si silleshin* Selzhuket kundrejt te Krishtereve?—Ç' kane te bejne kryqesatat me Shqiperine?

KËNDIME

MESJETA—Qe motin qe ra Roma ne duart e Gjermâneve, 476 pas Kr., nis nje periudë e re e historise, e cila quhet *M e s j e t ë*, osé *Kóhcrat e Mesme*. Mesjeta mbarój me rénien e Konstantinopojes ne duart te Turqve, 1453.

Qe te kuptoni mé mire kete ndarje, le te shkojme pak se si ndahet pergjithersht historia. Ndarjet kryesore te historise jane tri:

I. HISTORIA E VJETËR, e cila nis qe ne kóhcrat qe s' mbahen ment dhe gjer ne vitin e rénies se Romes, 476 pas Kr., siç shenuam mé siper.

II. HISTORIA MESJETARE, qe me 476 gjer me 1453.

III. HISTORIA E RE osé MODERNE, qe nis qe me 1453 dhe mbarón ne ditet tona.

Po, siç thame mé siper, ketó jane ndarjet kryesore te historise, se ka edhé nenendarje te cilat s' eshte nevoje qe t' i kujtojme beperhé.

Arcsya per te cilen periuda qe me 476 e gjer me 1453 u-quajt *Mesjete osé Kóhcra te Mesme* eshte se, ashtú siç shkoni dhe vete, kjo eshte *periuda e mesme* e historise se njerezise.

Mesjeta ka edhé një emer tjeter: *Kóhera t' Errcta*, dhe quhet keshtú sepsé pas rénies se Romes, 476, nisne shkeljet e barbáreve te cilet pothua shojtne krejt qyteterín' e mepáreshme te Románeve e te Grékeve, dhe bota ra n' *erresáre*. Ne kohen e Mesjetes, njerezia harruan mjeshteritc, dituritne, shkencat dhe artat e vjetra, dhe pothua se u-kthyen perseri ne jeten barbare. Shkolla s' kish mé, ashtú si kishin qene mé pare shkollat e shkelqéera te Greqise se vjeter e te Romes; libra s' dilnin mé, osé s' kish mé shkrimtare, as kendonjes. Njérezit e mesjetes kishin rene mé teper pas fese, siq tregojne *kryqesatat*.

Po kjo nuke dó te thote se qyteteria ishte shojtur krejt; jo, as fare; qyteteria kish rene vetem ne lengim, ish mbulnar ashtú si mbulohet zjarri me hí, dhe pak nga pak zuri te dilte perseri ne eheh, keshtú qe ne mbarim te Mesjetes, njerezia muar prape udhen e qyteterise, te cilen e prune ne shkallen e larter qe gjendet sot.

III
PRINCIPATAT E LIRA SHQIPTARE

1.—Despotati i Epirit

Sikunder thame mé siper, kryqesata e katert ka një rendesí te veçante per Shqiperine, dhe ja se persé:

Me 1202 u-nisne ushteritc qe perbenin kry-

qesatcn e katert, dhe njc tok i tyre shkoj ncpér Durrcs, ku ndenji edhé mjaft kohe. Pastáj, i bashkuar me togjet e tjere, tc gjithe hoqne per ne Konstantinopojc, dyke dashur qe tc shkonin permés Anadollit dhe t' arrinin me steré ne Jerusalém. Po ne vent qe tc mbaronin udhetimin e tyre, kryqtárcve u-mbetne syte ne bukurite dhe pasurít' e Kostantinopojes. E zune, pra, keté qytét per vete, rrezuan nga froni perandorin qe mbreteronte n' até kohe, i cili ish nga femija e *Komnénéve*, dhe ne vent te tij vune njc nga kapedanet e tyre (1204).

Po njc nga princerit e femijes mbreterore te Komnénéve, i qúajtur *Mihaíl Engjelli*, mundi te shpetonje e t' ike nga Kostantinopoja, arrijti ne Seleník, mblodhi atjé rreth tij kreret e Shqiperisc, dhe tok me tá u-hoth ne Janine, ku themelój njc principate shqiptare, e cila u-quajt *Despotát i Epirit*. Pak nga pak, Mihaíl Engjelli, si edhé atá q' erdhe pas tij, kur vdiq aý, e zgjeruan principaten e Epirit dyke i shpenc kufiret gjer ne Durres, Ohrí, Perlép, nga veriu, e gjer ne Thesalí, nga juga.

Ne keté kohe u-derthne edhé njc here Bullgaret per te zene Shqiperine, po princerit e Epirit e qendruan sulmen e tyre.

Pak mé von, kryqtaret u-zbuan nga Kostantinopoja, dhe u-kthye perserí ne fronin femija e vjeter mbreterore. Perandori i ri kerkój ahere qe principata e Epirit te bashkohej nené kurorcn

e tij, siç kish qenë edhé mé parë, po princi i Epirit u-kunderrohtua me përkrahjen e ushtërisë së tij shqiptare, dhe Despotati i Epirit mbet i lirë gjer në vitin 1358.

Me themelimin e kësáj principate, Shqipëria nisi të çkëputej përfundërísht nga Perandoria Bizantine, e cila, nga ana tjetër, s' kish as mé parë nonjé kontróll të math përmí Shqipërinë.

2.–Mbretëria Shqiptare Angjevine

Nukë shkoj shumë kohë kur edhé një pjesë tjetër e Shqipërisë, Shqipëria e Mesme, u-çkëpút nga perandoria bizantine.

Për të forcuar vendin e tij e për të patur miq të fortë që t'a ndihmonin kur të kish nevojë, *Despoti* osé Princi i Epirit Mihaíl Engjélli II martój të bijën, Helenën, me një nga mbretrit e shumë që kish aherë Italia, i cili quhej *Manfred*, i biri i perandorit të Gjermáneve dhe mbret i Napolit dhe i Sicilisë, dhe si pajë i dha të drejtë që të zinte pjesën mé të madhe të Shqipërisë së Mesme, si Dúrrësin, Vlorën, Beratin, Himarën, etj. Po pak mé von, Manfredi hyri në luftë me *Karolin* e *Angjevinëve*, i cili ish një prinë Normán i Italisë. Manfredi u-vra në këtë luftë, dhe Karoli i Angjevinëve hyri në marrëveshje me krerët e Shqipërisë së Mesme dhe me pëlqimin e tyre zuri tokat që kish marrë mé parë Manfredi si pajë të së shoqes së tij. Me këtë mënyrë, u-fillua në Shqipëri të

Mesme një mbretërí e veçantë e cila u-quajt "Mbretëri Shqiptare" e Angjevíneve. Dyke qenë se Karoli ish shumë i fortë, princi i Épirit u-shtrengua mé von që t'a njihte per *kryezót* të tij.

3.—Femija e Balshave

Angjevinet nuke qendruan dot shumë kohë në Shqipëri, se Serbet nisnë të levisnin perserí dyke u-mundnar që të zgjeronin kufiret e mbretërisë së tyre, e cila aherë permblidhej në Mal të Zi dhe në Bosnje. Fuqia serbe arrijti kulmin kur hipi në fron *Stefán Dushani*. Ky mbret i shkëlqyer i Serbisë mundi të zerë jo vetëm tërë Shqipërinë, të cilën, me gjith até, e kish lënë prapë në duart e krérëve vendës, po u-zgjat edhé gjer në Greqí.

Po mbretëria e tij e madhe s' mbajti mé teper se njezét e kater vjet, dhe kur vdiq Stefani vdiq dhe perandoria, që kish ngrehur ay, dyke u-copëtuar (1331-55). Me vdekjen e tij tokat u-ndanë në mes të qeveritárëve dhe krérëve që kish emëruar Stefani si zyrtarë të krahinave të ndryshme. Një nga këtá qeveritarë, ay që qeveriste krahinën e Shkodrës n' emer të Stefán Dushanit, ish fílis i femijes së *Balshave* e cila kish erdhur në Shqipëri në kohën e Angjevíneve. Femija e Balshave ish frenge nga kombësia, po në këté kohë ish përzjerë me Shqiptarë.

E taní, me vdekjen e Stefán Dushanit, që-

veritari i Shkodres e beri até krahine nje principate te lire dhe aý vete mori émerin *Balsha I*, qe te tregonte qe s' varrej nga nonjé tjeter. Me keté menyre, u-çkepút edhé Shqiperia e síperme nga perandoria bizantine dhe u-be nje principate shqiptare e lire.

Me ndihmen e princerve dhe krêreve vendes, Balshajt muntne te zgjeronin principaten e re, dyke zene tere Shqiperin' e Veriut, Shqiperín' e Mesme dhe nje pjese te Shqiperise se Juges. Balshajve u ndihmój shume krushqia qe bene me *Karl Topien*, princin shqiptár te Krujes, i cili ish nje nga burrat mé te shenuar te Shqiperise ne keté kohe. Po miqesia ne mes te Karl Topjes e te Balshave nuk mbajti shume kohe, se Balshat i rane mé te funt ne qafe edhé vete Karl Topjes, i cili u-shtrengua qe te leshonte Durresin te cilin aý kish nje kohe shume te gjate qe po e mpronte kunder te hûajve, Angjevíneve dhe Sérbeve. Me marrjen e Dúrresit, Balshat vune ne dore tokat qe lakmonin.

4.—Gjin Bua Shpata

Ne kohen qe Karl Topja po hahej me Balshat ne Shqiperi te Mesme, nje prine tjeter Shqiptár *Gjin Bua Shpata*, zot i Gjinokastres, kish nieur nje hafte tjeter ne Shqiperi te Juges.

Mé síper shenuam se Despotati i Epirit mbet si nje principate shqiptare gjer ne vitin 1358. Ne

këtë mot Despotati u-nda ne disá krahina, dhe ne krye te e'lesló prej tyre ish njc i parc osé princ shqiptár. Krahinat mé te shendara ishin *Arta* (Narta), te cilen e kish shtirc ne dore *Pjeter Losha*, njc burrc shume trim dhe i zot!, dhe *Gjinokastra*, zot i te cilcs u-be femija e *Shpatajve*. Nga Shpatat mé i zoti dhe mé i çquar dolli *Gjin Bua*, i cili nisi te zgjeronte principaten e tij dyke marre mé parc krahinen e Artes nga Loshajt. Qe nga Arta, Gjin Bua Shpata u-unj poshte ne krahinat e Greqise dhe dyke leftuar lúftera te repta kundra Grékeve arrijti gjer n' Athine me Shqiptaret e tij. Krahinat greke ndenjne keshtú nenë Shqiptaret njc kohe te gjate. Po ne vent qe te kthébeshin prapc ne Shqiperi, passi mauntne Greket plotcrisht, pasaniket e Gjin Buc Shpatcs u-shtruan vete dhe ndejne ne viset greke qe kishin zenc, dyke u-vendosur mé teper ne qarkun e Athines ku gjenden édhe sot. Njc nga ató fshatra shqiptare t' Athines quhet *Shpate* per kujtim te trimit shqiptár qe i shpuri atá Shqiptarc gjer atjé, dyke dermuar Greket.

Shqiptaret e qarkut t' Athines flasin édhe sot shqip dhe mbajne édhe zakonet e Shqiperise, po, per fat te keq, kane harruar kombesin' e tyre dhe Shqiperine.

Veç ketyre Shqiptáreve t' Athines, jane edhé shume vise te tjera te Greqise te ndénjura prej Shqiptaresh, nga te cilat ató mé me rendesí jane nisite *Hydra*, *Spetze*, *Kullari* osé *Salamine* dhe

Poros. Ashtú si Shqiptarct e qarkut t' Athinës edhé Shqiptarct e ketyre nisive flasin shqip édhe sot e kesáj dite, po nc gjashtc qint vjetet qc kanc shkuar q' ahere e humpnc ndjenjcn e kombesisc dhe e harruan Shqiperinc.

PËRMBLEDHJE

(Tc mesohet me goje)

1. Kryqtaret qc perbenin kryqesaten e katert zunc Konstandinopojen dhe rezuan nga froni perandoris bizantin. *Mihail Engjelli*, nje nga princerit e fenjes mbretcrore, u-hoth nc Janinc dhe me ndihmen e Shqipetareve themeloj Despotatin e Epirit me 1204. Principata e re leftoj fitimisht kunder Bullgareve dhe perandorit tc Bizantit. Kjo ish e para toke shqiptare q' u-çkeput nga perandoria bizantine.

2. Princi i Epirit beri krushqi me Manfredin, mbretin e Napolit dhe tc Sicilisc, dyke i dhenc si paje tc drejten qc tc xinte Shqiperin' e Mesme. Po Manfredi u-mund prej *Karolit t' Angjevinevc*, i cili zuri Shqiperin' e Mesme me pelqimin e krereve tc vendit dhe themeloj "Mbretcrinc Shqipetare" t' Angjevinevc. Keshtu keputet nga perandoria bizantine edhe nje pjesc tjetcr e Shqiperisc.

3. Angjevinet humpnc Shqiperin' e Mesme, nga shkaku se Serbet nisnc tc zgjeronin vendin e tyre, dhe nenc *Stefan Dushanin*, muntnc tc zenc tcrc Shqiperinc. Po me vdekjen e Dushanit, perandoris e tij u-coptua.

4. Nje nga femij' e Balshavc, i cili kish fituar nga Dushani tc drejten qc tc qeveriste Shkodren bchet princ me vete, pas vdekjes se Dushanit. Pak nga pak Balshajt zgjeruan principaten e tyre, dyke pushtuar Shqiperin' e Veriut dhe Shqiperin' e Mesme, si edhe nje pjesc tc Shqiperisc, sc Jugos, dyke u-ndihmuar edhe prej *Karl Topjes*, i cili ish zot i Krujes. Po me nc funt zihen edhe me Karlin tc cilit i marrin Durresin.

5. Despotati i Epirit merr funt dhe përçahet. *Gjin Bua Shpata*, zot i Gjinokastres merr Artën nga Pjetri Losha dhe nis luftë më Grekët të cilët i mundi në çdo përpjekje dhe zbret gjer n' Athinë. Shqiptarët q' i vanë pas u-vendosën në qarkun e Athinës ku janë edhe sot e kësaj dite. Një tok nga ata Shqiptarë zuri ishujt *Hydra, Spetsë, Kullurí dhe Poros.*

PYETJE PËR STËRVITJE

1. Ç' ka të bënjë kryqëzata e katërt me Shqipërinë?—Ç' pësoj Kostandinopoja nga kryqtarët?—Si quhej familja që mbretëronte atë kohë?—Cili ish Mihail Engjelli dhe ç' bëri?—Ç' është Despotatí i Epirit dhe si e kur u-themelua?—Ç' bënë Bullgarët në këtë kohë?—Ç' kërkonte të bënte perandori bizantin kur e mori prapë fronin? Si u-përgjegj Princi i Epirit?—Ç' rrodhi ka për Shqipërinë themelimi i kësaj principate?

2. Cili ish Mihail Engjelli II dhe sá u-mundua që të forconte vendin e tij?—Cila ish Helena?—Ç' pajë mori kur u-martua?—Me cilin u-martua?—Cili ish Karoli i Angjevinëve dhe ç' bëri?—Si e zuri Shqipërin' e Mesme?—Ç' ish "Mbretëria Shqiptare" e Angjevinëve?—Qysh Karoli u-bë kryezot i Epirit?

3. Si e humbnë Shqipërin' e Mesme Angjevinët?—Ç' po bënin Serbët në këtë kohë?—Cili ish Stefan Dushani?—Ç' bëri dhe gjer ku e zgjati mbretërin' e tij? Sa kohë mbajti mbretëria e tij dhe ç' u-bë pas vdekjes së tij?—Cilët ishin Balshat dhe ç' punë kishin?—Kush u a kish dhënë atë punë?—Ç' bëri Balsha I?—Gjer ku u-zgjat principata e tij?—Kush i ndihmoj Balshat—Cili ish Karl Topja?—Mbeti shumë kohë mik Karli me Balshajt?— Përse u-zunë?

4. Kur mori funt Despotati i Epirit?—Ç' ngjau pastaj?—Cili ish Pjetër Losha?—Cili ish Gjin Bua Shpata? Ç' bëri Gjin Bua?—Ç' bënë Shqipëtarët që vanë me Gjin Buën gjer n' Athinë?—Që kur janë rreth Athinës dhe sa kohë kanë që janë atje Shqiptarët?—Ç' farë gjuhe flasin sot?— Përse u-quajt *Shpata* ay fshati në qarkun e Athinës?— Ç' janë Hydra, Spetsë, Kullurí, dhe Poros dhe prej cilëve janë të ndënjura?

IV
SHQIPERIA E REPUBLIKA VENETIKE

1.–Pushteti i Venetisc

Kini parc nonjć here pará tc vjetra tc cilat quhen "venetike"? Nc mos kini parc pyetni dhe do t' ju refejnc se ç' lloj monedhe janc ketó *venetike*. Jo shumc kohc mć parc, ndofta edhé sot, çupat e fshátrave tc Shqiperisc mbanin nc qafc gjerdhanc tc perbercc prej venetikesh, tc cilat kanc njc ngjyrc tc ndritshme si tc arit, po nuk' janc ar. Po veç kesáj monedhe, po tc ndodhet qc tc vini nonjé here nc Gjinokastrc, nc Durrcs a nc Berát, si edhé nc disá vise tc tjera t' anedetit tc Shqiperisc, do tc shihni disá mure prej tullash tc kuqe rreth qytetit, dhe kur tc pyesni se ç' janc do t' ju thonc qc janc *mure* osé *keshtjella* (kalá) *venecïane* osé *venetike*.

Po ç' kerkojnc ató pará dhe mure venetike nc Shqipcri? Do tc mesoni per pak se ç' kerkojnc dhe persé gjenden nc Shqipcri, po mć parc duhet tc shohim se ç' ish kjo *Venetí*, osé *Republike Venetike*.

Nc funt tc njerit nga tc dy gjiret qc ka Adriatiku n' anen e tij tc síperme gjendet qyteti i sotmc italián qc quhet *Venezia* (shqip kendohet *Venécia*). Aý eshtc qyteti qc ish njc here qendra e *Republikes Venetike*, e cila u-themelua me ketć menyrc:

Ne shékullin e gjashte, (500 pas Kr.), nje nga fiset gjermane, *Lombardet*, shkelne Italine dhe bene romaje te madhe, dhe shume femije te Romes se vjeter u-futne per mprojtje ne te 118 nisite, prej te cilave perbehet qyteti i Venetise, dyke qene se atje s' munt te afróheshin aqe lehte Lombardet. Vendi i ketij qyteti te fshehur ne gjirin e Adriatikut ish prej natyre fort i volitshem per tregeti, dhe femijet romane q' u-vendosne atjé, si edhé femijet e tjera qe vane mé von, hapne nje tregti te madhe me te dy anet e detit Adriatik, e ne pak kohe Venetia u-be nje qender tregetare qe s' kish shoqe n' até det. Pak nga pak, tregetaret e Venetise hapne dyqane dhe magazera ne skelat e ndryshme t' Adriatikut, e gjith' ashtú, pak nga pak, dhe me anen e tregetise, Venetia zgjerój vendin e saj dyke shtene ne dore buzen e detit Adriatik gjer ne kafiret e Shqiperise, pastáj zuri nisite ioniane, Korfuzin dhe nisít' e tjera qe vijne pas Korfuzit, *Kreten* (Gjiritin) dhe mé ne funt u-zgjat edhé n' Anadóll. Me pak fjale, Venetia vuri ne dore detin dhe tere udhet e tregetise, dhe nuk' shkoj shume kohe kur zuri t' u vertitej edhé skélave te Shqiperise, si Dúrresi, Leshi, Vlora, etj., etj., te cilat mé ne funt i vuri ne dore. Nga ana tjeter, me 1172, pópulli i Venetise vendosi te kete nje qeveritár te zgjedhur prej tij; ky qeveritár quhej *Duke*, dhe kish afer tij nje Keshille te madhe prej 480 vetash, bashke me te cilet qeveriste púnerat e Venetise. Sig shekoni, ne Veneti

qeveria gjendej, pak a shume, ne duart e popullit dhe perandaj quhet *Republike Venetike*, ashtú siç kish qene edhé Roma mé pare.

Ajó qe desh te bente Republika Venetike ish te zinte vendin e Romes se vjeter, dhe keté qellim e arrijti, gjer me nje pike.

Pak mé tutje do te shkojme sa roll te math lojti kjo republike ne púnerat e Shqiperise.

2.—Feudalizmi ne Shqiperi

Ne kendimin qe kini here gjer tani nofta te jini quditur kur gjette fjalen "zot" i kesáj osé i asáj krahine, si Gjin Bua Shpata q' ish *zot* i Gjinokastres, si Karl Topja q' ish *zot* i Krujes; perseri pate me nje vent ku thame se Karoli i Angjevinove u-be "kryezót" i Epirit; pastáj u-be fjale edhé per "kreret" dhe "princerit" shqiptare, gjera per te cilat kam frike se nuk' i kini kuptuar se ç' do te thone. Tani, pra, erdhi koha qe te mesoni se ç' ishin keté *zoter, kryezoter, krere* dhe *princer* te Shqiperise.

Afró per nje mije vjet, dyke nisur me shékullin e nente (800 pas Kr.), popujt e Evropes qeveríseshin me nje forme qeverimi e cila quhet *feudalizme*. S' eshte gje e lehte te kuptoni sot se çdo me thene feudalizme, po do te mundohem t' ju jap te kuptoni me sa te jete e mundur. Pas rénies se perandorise romane, shkeljet e barbáreve e kishin sjelle Evropen ne nje pike t' atille qe

qeverit' e ndryshme s' kishin fuqi qe te mpronin pópullin dhe aý q' ish mé i forte i binte gjithenjé me qafe atij mé te dóbetit, keshtú qe shumica e pópullit s' kish shigurí as per jete, as per mall, as per nder, se dilte nonjé kapedán i forte—dhe kapedane te ketille kish me qindra e me mijera —dhe i merrte jeten, mallin e nderin fshatarit te dobet, i cili s' kish asnjé menyre qe te mprohej kundra ketyre hajdúteve me çizma, se thame mé siper, qe qeverít' e ndryshme ishin rezuar prej shkëljeve te barbáreve; po edhé atjé ku kish qeveri, ajó qeverí s' kish fuqí te mpronte pópullin.

Perandáj, tani u-çpik nje forme e re qeverimi: atá qe s' kishin fuqí te mjafte sa te mpronin veten dhe mallin e tyre, dhe ne keté gjendje ish shumica e pópullit, vinin i fáleshin dhe i binin ner kembe fqinjit te tyre mé te forte, i cili mbante nje keshtjelle per veten e tij, me fjale te tjera *beut* mé te forte t' atij qarku. Beu zotohej qe te mpronte me fuqine dhe me njérezit e tij njerine q' i binte ner kembe, dhe ky njerí zotohej qe t' ish i bindur tek beu, t' i pagúante nje pagese me regull, t' i vinte pas si ushtár ne kobe lufte, dhe t' i bente sherbime te tjera. Ky bej quhej zot i njéresve qe i kishin rene ner kembe. Po aý i forti s' ish i vetem, se kish edhé njeres te tjere q' ishin mé te forte se aý dhe munt t'a merrnin nepér kembe kurdohere qe te deshin. Keshtú, edhé aý i forti shtrengohej qe t' i falej nje mé te forti, dyke u-zotnar qe t' i pagúante nje pagese me regull e t' i

bente sherbime te tjera. Dhe tani, ky mé i forti quhej *kryezót* i atij tjetrit qe quhej *zot*. Po edhé *kryezoti* vete kish shume here nje mé te forte me koke, si mbreti, dhe perandori, dhe ky mbret a perandór bchej *kryezót* i *kryezóterve*.

Kesáj menyre, qe mé i dóbeti hyute nené mprojtjen e nje mé te forti, i thone *feudalizme*, dhe atá q' ishin mé te forte qúheshin me nje emer "krere feudale". *Prine* ish nje titull qe u jepej krérreve feudale q' ishin mé te forte dhe kishin mé teper njeres pas tyre.

Kur erdhe, pra, Normandet dhe Angjevinet ne Shqiperi, e suall edhé ne vendin tone keté forme qeverimi, dhe Shqiptaret zune te benin edhé atá ashtú siç benin popujt e tjere t' Evropes, domethene edhé Shqiptaret pranuan *feudalizmin* si forme qeverimi.

Mé siper pame se si muarr funt principatat e lira, si Despotati i Epirit dhe "mbreteria shqiptare" e Angjevineve; pak mé von, mori funt edhé principata e Balshajve, dhe tani Shqiperia u-nda pas menyres feudale. Gjith' ashtú, pame se femija e Shpátave, nga e cila dolli Gjin Bua Shpata, mori krahinen e Gjinokastres dhe qe Gjin Bua u-be zot i kesaj krahine; Pjetri Losha u-be zot i Artes. Karl Topjen e pame q' ish *zot* i Krujes. Dyke u-çdukur femija e Balshave me 1395, vendet qe kish ajó, u-ndane ne mes te feudáleve shqiptare, ne mes te cileve do te knjtojme vetem disá: *Dukagjinet*, q' ishin zoter te *Pejes* (Ipekut)

dhe të një pjesë të madhe të Shqipërisë së Sipërme; *Muzakat* ishin zotër të Shqipërisë së Mesme, rreth e rrotull Myzeqesë; *Zakariat* dhe *Dushmanet* kishin malcsít' e Shqipërisë së Sipërme; shtëpia e *Arianitëve* ishin princer të Kaninës dhe Himarës. Këtó janë vetëm disá emra, se múmuri i zótërve dhe i princerve shqiptarë ish shumë i math. Le të shtojmë vetëm që nuk' shkoj shumë kohë dhe vendin e shtëpisë së Topjave në Krujë e zuri shtëpia e *Kastriótëve*, si princer t' asáj krahine.

Nga ana tjetër, Republika Venetike kish shtënë në këtë kohë në dorë ékelat më të mira të Shqipërisë, si Leshin, Dúrrësin, Vlorën, e të tjera, si *zotnesha* e tyre, domethënë që i mori nënë mprojtjen e saj, po qellimi i saj i parë ish tregtia.

Siç shëkoni, gjer në këtë pikë zotrit dhe princerit shqiptarë s' kishin édhe nonjë *kryezót*.

3.—Feudalet Shqiptarë dhe Venetia

Po nukë shkoj shumë kohë kur vetë feudalet Shqiptarë ndjenë nevojën për një *kryezót* dyke parë rrezikun e tmerrúar që po i afrohej Shqipërisë.

Ky rrezik vinte nga *Turqit Osmanllinj*, të cilët arrijtin në këtë kohë në kufirët e Shqipërisë.

Le të shohim se ç' ishin këtá Turq Osmanllinj dhe ç' kishin bërë gjer në këtë kohë.

Turqit Osmanllinj ishin sulur në krye që nga Turqestani i Asisë, dhe ishin prej një gjaku me *Turqit Selxhukë*, nga shkaku i të cilëve, siç pamë,

u-bene *kryqesmat*. Edhé ketá, ashtú si edhé Selxhuket, ishin nje popull barbár dhe te vétemen te mire qe kane patur eshte trimeria e madhe po e verber me te eilen leftonin dhe fituan aqe lúftera. Ky fis i Turqve quhet *Osmanlli* nga nje Sulltán i pare qe kishin i eili quhej *Osmán* osé *Otlmán*, dhe i eili themelój te paren mbreteri turke n' Asi te Vogel. Q' andéj u-nisne per te pushtuar anadollin e tere dhe ne shékullin e 14te (1300) kaperxyen Dardanelet (Çanák-Kalé) dhe zune Thraken dhe Adrianopojen, te eilen e bene kryeqytetin e tyre, kursé perandoria bizantine s' kish fuqi qe t' i kundershtonte. Ne funt te gjith' ketij shékulli, Turqit u-shtrine nga ana e Serbise, dhe ne fushen e Kosoves, afer Prishtines, u-goditne me Serbet, te cilet ndihmóheshin edhé prej nje ushterie shqiptare nené Balshen II, dhe fituan nje beteje te madhe, (1389) e eila eshte e njojtur n' histori me emrin *Beteja e Kosoves*. Ne keté beteje te madhe, u-vra edhé mbreti i Sérbeve edhé Sulltán Murat I i Turqve, varri i te eilit gjendet édhe sot e kesáj dite n' até vent.

Pas kesáj beteje, Balsha u-kthye me Shqiptaret ne vendet e tij, po edhé atjé e ndoqne Turqit.

Te tronditur e keq te trembur nga ky rezik i ri dhe aqe i tmerrnuar, feudalet shqiptare nisne tani te mejtóheshin se qysh munt t' i benin ballé. Vete atá, dhe pa nonjé perkrahje te jashtme, s' munt t' u qendronin túrmave dhe miserive te Turqve. U dubej, pra, nje ndihme dhe perkrahje

e jashtme, dhe nuk' desh shumε ment qε tε gjenin se s' kish tjeter shtet i cili munt t' u jepte até ndihmε dhe perkrahje pεrvéç Republikεs Venetike, e cila ish ahere Shteti mé i fortε n' até perqárk.

Njε nga njε, pra, princerit dhe zotret shqiptarε iu-kthyen Venetisε, kεrkuan pεrkrahjen e saj dhe e njojtin pεr *kryezotneshε* tε tyre.

PεRMBLEDHJE

(Tε mεsohet me gojε)

1. *Venetia*, e cila mé von u-bε Republikε, dykè u-qúajtur *Republikε Venetike*, u-themelua nε shékullin e gjashtε prej fεmijεve romane qε u-vendosnε atjé dyké shpetuar nga shkelja e *Lombardεve*. Pak nga pak Venetia arriti tε verε nε dorε detet, dyké zenε skelat mε tε shεnuara, mε anεn e tregetarεve tε saj. Nga skelat e Shqiperisε Venetia kish Leshin, Dúrresin, Vloren e tε tjera. Republika Venetike qεverisej prej njε *Dukε* dhe njε keshillε tε madhe.

2. Kur u-rrεzuan dhe u-ndanε principatat e lira tε Shqiperisε, vendi u-nda nε mes tε *zóterve e princerve* Shqipetare, tε cilεt quhen me njε emεr *feudale*. *Feudalismi* u-ngjall n' Evropε nε kohen qε shkeljet barbarε lanε qεverit' e ndryshme pa nojnε fuqi qε tε mpronin popullin, i cili u-shtrengua t' u falej dhe tε kεrkonte mprojtjen e atyre q' ishin mé tε fortε, dhe tε cilεt i njihnin pεr *zoter*. Po edhé *zotrit* ishin tε shtrenguar shumε herε qε tε kεrkonin njε mprojtje mé tε fortε nga *kryezotet*. *Normanet* dhe *Angjevinet futnε nε* Shqiperi *sistemin feudal*.

3. Nga *feudalet* shqiptare, me tε fortet ishin *Shpatat e Gjinokastres*, *Dukagjinet* e Pejes dhe tε Dukagjinit, *Muzakat* e Myzeqesε, *Arianitet* e Kaninεs dhe tε Himarres dhe *Kastriotet e Krujes*.

4. Nε funt tε shékullit tε katεrmbεdhjetε, (1300), u-dukne pεr tε parεn herε afεr kufirεve tε Shqiperisε *Turqit Osmanllinj*, qε quhen ashtu nga

Sulltan Osmani qe themeloj te parën mbreteri turke ne Asi te Vogel. Me 1389, ngjau *beteja e Kosoves* ne mes te Serbeve dhe te Turqve, ne te cilen muar pjese dhe Shqiptaret. Turqit mundohen per te parën here qe te hyjne ne Shqiperi.

5. Feudalet Shqiptare njohin Republiken Venetike si kryezotneshe te Shqiperise, q' ashtu te kene krahe nga ajo per te qendruar kunder Turqve.

PYETJE PËR STËRVITJE

1. Ç' jane "venetikat" dhe muret e koshtjellat "veneciane" dhe ç' ishte arceya qe kane mbetur ne Shqiperi?—Cila ish Venetia, si, kur edhe prej kujt u-themelua?—Cilet ishin Lombardet?—Ç' pune zane te benin Venecianet dhe gjer ne ç' pike arrine?—Gjer ku e zgjati fuqin' e saj Republika Venetike?—Perse quhej republike dhe si qeverisej?—Ç' ndryshim ka qeverimi i Venetise nga ay i Romes se koherave te para?—Si e quanin qeveritarin e Venetise?—Ç' skela shqiptare zuri me pare Venetia?

2. Ç' kuptoni me fjalet "zot", "kryezot", "prine"? Ç' ishte *feudalizmi* dhe ku e kur u-ngjall?—Cilat ishin shkaket qe ngjalle feudalizmin?—Cilat jane shkallet e feudalizmit?—Si behej zot dhe *kryezot* nje njeri?—Ç' te drejta fitonte *zoti dhe kryezoti?*—Kush e solli ne Shqiperi feudalizmin?

3. Ç' ngjau ne Shqiperi pas çdukjes se principatave te Epirit, te mbreterise shqiptare, t' Angjevineve dhe te Balshave?—Numeroni disa nga feudalet me te forte te Shqiperise.—Te ç' vendi ishin zotet *Muzakat, Araniteet, Dushmanet, Zakariat, Dukagjinet, Kastriotet. Republika Venetike?*

4. Cilet ishin Turqit Osmallinj?—Cili ish Osmani dhe ç' beri?—Kur e zune Turqit Thraken dhe Adrianopojen?—Ç' bente perandoria bizantine ne ketë kohe?—Ku e kishin kryeqytetin Turqit?

5. Kur u-be *Beteja e Kosoves?*—Kush e kush leftoj ne këte beteje?—Ç' ngjau per Shqiperine pas kesaj?—Perse feudalet Shqiptare njojtne Venetine si *kryezotneshe?*

PJESA E TRETE
(1410-1501)

I

LUFTERAT E PARA ME TURQIT

1.–Shqiperia Nené Siperanine Turke

Ndonesé Serbet u-muntne dhe u-thyen ploterisht ne betejen e Kosoves dhe ushteria turke hyri per te paren here ne kufiret e Shqiperise dyke ndjekur Balshen II, Turqit s' u-shtyne mé perbrenda keté here, se u-duall disá ngatrime te medhá nga pas. Mbreti i Tartáreve, *Tamerlanni* osé mé mire *Timur-Lengu* (Timuri i Çale), nje nga egersirat mé te terbúara qe ka nxjere dheu, ish nisur qe nga thellesia e Asise dhe po dilte ne anedetin e Anadollit kur u-perpóq me Turqit Osmanllínj, te cilet u-shtrenguan me keté menyre qe te hiqeshin nga kufiret e Shqiperise dhe nga Serbia per t' i bere balle rezikut te ri. Nje beteje e madhe u-be n' *Angore* t' Asise se Vogel, me 1402, ne mes te Tartáreve, te Timur-Lengut dhe te Bajazitit I, Sulltanit te Turqve. Beteja ish nje shkaterim i plotte per Turqit dhe Bajaziti ra rop ne duart e Timur-Lengut.

Me keté menyre, sulma qe kishin nisur Turqit kundra Shqiperise u-pre e u-ndalua per ca kohe, po jo per nonjé kohe te gjate, se tete vjet mé von, domethene me 1410, Turqit u-forcuan perserí, dyke u-perkembur nga druri i shendoshe qe kishin ngrene nga Timur-Lengu, dhe u-kthyen perserí per te plotesuar pushtimin e Ballkanit.

Po ç' bente ne keté kohe republika venetike, kryezotnesha e Shqiperise? Ne vent qe te mblithte fuqít' e saj dhe te goditte Turkun, Venetia vrapój qe te merrej vesh me Sulltanin, nga frika se mos humbiste tregetín' e saj. Me marreveshjen qe beri me Sulltanin ne múajin e Shkurtit, 1410, Venetia pranój qe t' i pagúante Turqise haráç per vendet qe kish ne Shqiperí, me fjale te tjera jo vetem q' i la ne balte Shqiptaret po edhé i tradhetój ne duart e Sulltanit, i cili u-kenáq nga kjo marreveshje dhe heperhé s' u-shty mé tej.

Disá nga princerit shqiptare q' ishin te lidhur me Venetine, siç pame mé siper q' u-lithne, vrapuan edhé atá te pranonin t' i pagúanin *haráç* Sulltanit qe te mos i ngistej, passi pane tradhetite qe u punój Venetia e cila kish kujdés vetem per nje gje: per te hollat qe nxirrte nga tregetia. Veç haraçit, princet shqiptare u-shtrenguan te njihnin *siperanín'* e Sulltanit, me fjale te tjera e njihnin Sulltanin si *zot* te Shqiperise, dyke pranuar ushterí turke nepér keshtjellat e tyre. Po ndryshe, mbetne te lire te qeveriseshin pas kanúneve te tyre, pa nonjé nderhyrje nga ana e

Turqve, me fjalë të tjera, princët Shqiptarë i zotëheshin Sulltanit që do të mbeteshin besnikë të atij, dhe si për shigurí që nuk' do të dilnin nga besa e që do të pagúanin me regull haraçin, atá pranuan që të mbanin nepër keshtjellat e tyre ushtarë turq.

Po disá princer të tjerë s' deshin që t' i bindeshin as Sulltanit as marreveshjes që beri atý me Venetinë dhe u-kundershtuan me armë. Një prej këtyre ish *Gjon Kastrioti*, princ i Krujes, i cili lëftój gjith' até vit, 1410, me trimëri të madhe kundra *Evrenos Pashes*, njërit nga gjeneralët e Sulltanit. Po fuqia e paket e Gjon Kastriotit s' mundej t' i bënte ballë ushtërisë së madhe turke. Gjon Kastrioti u-mund dhe Sulltani, i cili ish e-gërsuar fort kunder tij për kundershtimin që beri, nuk' u-kenáq vetëm dyke e shtrenguar që të pagúante haráç e të nqaste ushtarë turq në keshtjellën e Krujes, po, për shigurí mé të madhe, i mori penk të katër djemt' e tij, të cilët qúheshin: Repos, Stanislé, Kostandín dhe *Gjergj*, i cili u-bë mé von *Skenderbeu* i fámeshëm.

2.—Zgjerimi i Pushtimit Turk

Po ish e pamundur që Sulltani të kenaqej vetëm me atë, dyke qënë se qellimi i tij ish që t'a shtrónte krejt tërë Ballkanin nenë zotërimin e tij.

Më 1431, pra, Sulltan Murati II rrethój Selanikun, i cili ish nenë qeverimin e bashkët të

perandorit të Bizantit e të republikes venetike. Kur po vazhdonte rrethimi i këtij qyteti, njérezit e krahines së Janines muarr frikë të madhe dhe dërguan njeros tek Sulltani me anen e të cilëve i benin të njohtur q' e linin qytetin e tyre në duart e tij, me kondite që qyteti të mbaute peraeri qeverimin e vjeter të tire. Sulltani e pranój këté ujdí, po nuke shkoj shumë kohe kur e mori nepér kembe lirin' e qytetit të Janines.

Me radhe zunë të bien ahere qytetet e Shqipërisë së poshtme, dyke u-prerë, më tjetren anë, çdo shpresë ndihme nga ana e republikes venetike e cila, në vend që t' u jepte nonjé ndihmë, përkúndrazi merrej vesh me Sulltanin kurdohere q' e desh interesi i saj, keshtú që Shqiptaret e mjere kishin mbetur në mes dy zjarresh. Po, sidomós, Sulltani nuke deshi até kohe që t'a asht peronte punen mé teper nga ana e Shqipërisë së cilës, sikunder thamë, i kish lenë një vetëqeverim. Arësya q' e bente mbretin e Turqve të mos e shtynte mé teper doren e tij nga kjo anë ish se syt' e tij kishin mbetur hepërhé përmi Kostantinopojen, të cilen Turqit kishin shumë kohe që po e lakmonin dhe shumë herë e kishin goditur, po pa nonjé fitim.

Perandoret e Konstantinopojes, dyke parë këté rezik të math, u ishin drejtuar shumë herë pópujve të Krishterë t' Evropes dyke kerkuar ndihmës, po më kot. Në krye të gjithë këtij shékulli, (1400), u-mbloth edhé një keshillë e madhe

s' Italí, e perbere prej fetaresh te larter e te dy kisheve, te *kishes katholike romane* dhe te *kishes orthodokse greke*, me shpresë qe, dyke bashkuar kishet, te bashkóheshin edhé ushterit' e krishtera per te goditur Turqit. Po edhé nga ajó mbledhje s' dolli gjc, sepsé fetaret greke s' deshin t' i bindeshin Papes se Romes me asnjé menyre.

Keshtú, pra, ne kohen qe duhej bashkim kunder armikut te bashket, fuqite qe duhej te leftonin kundra Turqve ishin te ndara.

Jo mé pak e keqe ish gjendja e Shqiperise ku princerit e ndare jo vetem s' muunt te mérreshin vesh ne mes te tyre per te leftuar se bashku kunder Turqve, po edhé leftonin njeri me tjetrin, edhé shere kur e kishin armikun brenda ne shtepi. Qe te bashkóheshin duhej nje dore e forte, e cila t' i permblidhte, nje kryetar i forte, i cili t' i mbante te bashkuar nené qeverimin e tij. Ajó dore e forte dhe aý kryetár i fuqishem nuke vonój te çfaqej, sidó qe, per fat shumë te keq, vetem per nje kohe te shkurter, dhe aý ish *Gjergj Kastrioti*, i mirenjuar *Skenderbej*.

PËRMBLEDHJE

(Te mesohet me goje)

1. Turqit u-shtrenguan qe te hiqeshin kete here nga Ballkani per t' i bere balle Timur-Lengut n' Asi, me te cilin u-perpoqen n' Angore me 1402 dhe u-dermuan, dyke rrenë edhe vete Sulltan Bajazíti rop ne duart e Timurit.

2. Po tetevjet me von. (1410), ushteria turke iu

kthye perseri Ballkanit, dhe Venetia, dyké mos ja-shur qe te prishte tregetin' e saj, pranoj t' i paguante haraç Sulltanit per vendet qe kish ne Shqiperi. Kjo gje i trembi fort princerit Shqiptare te cilet vrapuan qe te benin gjith' ashtu, dyke hyre nene siperanin' e Sulltanit i cili do te kish te drejte qe te mbante ush-tare ne kështjellat e tyre.

3. Vetem Gjon Kastrioti i Krujes desh te kunder-shtohej, po u-mund prej Turqve, dhe u-shtrengua qe te bindej dyké dhene si penk te kater djemt' e tij, ne nder te cilave ish Gjergji i vogel, q'u he mé von Skenderbeu i fameshme.

4. Kur ushteria e Sulltanit rrethoj Selenikun ne 1431, pópalli i krahines se Janines i beri te njohur q'e linte qytetin ne duart e tij. Sulltan u-kenaq ahere ve-tem me age, sepsé kish shtire syte mi pushtimin e Kon-stantinopojes.

5. I trembur nga forcat e Turqve, Perandori i Kostantinopojes rrahu qe te merrte ndihme nga kom-bet e Krishterc t' Evropes. Per ate qellim u-mbajt nje mbledhje e madhe n' Itali per te bashkuar Kishet, po s' u-be gje sepse fetaret greke s' deshin te njihnin Papen e Romes si krye.

6. Nga ana tjeter, edhe gjendja e Shqiperise ish shume e keqe nga shkaku i perçarjes qe mbretеronte ne mes te princerve. Shqiperia kish nevoje per nje dore te forte qe t' a mbante te bashkuar, dhe ajo dore u-provua q' ish e Skenderbeut.

PYETJE PËR STËRVITJE

1. Ç' i shtrengoj Turqit qe te hiqeshin nga Ballka ni?—Cili ish Timur Lengu?—Qe nga ish nisur?— Ci-li ish Bajaziti I?—Ç' pesoj Bajaziti dhe ne ç' vent?— Ç' bene Turqit me 1410?—Ç' beri Venetia dhe si e gjeni sjelljen e saj?—Persé mundohej mé teper?— Cilat ishin viset e Shqiperise per te cilat u-sotua qe te paguante *haraç*?—Ç' do te thote fjala *haraç*?

2. Ç' bene princerit shqiptare?— Ç' kuptoni mi fjalet "prangun siperanine te Sulltanit?—Gjithe prin-cerit e Shqiperise e prangun até gje?—Ne mos e pra-nuan ç' bene pastáj?—Ç' beri Gjon Kastrioti dhe ç' i

ngjau?—Si qiheshin, sa ishin, dhe ç' u-ngjau djemve te Gjonit?—Ç' do te thote fjala "penk"?—Ç' farc siguri i jepte Sulltanit ky penk?

3. Ç' ngjau me 1431 dhe persé?—Ç' bente Sulltan Murati II ne ketć kohe?—Ç' ngjau ne Shqiperin' e Poshtme?

4. Persé Turqit s' deshin t'a ngjanin mć tepér Shqiperine?—Ç' beri perandori i Konstantinopojes?—Ç' u-be n' Itali dhe persé s' u-be gje?

5. Ç' i duhej Shqiperise ne ketć kohe, dhe persé i duhej?

II

SHQIPERIA NENĆ GJERGJ KASTRIOTIN

1.—Ne Sherbim te Sulltanit

Dyke marre penk te kater djemt' e Gjon Kastriotit, Sulltani i shpuri n' oborin e tij n' Adrianopoje. Po nuke shkoj shume kohe kur tre djemt' e pare, Reposi, Stanislá, dhe Kostandini vdiqne pa kohe; thuhet qe u-helmuan prej Turqve, dhe ne qofte se eshte e vertete kjo, e siç duket eshte e vertete, Sulltani dolli nga besa q' i kish dhene Gjon Kastriotit dhe nga kanuni i pergjitheshme i kómbeve qe urdhcrón qe atá qe merren penk duhet te mos ngiten me asnjé menyre.

Sidó qe te jete, e verteta eshte qe te tre djemte vdiqne pa kohe dhe me nje menyre te dyshimte; vetem mć i vogli, Gjergji, (lindur me 1404 ne *Gures*) shpetój, se Sulltani kish shtire nje dashuri te madhe n' até djale te vogel—Gjergji ish vetem nente vjetsh ne ketć kohe—i cili tregonte qe ne

vogli se do tɛ bɛhej njɛ njeri i zgjuar dhe i fortɛ nga trupi. Dyke shkelur edhé njɛ herɛ mé tepɛr zotimet zyrtare q' i kish dhenɛ t' et, Sulltani e rriti Gjergjin sikursé t' ish Turk dhe kur arrijti nɛ moshen e duhur i dha njɛ shkallɛ tɛ lartɛ nɛ ushtɛrinɛ turke. Kɛshtú, pra, e gjejmɛ mɛ 1422, Gjergj Kastriotin, kur ish vetɛm tetɛmbɛdhjetɛ vjetsh, kumandár tɛ njɛ trupe turke n' Anadóll ku ish dɛrguar qɛ tɛ mbytte njɛ kryengritje. Ish nɛ kɛté fushatɛ, tɛ cilɛn e nxori nɛ krye me mjeshtɛrí tɛ madhe, qɛ Gjergj Kastriotit iu-dha prej ushtáreve tɛ tij miemri "Isqender Bej", *Skenderbéj*, siç e pɛrdorim neve taní, dyke e barabitur me kɛté menyrɛ me Aleksandrin e Math pɛr trimerinɛ dhe zotesin' e tij nɛ púnera ushtɛriake. Mé von, Gjergj Kastrioti lɛftój pɛr Sulltanin edhé nɛ Sɛrbí, nɛ Greqí, e nɛ Hungarí; nɛ gjithɛ kɛtó fushata dolli faqebardhe dhe nderi i tij po shtohej nga tɛ gjith' anɛt. Mé tepɛr nga tɛ tjerɛt, Skɛnderbeu nderohej prej Sulltanit, i cili e qúante si dorɛn e djathtɛ tɛ tij.

Po as tɛrɛ kɛtó lajka, as nderet, as fitimet, as rritja qɛ mori nukɛ muntnɛ qɛ tɛ shushitnin nɛ zɛmrɛn e tij tɛ kɛthjellte dashurinɛ qɛ ndjente pɛr Shqipɛrinɛ, pɛr prindɛrit e tij, pɛr kombin e tij, i cili po robɛrohej mé tepɛr dita me ditɛn prej Turqve. Kujtimi i atdheut ish mbajtur i gjallɛ nɛ mɛndjen e tij, dhe s' kɛrkonte gjɛ tjetɛr veç se njɛ rasje tɛ mirɛ qɛ tɛ kthehej nɛ vɛndin e tij dhe tɛ merrte nɛ dorɛ qeverimin e Shqipɛrisɛ.

Nga ana tjetcr, ngjanc edhé disá shkake tc tjera tc cilat e bcnc mé tc forte vendimin e tij. Njc nga ató ish sjellja e Sulltanit. Mc 1432, Gjon Kastrioti, i ati i Skenderbeut, vdiq. Murati II, nc vent qc t' i jepte principaten e Krujcs Gjergj Kastriotit qc kish tc gjitha tc drejtat qc tc bchej princ i Krujcs, ia dha njc Turku, tc qúajtur *Sabél Pashc*. Kjo ngjarje e ftohu mé tepcr Gjergj Kastriotin, dyke i treguar qc tc drejtat e tij po mérreshin nepér kembc, me gjithc besnikerín' e madhe qc kish treguar nc sherbím tc Sulltanit. Skenderbeu vendosi, pra, qc tc mbaronte qellimin e tij su mé shpejt, porsá qc t' i dilte perpara njc rasje e mirc.

2.—Kthimi i Skenderbeut nc Shqipcri

Mc 1443, ushtcria turke, nc tc cilen Gjergj Kastrioti kish ketć herc vendin e nenekumandarit, udergua kundra mbretit tc Hungarise, *Gjon Hunyadit*, dhe nc betejen qc u-bc nc *Nish*, Turqit u-thyen shumc liksht dhe u-shperndanc tc dermuar. Nc mes t' ikjes sc pergjithcshme tc Turqve, Skenderbeu zuri shkrónjesin e Sulltanit, i cili mbante edhé shillen e tij, dhe e shtrengój me shpatc nc dorc qc t' i shkrûante njc letrc qeveritarit tc Krujcs, Sabél Pashcs, me anen e tc ciles e urdhcronte qc t' ia jepte keshtjellen dhe qeverimin e Krujcs Skenderbeut. Shkaku qc Gjergj Kastrioti ushtrengua qc tc perdorte njc menyrc tc ketillc ish

se pa njɛ urdher t' atillɛ ushtɛria turke qɛ gjendej nɛ Shqiperí do t' i bɛnte kundershtime tɛ mɛdhá qɛ nɛ krye, dhe aý s' kish hɛpɛrhé nonjé ushtɛri me vete. Me até shkresɛ nɛ dorɛ e me tre qint Shqiptarɛ q' i kishin mbetur besnikɛ, Skɛnderbeu u-nis nga Nishi dhe arrijti nɛ Krujɛ me nxitimin mé tɛ math. Atjé i dorɛzój Sabel Pashɛs úrdhɛrin qɛ kish shkrojtur shkrónjɛsi n' emɛr tɛ Sulltanit. Sabél Pasha s' pa nonjé gjɛ tɛ dyshimtɛ n' até urdhɛr, dhe me njɛ herɛ ia dorɛzój Skɛnderbeut kumanden e kɛshtjellɛs dhe tɛ principatɛs sɛ Krujɛs. Gjith' ashtú, Skɛndebeu u-hoth me njɛ herɛ kundra Turqve, i dermój plotɛrisht dhe ngriti flámurin e tij, Shkabɛn me dy krerɛ, nɛ majɛn e Kɛshtjellɛs sɛ Krujɛs *(Shɛkó vjershɛn "SKɛNDERBEU")*.

Pa humbur kohɛ, Skɛnderbeu mblodhi sa ushtarɛ qɛ mundi dhe zuri grykat e kufíreve tɛ Shqiperisɛ, pas lumit Drin, nga ana e Ohrisɛ dhe e Dibrɛs. Me até pakicɛ ushtarɛsh qɛ kish e shtrɛngój ushtɛrín' e fortɛ turke qɛ tɛ mprapsej.

Kɛtó fitime tɛ para u dhanɛ kuraje tɛ madhe e mbushnɛ me trimerí zɛmrat e Shqiptárɛve. Gjith' ashtú u dhanɛ tɛ kuptojnɛ princɛrve tɛ shumɛ tɛ Shqiperisɛ qɛ dora e hekurt qɛ u lipsej dolli nɛ shesh dhe qɛ Skɛnderbeu ish me tɛ vɛrtetɛ princi pɛrmí princɛt e tjerɛ.

E taní muntni t'a merrni vetɛm me mɛnt sɛ sa i math ish tɛrbimi i Sulltanit kur mɛsój se ç' bɛri Skɛnderbeu. E para punɛ e tij ish, pra, qɛ tɛ

pregatitte një fuqí të madhe për të derguar kunder Shqipërisë. Këtó pregatitje të medhá të Turqve e bënë Skenderbeuë që të therriste një mbledhje të madhe në *Lesh*, ku ishin ftuar tërë princerit dhe feudalet shqiptarë, me qëllim që të mérreshin vesh se si do t' i kundershtóheshin ushtërisë së Sulltanit. Në këtë mbledhje për të mbajtur ment u-ndodhë, veç princervë shqiptarë, dhe princi i Malit të Zi si edhe delegatët e Republikës Venetike, iu-dha Skenderbeut titulli "*Kryetár i Ligës së Pópujve Shqiptarë.*" Në cshtë se habiti se përsé u-përdorë fjalët "popuj shqiptarë", kursé juvë dini që pópulli shqiptár cshtë *një* dhe i *vetëm*, arrin 'ë kujtoni se n' até kohë Shqipëria ish e ndarë nër feudalet e ndryshmë dhe çdo principatë dukej sikúr përmblithte një popull të veçantë, të ndarë nga të tjerët.

Kjo mbledhje e Leshit ka një rendësi të madhe për Shqipërinë, se n' até u-bë *bashkimi i parë dhe i plotë* i Shqipërisë, nënë kryesin' e Skenderbeut, dhe se dy Shtete të huaj, Venetia dhe Mali i Zi, e çmuan até kryesi të Gjergj Kastriotit dyke marrë pjesë në mbledhjen. Me këtë menyrë, Skenderbeu u-njojt si kryekumandár, kryeqeveritár, dhe mbret i *gjithë Shqipërisë së Bashkuar*, me fjalë të tjera Gjergj Kastrioti cshtë i pari Shqiptár që mundi të bashkonjë Shqiptarët nënë një qeverí për një kohë të gjatë.

3.—Lúftcrat e Para tc Skcnderbeut

Cshtc gjc krejt e pamundur qc tc pcrshkrúajmc kctú nc kctć librc njc nga njc lúfterat qc bcri Gjcrgj Kastrioti, sc ató janc aqc tc shuma sa munt tc mbushin dhjetc osć mć tcper libra si kjo. Kctú do tc shcnojmc vetcm disá nga ató mć tc mcdhatc e mć tc shcnúarat.

Po ató pika qc duhcn mbajtur mcnt mirc janc kctó:

1.—Qc Skcnderbeu cshtc luftctari dhc gjcnerali mć i math i kohcs sc tij, dhc njc nga gjcneralct mć tc mcdhénj tc botcs.

2.—Qc Skcnderbeu i shkoj po-thua sc nc lúftcra tc gjith' ató njczét e pesc vjet tc jetcs sc tij si mbret i Shqipcrisc.

Zotcsia e tij e çqusr duket m' e shkclqyer nc dy pika:

a) Skcnderbeu pati vetcm njc hcrc njc ushtcrí prej 24,000, kursć gjithc hcrct e tjcra kish vetcm pak mijc, dhc shumc hcrc vetcm disá qindra ushtaresh, e mc gjith' atć ay mundi e dcrmój ushtcritc turke qc kishin shumc hcrc mć tcper sc 150,000 njcrcs, dyke mos u-mundur asnjć hcrc.

b) Njc provc édhc mć e çkclqyer e zotcsisc sc tij cshtc qc nc çdo lufte dhc bctcjc humbjct e ushtcrisc sc tij ishin dhjetc osć njczét hcrc mć tc paka nga humbjct e armikut. Nc njc nga bctcjat Turqit humpnc 5000 tc vrarc, kursć Shqiptarct mik' patnc mć tcpcr sc 70 tc vdekur.

E tani le të hedhim një sy në lúftërat që bëri luaní shqiptár.

Murati II, pasi mbarój luften me Hungarezët, vendosi që të mbytte kryengritjen shqiptare —se aý e pandehte që ish kryengritje—dhe dërgój 25,000 kalorës të provuar dhe 15,000 këmbës nenë kumandën e *Ali Pashës* që të zinte grykat e Dibrës. Skenderbeu nuke kish mé tepër se 18,000 ushtarë. Të dy ushtëritë u-përpoqnë në Dibrë më 29 Qershór, 1444. Gjysma e ushtërisë turke mbet e vrarë në fushën e luftës, 2000 u-zunë robër dhe 25 flámurë ranë në duart e Shqiptárëve.

Ky fitim i çkëlqyer bëri bujën mé të madhe n' Evropë, mbretrit dhe princat e së cilës nisnë tani të kërkonin miqësinë dhe ndihmën e mbretit të Shqiptárëve, mé tepër sepsé kombet e tjerë, si Hungarezët, po mundeshin dita më ditën prej Turqve sidó që mbretëria e tyre ish e madhe dhe kishin ushtërí mé të shumë. Dhe ahere, dolli Papa i Romës, *Eugjeni IV*, për të formuar një *kryqëzatë* të re, në të cilen do të merrnin pjesë një dyzinë nga Shtetet mé të fortë t' Evropës. Me këtë menyrë, Shqipëria u-njojt si një nga *Shtetet e medhénj* t' asáj kohe.

I trembur nga këtó pregatitje t' Evropës, Murati II u-shtrengua të bënte paqe. Midis kondítave të tjera të paqes ish edhé ajó që njihte mbretërinë shqiptare nenë Skenderbenë.

Po nuke shkoj shumë kohë, kur konditat e paqes u-shkelë prej mbretit të Hungarézëve, i

cili nisi perseri luften kunder Turqve. Si pas lidhjes qe kishin bere dhe pas fjales se dhene, Skenderbeu u-nis me ushterin' e tij qe t' i vinte per ndihme mbretit te Hungarise. Po qe t' arrinte ne fushen e luftes, lipsej te shkonte permés Serbise, dhe princi i saj i pabese iu-kundershtua Skenderbeut e s' desh t'a linte qe te shkonte permés tokes se tij. Ky ndalím u-be shkak qe Hungarezet u-thyen edhé nje here prej Turqve, dhe Skenderbeu, i zemruar keq per tradhetín' e princit serp, i dha leje ushterise qe te rumujoste Serbine.

Sulltán Murati e ftoj keté radhe Skenderbene qe te bente paqe; po mbreti shqiptár s' ish nga atá qe dalin nga fjala dhe prishin besen, e keshtú s' deshi te bente paqe pa shoket e tjere. Lufta u-ndes perserí, dhe ne çdo beteje Skenderbeu dolli i fituar.

Po me 1447, u-hap nje lufte e re, keté here me Republiken venetike. Shkaku i luftes ish se Venetikasit hyne dhe zune nje qytét te Shqiperise, i cili pas kanunit i binte Skenderbeut. Mbreti i Shqiperise u-nis me ushterín' e tij kunder fórcave te Venetise, e cila, dyke e gjetur pisk, arrijti gjer ne piken sa u-muarr vesh me Sulltanin kunder Skenderbeut. Nje ushterí turke hyri ne kufiret e Shqiperise, ne kohen kur Venetikasit po pregatíteshin qe te goditnin fuqit' e Skenderbeut qe nga Dúrresi. Po trimi pa shoq i mundi njerin pas tjetrit te dy armiqt' e lidhur. Kjo eshte nje nga lúfterat mé te çkelqýera, sepssé n' até kohe

Venetia dhe Turqia ishin dy nga shtetet më të medhénj të botës, dhe Skenderbeu i mundi që të dy me një herë. Pas asáj mundje, Republika Venetike i ndenj besnike Skenderbeut.

Lufta me Turqit vazhdój si më parë, dhe nuke shkonin gjashtë muaj pa hyrë në Shqipëri edhé një ushtëri turke vetëm e vetëm që të dërmohej prej Shqiptárëve. Më në fund, më 1450, Sulltan Murati II vendosi që t' i jepte fund kësáj punë, dyke goditur zemrën e Shqipërisë, kryeqytetin e Skenderbeut, *Krujën*. Mblodhi afró 50,000 ushtarë, dyke patur edhé topat më të medhénj që kish parë bota gjer n' até kohë, hyri në Shqipëri dhe ndrejtua në Krujë, të cilën e rrethój më 5 të Prillit, 1450. Reziku i kryeqytetit ish rezik për tërë Shqipërinë, dhe jeta e sáj varrej në një pe. Po nga ana tjetër, dihej përsëri se sa ish gjallë Skenderbeu Shqipëria s' mund të kish frikë nga roberia. Reziku i tmerrúar e shtoj edhé një herë më tepër kuximin, trimërinë dhe mjeshtërinë ushtarake të mbretit luan të Shqipërisë. Skenderbeu, në vend që të mbyllej në qytetin e rrethuar, iu la kumandën e mprojtjes së Krujës njerit nga gjeneralët e tij dhe ný vetë zuri në ushtërín' e tij visët më të forta në malet që rrethojnë Krujën. Q' andéj goditte pa reshtur Turqit, iu bënte prishje të medhá, s' u linte t' u vinin ushqime që jashtë, dhe i mundonte me një mijë menyra që çpikte mendja e tij. Pas pesë muajsh rrethimi, Sulltán Murati e mblodhi bishtin dhe iku nga

Shqiperia me ushterin' e tij te dhjetuar e te dermuar, dhe nuke shkoj shume kohe qe vdiq ne Adrianopoje. I ra pika se nje grusht Shqiptare i benin balle fitimisht perandorise se tij se madhe.

4.—Lúfterat me Sulltán Mehmetin II dhe ne Itali

Vendin e Muratit e zuri Mehmeti II, i cili ish nje njeri i eger dhe kryengjeshur. Sulltani i ri vendosi qe te vazhdonte punen e t' et per te pushtuar Shqiperine.

Dyke perfituar nga nje pushim i heperheshme i luftes, Skenderbeu u-marrtua ne Maj, 1451, me te bijen e princit te Kanines dhe Himarres, *Arianitit*, e cila quhej *Marine*. Dasma ish shume e shkelqyer, dhe u-bene kremtime te medhá. Republika e Venetise dhe mbreti i Nápolit i derguan Skenderbeut dhurata fort te çmúara.

(Shiko Kendimin: MARRTESA E SKENDERBEUT, faq. 107).

Pas dasmes, Skenderbeu vajti te kqyrte kufiret e Dibres ku ngriti keshtjellen e Modrises. Sulltán Mehmeti s' ish édhe gatí qe te vinte vete ne Shqiperi, po dergonte kohe me kohe gjeneralet e tij te cilet shtrengóheshin prej mbretit te Shqiptárve qe te kthéheshin te Sulltani te turperuar dhe koke-unjur. Aresya qe Sullani s' vinte dot heperhé ne Shqiperí ish se ne 1453 kish rrethuar Kostandinopojen, e cila mé ne funt ra ne duart

e tij me 29 te Majit t' atij viti. Me keté menyre u-çduk per gjithenjé edhé perandoria bizantine, hinjakja e perandorise romane. Ballkani i tere tani ish ne duart e Turqve, dhe vetem nje çip i vogel i tij, Shqiperia, qendronte kryelarter kundra fuqise se tyre te tmerruar. Mbretrit dhe princet e tjere t' Evropes po rrinin me goje hapur dyke vështruar prej se largu luften gjigantike qe po çvillohej ne mes te Skenderbeut dhe te Sulltán Mehmetit, i cili, me marrjen e Kostandinopojes, fitój titullin "Fatih", domethene *ngadhenór*. Vetem te Skenderbeu s' i shkonte titulli dhe emri i tij i math. Tere gjeneralet dhe pasballaret e degjuar per zotesí e per trimeri qe dergój kunder Skenderbeut u-thyen njeri pas tjetrit, dhe Mehmeti ment lojti mentsh nga terbimi qe ndjente.

Po per fat shume te keq, até qe s' fitonte dot Sulltani me ushterin' e tij dualle dy Shqiptare tradhetore, dy nga kapedanet mé te mire te Skenderbeut, njeri nga te eilet ish vete i nipi i mbretit shqiptár, dhe in-zotuan Sulltanit qe t'a henin até dyke mposhtur Shqiperine dhe mbretin e saj. Po zemrimi i drejte i Skenderbeut ra si rrufé mi 'tá, dhe njeri pas tjetrit qe te dy u-muntne e rane ne duart e tij.

E kur, mé ne funt, Mehmeti II pa qe s' ia dilte dot luftes me Skenderbene, e hoqi ushterin' e tij nga Shqiperia dhe e dergoj ne vise te tjera.

Ky pushim i luftes nuke shkoj me kot, se detyrat e miqesise e thirre mbretin e Shqiperise

n' Itali per të ndihmuar mikun e tij, *Ferdinandin*, mbretin e Napolit, i cili ish goditur prej *Angjevinëve* që pamë më parë se kishin themeluar mbretërinë angjevine të Shqipërisë së Mesme. Skënderbeu kaperxeu Adriatikun me ushtërín' e tij më 1459 e dolli në *Bari*, dhe, dyke u-bashkuar me ushtërín' e mbretit të Napolit, i vuri përpara Angjevinët dhe i mundi plotërisht. Me këtë fushatë, Gjergj Kastrioti ngjalli edhé një herë kujtimet e fushátave të vjetra t' Aleksandrit të Mollosisë e të Pirros, me ndryshimin që Skënderbeu e mbarój punën për të cilën kish vajtur n' Itali kursé atá dy të paret vanë n' Itali dhe ikënë pa mbaruar gjë.

Skënderbeu nukë ndenji shumë kohë n' Itali, se Turqit, dyke degjuar largimin e tij nga Shqipëria zunë t' u afróheshin kufireve të saj. Njëri pas tjetrit, tre gjenerale turq u-mundúan të hynin në Shqipëri, po Gjergji arrijti më kohë dhe i mprapsi. Këtó humbje e shtrenguan Sulltanin kryengjeshur që të kërkonte edhé një herë paqe nga mbreti i Shqipërisë, dyke vënë përpara tri kondita të përgjithëshme. Skënderbeu pelqeu vetëm një nga ató dhe Sulltani ish aqe i detyruar sa pranój të bënte paqe (1462) vetëm me kondítën që pranój mbreti i Shqipërisë. Ajó kondítë ish që tregëtia në mes të Shqipërisë e të Turqisë t' ish e lirë.

(Shko Kreshtimin: NJË LETËR E SKENDERBEUT PËR SULLTAN MEHMETIN E DYTË, faq. 109).

Po edhé kjo paqe s' mbajti mé teper se dy vjet. Papa i Romes, *Piu II*, po mundohej tani qe t' organizonte nje kryqesate tjeter kunder Turqve, e eila keté radhe do te vihej nené *kumanden e pergjitheshme te mbretit te Shqiperise*. Me fjale te tjera, Skenderbeu do te njihej si mbreti mé i math i tere Evropes. Po per fat te keq, ne kohen qe Papa po gatitej te hidhej ne Shqiperi e te kurorezonte Skenderbenc si kryekumandár te kryqesates vdiq pa pandehur n' Itali, e keshtú puna e kryqesates u-prish.

Pas ketyre ngjárjeve, Sulltán Mehmeti, pasi dergój edhe nja kater a pese gjenerale te tjere kundra Shqiperise e pa qe s' bene gjc as atá, vendosi te vinte vete keté radhe. Ne krye te nje ushterie te tmerreshme prej afró 200,000 njerez, dhe me shume topa te medhénj, Mehmeti hyri ne Shqiperi dhe ne Korrik, 1465, rrethój Krujen. Perseri, Skenderbeu e la kryeqytetin e tij nené kumanden e gjeneralit te tij trim, *Balthazar Perdaçit*, dhe aý vete zuri malet, nga te cilat sulej pa rreshtur dyke i bere demet mé te medhá ushterise turke. Me keté menyre e lodhi Sulltanin, i cili u-hoq nga Kruja dyke lene ne vent te tij nje nga pashallaret mé te zoter, *Ballabán Badér Pashen*, me 80,000 ushtare. Keté here, Skenderbeu e pa qe puna ish shume e rende, dhe, dyke ikur fshéhurazi nga Shqiperia, arrijti ne Rome i panjojtur per te kerkuar ndihme nga Papa, po s' meori dot nonjé. U-kthye prapa ne Shqiperi

dhe dyke mbledhur atjé sa ushtare qe munt te nxirrte vendi beri sulmen e fundit dhe dermój ushterinc turke, dyke vrare edhé Ballabán Pashen.

Me 1466, Mehmeti II vendosi qe te bente sulmin e fundit per te pushtuar Shqiperinc. Mblodhi nje ushterí tjeter prej 130,000 njeresh, dolli ne Durres, arrijti prape gjer ne Kruje, po u-shtrengua perseri qe te kthehej ne Durres. Pas gjashte muajsh lufte, Mehmetit iu-mbush mé ne funt mendja qe s' ish e mundur qe te zinte Shqiperinc, dhe vendosi qe te hiqej nje here e mire nga tokat ku mbretcronte Skenderbeu dore-hekur dhe zemer-luan, dyke lene vetem 30,000 burra qe te rúanin kufiret.

U-duk tani sikúr Shqiperia shpetój nga reziku i Turqve, dhe Skenderbeu vajti ne Lesh ku thirri edhé nje here ne mbledhje princet e Shqiperise qe te mejtohej bashke me 'ta se cila ish udha dhe menyra m' e mire qe t' organizohej vendi dhe te mbetej i bashkuar edhé per kohen e arthme. Princerit dhe tere paresia e vendit u-mbloth ne Lesh per te nderuar kryekumandarin e pamundur, po kété here fati i zi i Shqiperisc kish vendosur qe, ne vent qe mbledhja te merrej me púnerat e mprojtjes e t' organizimit te saj, princet dhe paresia e mbledhur te shekonin fundin e asáj mbreterie te shkelqyer e te lavderuar. Pak dit kishin shkuar qe kursé ish mbeshtjelle mbledhja kur mbreti lavdiplót, luftetari pa shoq, múndesi i Sulltáncve, Skenderbeu i degjuar ne

tere boten, ra i semure dhe me 17 te Jenarit, 1467, vdiq, dyke e lene Shqiperine si qyqe te mjere e te shkrete.

(Sheko Kendimin: VDEKJA E SKENDERBEUT, faqe 112).

Thuhet se kur degjój vdekjen e Skenderbeut, Sulltán Mehmeti thirri: "Vdiq Skenderbeu! Te fálemi, o Perendí! e kush munt te na ndalonje mé qe te pushtojme tere boten?...."

Papa i Romes dhe shume mbreter t' Evropes mbajtne zi per vdekjen e trimit mbret te Shqiperise, e i bene shume nderime emrit te tij te lavderuar.

Skenderbeu u-varros me shume nderime ne Lesh, dhe kur e muare keté qytét me 1478, Turqit ndane ne mes te tyre thrimet e éshtrave te tij te cilat i mbanin si *hajmali*, dyke kujtuar qe keto kishin fuqi edhé t' i mpronin nga vdekja.

PERMBLEDHJE

(Te nesohet me gojc)

1. Nga te kater djemt' e Gjon Kastriotit q' u-muar penk prej Sulltanit shpetoj vetem me i vogli, *Gjergji*, te cilin Sulltani e rriti e i dhá punc n' ushterin' e tij. Kur ish vetem 18 vjetsh, Gjergji leftoj dhe fitoj n' Anadoll ku ushtaret turq e qánjtne "Skenderbej", per kujtim t' Aleksandrit te Math, per trimerine dhe mjeshterin' e tij.

2. Po Gjergji s' e harronte dot Shqiperne, me gjithe lajkat dhe nderet e Sulltanit, dhe priste vetem nje rast te mire qe te kthehej ne vendin e tij. Ay u-ftoh mé teper me Sulltanin kur iu-dhá principata e Krujes Sabel Pashes, pas vdekjes se Gjon Kastriotit, ne vend te t' i jepej atij si mall te babes q' e kish.

3. Rasti qe priste Skenderbeu u-duk ne betejen e Nishit (1443). Si u-thye ushteria turke, Skenderbeu mori me force nga shkrónjesi i Sulltanit nje shkrese per Sabel Pashen, dhe iku me 300 shoke Shqiptare. Arrijti me nxitím ne Kruje, vuri keshtjellen ne dore me shkresen, i dermoj Turqit e ngriti flamurn e tij.

4. Ne Lesh u-mblodhe princet e paresia shqiptare dhe nojtne Skenderbejne si "Kryetar te Liges se Popujve Shqiptare", me fjale te tjera mbret te Shqiperise se bashkuar per te paren here.

5. Skenderbeu u-refye nje nga gjeneralet mé te medhenj te botes me mjeshterin' e tij ushteriake, dyké mundur ushterí shume te medhá me forcat e tij te vogla, e dyké humbur fare pak ushtare aý kursé armiku humpte dhjete osé njezét here mé teper, pa u-mundur nonjé here ne jeten e tij q' e shkoj gjithe ne luftera.

6. Gjergj Kastrioti dermón ushterine turke t' Ali Pashes ne Dibre, 1444. Ky fitím ben buje te madhe n' Evrope, dhe Papa Eugjeni IV mundohet qe t' organizonje nje kryqesate te ré, me anen e se ciles Shqiperia njihej si nje nga Shtetet mé te forte t' Evropes. Murati II trembet dhe ben paqe. Mbreti i Hungarise shkel paqen dhe mundet prej Turqve, se Princi i pabese i Serbise s' e la Skenderbene qe te vinte te ndihmonte Hungarezet. Serbia rumujoset prej Shqiptareve.

7. Me 1447, hapet lufta me Venetine, e cila shkeli te drejtat e Skenderbeut. Venetia meret vesh me Turqit, po Gjergj Kastrioti i munt qe te dy palet, sidó qe ketá dy Shtete ishin nga mé te medhenjte n' Evrope. Lufta me Turqit vashdón, dhe Murati II rrethón me 1450 Krujen me 50,000 ushtare. Po Skenderbeu zuri vende ne malet dhe prishi ushterin' e tij. Murati hiqet nga Shqiperia dhe vdes nga meraku. Vendin e tij e ze Mehmeti II.

8. Skenderbeu martohet me Marinen e Arianitit te Kanines dhe Himares. Mehmeti dergón njerin pas tjetrit gjeneralet e tij kunder Shqiperise, po qe te gjithe munden dhe dermohen prej Skenderbeut. Ne Maj 1453, Kostantinopoja bie ne duart e Mehmetit, peran-

doria bizantine merr funt, dhe Shqiperia mbetet e vetem kunder Turqve. Dy nga gjeneralet e Skenderbeut, njeri nga te eilet ish i nipi vete, tradhetojne Skenderbene, po munden prej tij.

9. Mehmeti deshperohet dhe heq ushterin' e tij nga Shqiperia, Skenderbeu hidhet n' Itali, per te ndihmuar Ferdinandin, mbretin e Napolit, dhe i munt Angjevinet Italiane. Turqit hyne perseri ne Shqiperi, dyké mesuar largimin e tij, po Skenderbeu arrin me kohe dhe i dermón. Me 1462, Sulltani beri paqe me Shqiperine.

10. Papa i Romes, Piu II, mundohet t' organizonje nje kryqesate te ré *nené kumanden e Skenderbeut*, po vdes ne kohen qe po gatitej te hidhej ne Shqiperi, dhe puna e kryqesates prishet.

11. Nis perserí lufta me Turqit, dhe Mehmeti II rrethón Krujen me 200,000 ushtare. Skenderbeu hidhet ne Rome per te kerkuar ndihme, dhe, dyké ukthyer ne Shqiperi, mbleth nje ushterí te ré dhe e loth Sulltan Mehmetin, i eili iken dyké lene ne vent te tij Ballaban Bader Pashen, te eilin e munt pak mé von Skenderbeu. Mehmeti II ben edhé nje sulme te ré me 150,000 ushtare, po s' fitón gje dhe hiqet nje here e mire nga Shqiperia, me 1466.

12. Skenderbeu therret perserí ne mbledhje ne Lesh princet dhe paresine per t' organizuar Shqiperine, po bie i semure dhe vdes me 17 Jenár, 1467. Varroset ne Lesh, dhe Papa e shume mbreter t' Evropes mbajne zí per vdekjen e mbretit te Shqpierise.

PYETJE PER STERVITJE

1. Ku u-shpune djemt' e Gjon Kastriotit e ç' iu ngjau atjé?—Cili e persé shpetoj?—Kur e kú u-lint Gjergji?—Si e rriti Sulltani Gjergjin?—Kur e fitoj miemerin "Skenderbej" dhe ç' kuptim ka ky miemer?—Ç' enderonte dhe persé ish zemer-djegur Skenderbeu?—Ç' priste e s' kthehej ne Shqiperi?—Persé u-ftoh mé teper me Sulltanin?—Cili ish Sabel Pasha?

2. Ç' ngjau me 1443?—Kush e kush leftoj ne Nish?—Ç' beri Skenderbeu?—Persé i duhej shkresa qe mori dhe si e mori nga shkrónjesi i Sulltanit?—

Ç' beri pastáj?—Si arrijti ne Kruje dhe ç' púnera mbaroj atjé?—Ku i mundi Turqit mé parë?—Cili ish perfundimi i fitimeve të parë?—Si e priti Sulltan Murati ikjen e Skenderbeut?

3. Ç' u-bë në Lesh?—Përsé u-thirr ajó mbledhje, kush kish marë pjesë dhe ç' beri?—Ç' kuptoni me fjalët "Kryetar i Ligës së Popujve Shqiptarë"?—Ç' rendesí ka për Shqipërinë kjó mbledhje?

4. Përsé nuk i përshkrúajmë dot këtú tërë luftërat e Skenderbeut?—Cilat janë pikat mé me rendesi që duhen mbajtur mend?—Cilat janë provat që Skenderbeu ish një nga gjeneralët mé të medhenj të botës?—Sa ushtarë kish aý dhe sa kishin Turqit?—Sa humbje kish Skenderbeu dhe sa kishin Turqit?

5. Ç' ngjau në Dibrë më 1444?—Cili ish Ali Pasha dhe ç' pësoj?—Ç' neshtypje beri n' Evropë ky fitim i mbretit shqiptar?—Cili ish Eugjeni IV dhe ç' u-mundua të bënte?—Ç' do të thotë fjala *kryqësatë* dhe ç' rendesí kish për Shqipërinë kjó kryqësatë?— Ç' beri në këtë rasje Sulltan Murati e përsé e beri?—Kush e shkeli paqen q' u-bë?—Ku u-nis të vinte Skenderbeu e përsé s' mundi t' arrinte atjé?—Ç' beri princi i Serbisë dhe si u-suall Skenderbeu kundrejt tij?—Ç' desh të bënte Sulltan Murati?

6. Ç' ngjau më 1444?—Përsé u-hap lufta me Venetinë dhe si mbaroj?—Ç' beri Venetia dhe ç' rendesi ka kjó luftë për Shqipërinë?

7. Ç' pësonin ushtëritë turke që dërgóheshin prej Muratit në Shqipëri, dhe ç' vendosi të bënte Sulltani më 1450?—Me sa fuqí u-rrethua Kruja dhe si mori fund lufta?—Si dhe përsé vdiq Murati?—Cili e zuri vendin e tij?

8. Kur dhe me kë u-martua Skenderbeu?—Cili ish Arianiti?—Ç' beri pas dasmës Skenderbeu?—Përsé nuk vinte dot vetë kunder Shqipërisë Sulltan Mehmeti?—Kur rá Kostantinopoja dhe ç' rendesí ka renia e saj?—Ç' titull fitoj Mehmeti II?—Prej kujt u-trëdhetua Skenderbeu dhe ç' u ngjau tradhëtorëve?—Përsé hoqi dorë Mehmeti nga Shqipëria?

9. Ç' beri Skenderbeu më 1459?—Cili ish Ferdinandi?—Ç' beri n' Italí Gjergj Kastrioti?—Përsé nuk

ndenji shumë kohë atjé?—Ç' ngjiste në Shqipëri në këtë kohë?—Ç' bëri Mehmeti II më 1462?

10. Ç' dash të bënte Pio II?—Ç' rendesi të madhe ka për Shqipërinë dhe për Skënderbenë kjó kryqëzatë e dytë?—Përsé s' u-mbarua puna?—Ç' bëri Mehmeti II?—Me sá fuqí u-rrethua Kruja këtë radhë?—Kush e mpronte përbrenda?—Cili ish Balthazar Perdueri?—Ku vajti Skënderbeu për të kërkuar ndihmë?—Cili ish Ballaban Bader Pasha?—Ç' pesoj mé në fund?—Ç' vendosi të bënte Sulltan Mehmeti më 1466?

11. Ç' bëri Skënderbeu, pasi iknë Turqit?—Cili ish qëllimi i mbledhjes në Lesh?—Ç' fatkeqësi e madhe për kombin shqiptar ngjau atjé?—Kur vdiq Skënderbeu?—Ç' tha Sulltan Mehmeti kur dëgjoj vdekjen e tij?—Ç' tregojnë fjalët e tij?—Ç' mashtypje bëri n' Evropë vdekja e mbretit të Shqipërisë?—Kú u-varros Skënderbeu dhe si u-sualle Turqit kur arrinë në varrin e tij?

KËNDIME

Të këndohet e të mësohet më gojë vjersha e vjershëtorit amerikán H. W. Longfellow, "Skënderbeu", e përkthyer prej F. S. Nolit.

Të këndohet e të mësohet më gojë vjersha e Asdrenit "Palla e Skënderbeut".

MARRTESA E SKËNDERBEUT—Viti 1450, plot më mundime, më luftra e më gjakra, u-mbarua dykë ndritur mé bukur emerin e Skënderbeut. U-deftua n' atë vit, në faqe të gjithë dheut, se Skënderbeu që m' i madhi kapetán i kohës së tij.

Vitin 1451, Babaj i Kombit e shkoj nε qetín e nε paqe; trimi i mjere kish nevoje tε mblithtε kockat e tε çlodhej. N' até vit goditnε dy punε tε húmura: Skenderbeu u-marrtna me Zonjen Marinε, tε bijen e Arianitit, qε ish kryezót i Kaninεs, —e n' até vit prapε, ngrijti keshtjellen (kalanε) e Modrisεs.

Dasma u-bε mε 26 tε Prillit, 1451, Skenderbeu ish 47, e zonja 23 vjetsh. Princεt dhε zóterit fqinj arthnε mé tε shumεt nε dasmε, dhε, atá qε ishin tε penguar nε dhé tε tyre, derguan zevendes, tε gjithε me kanisqe tε búkura. Veç nuk' erdhε princεt Dukagjinε, qε ishin pak tε ftohεt me Skenderbenε, edhé tε vellézerit e nusεs, tε cilet s' deshnε tε venε nε dasmε se ishin tε zemrnar keq qε i atí i kish dhenε pajε tε tepér sε motrεs tyre. (Hajde, djall, Toskε, hajde! Ku tε le fellε Toska? E kush e mban Toskën kur zemrohet?.....Pa mbyllni pak sytε, e perpiqunι tε vemi mε mεnt 450 vjet perpara, nε Kaninε, nε Komúk tε Zotit Arianít me bijt' e vetε.—Hε mor djem, íhotε luftetari i ndritur, veshur mε fustanε e mε shokε, mε siláh, mε kallεn, e mε opinga; hε, mor djem, ç' kini ju? edhé juve ju kam pεr tε lenε begatí. Çapni nε dasmε, se εshtε turp!—Jo, mor zot, nuk' vemi nέ, na u-mbush mendja!.....)

Si u-mbarua dasma, Skenderbeu vuri nεr mεnt tε niset mε Princeshεn shoqen e tij e tε vejε nepér gjithε viset qε ishin nenέ urdher tε tij. E

ashtú u-nisnɛ, dhe kudó qɛ vanɛ qytete e keshtjella pɛrpiqeshin kush e kush t' i presɛ mé mirɛ e t' u japɛ mé tɛ búkura darovira.

(*ALBANIA, 1900*). Faïk Konitza.

NJɛ LETRɛ E SKɛNDERBEUT PɛR SULLTAN MEHMETIN II—Nɛ librat historike kanɛ mbetur disá letra qɛ ka kɛmbyer Skɛnderbeu me mbrétɛrit e tjerɛ, si me mbretin e Hungarisɛ e tɛ Pollonisɛ, me mbretin e Napolit e me Sulltanɛt, Murat II e Mehmet II, po neve do tɛ japim kɛtú vetem njɛ nga ató. Nɛ múajin e Pɛillit, 1461, Sulltán Mehmeti i dɛrgój njɛ letrɛ Skɛnderbeut, me anen e sɛ cilɛs e ftonte qɛ tɛ bɛnin paqe. Me njɛ madhɛshtí tɛ çudítɛshme e pa vɛnt, Mehmeti e drejtonte letrɛn me kɛté menyrɛ:

"*Sulltán Mehmeti, Zot e Perandór i Lindjes dhe i Perɛndimit dhe i gjithɛ vísɛve tɛ botɛs, Skɛnderbeut, Princit tɛ Shqiperisɛ dhe Epirit, i dɛrgón tɛ fala.*"

Po nɛ pɛrgjigjen q' i dɛrgój Sulltanit, Skɛnderbeu, dyke u-tallur me hollɛsi, in drejtón letrɛn Sulltanit me kɛté menyrɛ:

Gjergj Kastrioti, i qúajtur ndryshe Skɛnderbéj, Princ i Shqiptárɛve dhe i Epirótɛve, Princit tɛ Turqve, tɛ fala.

Letra juaj na ra nɛ dorɛ, dhe pamɛ qɛ bɛni fjalɛ pɛr dashurín' e madhe e tɛ veçantɛ qɛ ndjeni kundréjt nesh, e cila vɛrtetohet, siç shkrúanit, me njojtjen e vjeter qɛ u-rrit nɛ mes tonɛ dhe zuri

rrenjc ne zemrat tona, dyke shkuar koha, sikurse t' ish dashuri natyrale, dhe e cila do te mbanje per gjithenjé forcen dhe fuqin' e saj. Juve tani e gjette per te mire qe t'a zgjoni até dashuri qe kish rrene prej shume kohe ne gjume, dyke marre nisiativen qe te lidhim nje bese te re e te béhemi shoke ne lufte, dhe per keté qellim shtroni disa kondita.

E para kondite qe shtroni eshte qe kerkoni q' ushteria juaj te shkonje permés mbreterise sime, per te goditur Venetikasit. Po as drejtesia as nderi im nuke me le, i vyer Mehmét, qe te pranónj keté kondite, se Venetikasit janc miq te mij dhe shoke ne lufte.

Sa per até qe kerkoni birin tim, Gjonin, qe te jete si penk ne duart tuaja per shiguri mé te mire te paqes qe do te bejme ne mes tone, munt qe t'a benja, i fieme Mehmét, po te me jepte leje dashuria atesore; po, dyke qene se e kam djalé te vetem e esht édhe foshnje e parritur, nuke do te jete mire as per 'té as per neve qe te keputet nga gjiri yne ne keté moshe kur ka nevojen mé te madhe per perkujdesjen e dashurin' e prinderve te tij.

Sa per kerkimin qe beni per tregetaret tuaj qe te punojne lirisht tregetin' e tyre ne mbreterine time e pas deshires se tyre, jam i kenaqur qe t'a pranónj keté kerkim, dhe urónj me gjithe zemer qe te rritet tregetia ne mes te tregetareve tane ne te dy mbreterite.

Më tej, me qenë se juve kerkoni të më bintni që të vinj e të piqem me juve pa frikë, q' ashtú të mund të çmállemi, dyke u-fjalosur goja-gojes, s' mund veçsë t' ju levdónj për miredashjen tuaj e të çmonj shpirtmirësinë tuaj; përandáj, edhé unë do të bënja pa frikë ashtú siç më keshilloni juve, po t' ish që të mos më ndalonin disá púnëra më rendësi, të qëverisë sime, që s' presin. Po ç' mund të bënj? Im bir, Gjoni, sikunder thashë më parë, është i vogël dhe s' mund të qëverisë në vent tim; dhe pópulli im, siç e dini, dó kurdoherë diç të bënjë, dyke qenë se është prej natyre i ashpër dhe i pashtruar, aqe sa edhé vetë unë me-zi e qëveris. Më gjith' atë, do të vinj tek ju, pas deshirës suaj, porsá që të gjenj një rasje të mirë. Qofshi me shëndét, dhe mos harroni dashurinë.

Nga Fusha e Luftës, më 30 të Majit, 1461.

E me gjith' atë, Sulltan Mehmeti u-përúnj dhe bëri pagë me të vëtmen kondítë që pranój Skenderbeu.

Në një letrë tjeter, shumë të gjatë, më 26 Maj. 1463, Skenderbeu tallet me titujt e fryrë të Mehmetit "Zot e Perandór i Lindjes dhe i Perëndimit dhe i gjithë viseve të botës," dhe i thotë Sulltánn Mehmetit që do të bënte shumë mirë që, përpara se t' i përdorte ató tituj aqe të medhénj e të kottë, të kujtonte se gjyshi i tij, Bajaziti II, ish rop në duart e Tamerllanit i cili e zvarroste si kafshë t' egër me pranga nepér kembë, dhe

se mé parc se t'a quante veten "Zot e Perandór tc Lindjes e tc Perendimit e tc gjithe viseve tc botes," duhej qc tc kish shtruar tc paken Shqipcrín' e vogel, nga e cila vetc aý, Sulltani, po kerkonte paqe.

VDEKJA E SKENDERBEUT—Kur u-nis Skenderbeu qc tc vinte nc lufte, poqi ndhes Mortjen, lajmetare tc keqe per fatkeqesí.

"Emri im eshtc Vdekje; kthehu prapc, ô Skenderbéj, se jeta jote i afrohet fundit."

Aý e vcshtronte dyke e degjuar; nxori shpatcn, dhe Vdekja qendrój nc vent pa u-tundur.

"Hije erc, nga e cila kanc frike vetem burracakct, nga dí ti qc do tc vdes? Zemra jote e ngrirc á mun tc parcshekonje vdekjen time? Apó esht e hapur per ty libra e shortit tc trimave?"

"Die, nc qiell, m' u-hapnc librat e fatit; i zi e i ftohtc sí nje duak, zbriste fati yt mi koken tende, pastáj binte edhé mi tc tjere."

Skenderbeu perpoqi duart, dhe zemra e tij nxori nje rrenkinu—"Ah, i mjeri unc, nuk' do tc rronj mé!"

Me mendjen e tij shekón kóherat qc do tc vijnc pas vdekjes sc tij; shekón tc birin pa áftc, dhe mbreterín' e tij tc mbytur nc lote. I mbledhi luftetarct e tij e u tha:

"O luftetarc besnikc tc mij, Turku do tc zerc terc vendin tuaj, dhe juve do tc bchi robct e tij.....Dukagjín, sill-e ketú tim-bir, até dja-

lósh tɛ hijeshɛm qɛ t' i jap kɛshillat e mija....— O lule e lɛnɛ, lule e dashurisɛ sime, merr nɛnɛn tɛnde dhe gatit tri nga galerat mé tɛ mira. Po tɛ mɛsonjɛ Turku, do tɛ vinjɛ qɛ tɛ tɛ zerɛ, ty dhe nɛnɛn tɛnde. Zbrit nɛ buzɛn e detit; atjé ku eshtɛ njɛ selví e errɛt dhe e helmuar. Lidhe kalin n' até selví dhe çpeshtíll flámurin tim permí kalin, tɛ hapur kundréjt erɛs sɛ fortɛ tɛ detit, dhe mi flámurin, varr shpatɛn time. Gjaku i Turqve ka mbetur nɛ tehun e shpatɛs, dhe atjé fle vdekja. Nɛné selvín' e errɛt, a esht e mundur qɛ tɛ mbeten tɛ shúrdhra armɛt e luftɛtarit tɛ tmeruar? Kur tɛ frynjɛ thellimi i tɛrbuar, kali do tɛ hingɛllinjɛ, flámuri do tɛ valonjɛ n' erɛ, shpata do tɛ tingɛllinjɛ. Turku do t'a dɛgjonjɛ tingɛllimin, e, dyke u-dredhur, i zbetɛ dhe i frikɛsuar, do t' ikɛ dyke mejtuar vdekjen."

LEGJENDɛ POPULLORE.

(Kjo legjendɛ e bukur kɛndohet si kɛngɛ prej Shqiptáreve t' Italisɛ kur lozin *Vallen e Skenderbeut* ditɛt e Páshkeve).

III
LUFTRAT E FUNTME ME TURQIT

1.–Kryezotnimi i Venetisɛ

Me vdekjen e Skɛnderbeut, Shqiperia mbet pa dorɛ tɛ fortɛ, e cila t'a mbante tɛ bashkuar e t'a udhɛhiqte nɛ luftɛn kundɛr Turqve qɛ muarɛ taní

kurajen mé tε madhe, dyke parε qε Gjergj Kastrioti i pamundur s' ish mé nε krye t' ushtcrive tε tij. Nga ana tjeter, ish e ditur qε princerit e shumε tε Shqiperisε nuke do tε mbéteshin dot tε bashkuar, mé tepεr sε asnjé prej tyre s' ish i zoti qε tε zinte vendin e mbretit tε vdekur, dhe trashegimtari i Skenderbeut, *Princi Gjon i Krujes*, ish vetε njε foshnje nε keté kohε.

Perandáj, Skenderbeu, nε shtratin e vdekjes, ia la kryezotnimin e Shqiperisε Republikes Venetike, e cila, me keté menyre, u-bε perserí kryezonjε e tókave shqiptare. Gjith' ashtú, nε duart e Venetisε Skenderbeu la tε birin dhe trashegimtarin e tij. Pasketáj, pra, kryekumanden e ushterisε shqiptare do t'a kish Venetia, e cila ish i vétemi shtet i math qε muntte tε kumandonte Shqiptarεt.

Sikunder do tε shohim mé poshtε, Venetia u-mundua per disá kohε, sε bashku me Shqiptarεt, qε tε ndálonte sulmat e tmerúara qε zunε tε benin Turqit, po çdo shpresε per njε fitim tε perfundshmε ish e kottε, sepsé mungonte tanί ajó dorε e hekurt e Skenderbeut i eili ish i vétemi qε dinte se qysh munt tε mundej e tε dermohej njε ushterí e madhe prej njε trupe tε vogel.

Heperbé, Sulltán Mehmeti s' e ngau Shqiperinε, se i kish duart tε zena me láftera nε Persí, dhe po t' ish qε Shqiptarεt tε kishin njε gjenerál tε zotin, i eili tε muntte t'a organizonte e t'a bashkonte vendin nε kohen kur Turqit leftonin gjetkε,

pa fjalɛ Shqipɛria munt tɛ qɛndronte edhé pɛr njɛ kohɛ tɛ gjatɛ si shtet i lirɛ. Po dyke qɛnɛ se s' gjendej nonjé gjenerál i atillɛ, e dyke qɛnɛ se gjenerali mé i mirɛ pas vdekjes sɛ Skɛnderbeut, *Leke Dukagjini*, s' mundi qɛ t' i bashkonte príncerit e tjerɛ, dukej qɛ nɛ krye qɛ nukɛ do tɛ shkonte shumɛ kohɛ qɛ edhé Shqipɛria tɛ binte nɛ duar tɛ Turqve.

2.—Hyrja e Turqve nɛ Shqipɛrí

Shtatɛ vjet pas vdekjes sɛ Skɛnderbeut, domethɛnɛ mɛ 1474, Turqit bɛnɛ sulmɛn e tyre tɛ parɛ kundra Shqipɛrisɛ. Njɛ ushtɛrí e madhe, nɛné kumandɛn e *Sulejmán Pashɛs*, hyri nɛ Shqipɛrí dhe arrijti drejt nɛ Shkodrɛ, e cila u-rrethua nga tɛ gjith' anɛt. Venetia kɛrkój ndihmɛn e Evropɛs, po Evropa s' dɛgjój as kɛté herɛ. Me gjith' até, Shkodra qɛndrój burrerísht dhe trimɛrísht kunder Turqve. Passí Sulejmán Pasha humbi pjesɛn mé tɛ madhe t' ushtɛrisɛ sɛ tij, dyké goditur mɛ kot qytetin e rrethuar, u-shtrɛngua tɛ hiqej edhé ky nga Shqipɛria, dhe Shkodra shpɛtój kɛté herɛ.

Po Sulltán Mehmeti II s' ish nga atá njerɛs qɛ lodhen shpejt nɛ luftɛ. Aý ish nga atá qɛ sa ndalime mé tepɛr gjejnɛ aqɛ mé tepɛr ndizen pɛr tɛ kapɛrxyer ató ndalime. Kujtimi vetɛm qɛ njɛ çip i Ballkanit s' desh t' i pɛrunjej kur Evropa e tɛrɛ dridhej nga frika e ushtɛrisɛ sɛ tij, e terbonte Mehmetin II.

Me 1477, Mehmeti u-nis vetë për në Shqipëri me një ushtërí prej 150,000 njerës dhe arrijti afer Krujës, për mprojtjen e së cilës vrapój Leke Dukagjini dhe Venetíkasit. Fitimet e para ishin për Shqiptarët, po pas trembedhjete muajsh rrethimi, kryeqyteti i lavderuar i Skënderbeut ra në duart e armikut të tij mé të math, Sulltán Mehmetit. Leke Dukagjini dhe gjenerali venetikas që mpronte qytetin bashkë me 'të rranë në duart e Turqve të cilët i vranë me shumë mundime. Për të ndihmuar Krujën kish vajtur edhé Princi Gjon, i biri i Skënderbeut, me një ushtërí, po arrijti tepër von.

Pasi mbar kryeqytetin e Shqipërisë, Turqit ia turrë Leshit, i cili ra në duart e tyre më 1478. Q' andéj, Sulltani hoqi për në Shkodrë të cilën e rrethój për të dytën herë. Shkodra ketë herë mprohej vetëm prej një ushtërie të vogël, në të cilën ishin dhe disá Venetikas. Në mes të mprojtësve të qytetit të rrethuar ish dhe një murg i quajtur Fra (vëllá) Bartholomeu,—siç e kanë zakón murgët që quhen vëllezër në mes të tyre—i cili me fjalët e tij të zjarrta ndiste zemrat e luftëtárëve për kundërshtim. Kundër kësáj fuqie të paket. Turqit kishin mé tepër se 150,000 ushtarë e përdorën topat dhe gjylet mé të medhá të asáj kohe. Me trimërí të pashëmbëllte, mprojtësit e Shkodrës qëndruan burrërisht kundër Turqve, dyke patur për ndihmë edhe grate që luftonin si luanesha, për dhjetë muaj. Po ish e

ditur qe s' munt t' ia dilte mb' ane kesáj lufte me nje armik aqe te forte, dhe ne Jenár, 1479, Shkodra u-dha ne duart e Turqve. Rénia ish e ndérshme, se nje nga konditat e dorezimit te qytetit ish qe mprójtesit e saj te líheshin te lire te dilnin t' armatisur.

(Shiko Kendimin: RETHIMI I SHKODRES, faqe 120).

Me rénien e Shkodres, Sulltani po-thua se e plotesój pushtimin e Shqiperise, e cila e humbi keshtú lirín' e saj. Nje kohe e zeze roberie dhe skllaverie te rende nisi per vendin tone qe po-thua se ment e humbi fare idén' e kombesise se vete.

Vetem nje prine shqiptár, *Gjon Muzaku* i Myzeqese, deshi qe te kundershtohej, edhé pasí kish rene Shkodra, po Turqit e thyen fuqín' e tij dhe e mposhtne.

3.—Plotesimi i Pushtimit Turk

Me 1480 po-thua se tere Shqiperia ish ne duart e Sulltanit, veç disá véndeve qe me trimerín' e tyre u-mbajtne te lira edhé disá kohe, e disá te tjéreve qe kishin mbetur nené zoterimin e Venetise.

Nga vendet qe muntne te mbanin lirín' e tyre ish *Mirdita* ne Shqiperín' e Siperme, dhe krahina rreth *Himarres*, ne Shqiperín' e Poshtme.

Mirditasit muare malet, pas rénies se fortesave te Shkodres, Krujes e Leshit, dhe nuk' u-

shtruan nenć Turqit gjersa Sulltani u njojti disá tє drejta qє kerkonin: tє drejtєn qє tє mbanin armєt, tє mos u ngitej malli e zakonet, e tє mos u trazohej feja. E ketó tє drejta i mbajtnє gjer nє ditєn qє Turqit u-gporrє nga Shqiperia.

Nga ana e Shqiperisє sє Poshtme, Shqiptarєt e atij krahu kishin ikur nє malet e Himarrєs dhe atjé i qendruan burrerisht Sulltanit per shumє kohє gjersa u-bint qє t' u njihte mє 1492 edhé ketyre Shqiptáreve ató tє drejta qє i kish njojtur Mirditєs e Dukagjinit. Po vetєm *Himarra* mundi t' i ruanje ató tє drejta gjer nє funt, se krahinat e tjera i humpnє qє shumє kohє mé parє.

Kur e mbarój punєn mє Shqiptarєt, Sulltani iu kthye qytéteve tє Shqiperisє q' ishin nenć zotєrimin e Venetisє, si Dúrresi, Vlora, Ulqini, Tivari e tє tjera.

Mє 1499, Turqit goditnє Dúresin, dhe Republika e Venetisє u-shtrengua tє bєnte paqє mє Sulltanin. Paqa u-bє mє 1501, dhe mє anєn e saj, Venetia hiqte dorє krejt nga Shqiperia si kryezonjє e saj q' ish dhe e linte nє dorє tє Sulltanit.

Keshtú mori funt edhé jeta e lirє e Shqiperisє dhe kryezotnimi i Venetisє pernі tokat shqiptare, veç disá skélave tregetare tє vogla qє Venetia mbajti mє pleqimin e Sulltanit i cili preapє njihej si zot i atyre vєndeve.

PERMBLEDHJE

(Te mesohet me goje)

1. Vdekja e Skenderbeut e la Shqiperine perseri pa krye. Djali i tij, Princi Gjon, ish i vogel, e asnjé nga gjeneralet s' kish aqe fuqi sa t'a mbante Shqiperine te bashkuar. Prandáj, Skenderbeu ia la Venetise kryezotnimin e Shqiperise.

2. Sulltan Mehmeti, i zene me luftera ne Persi, nuk e goditi Shqiperine me nje here, po shtate vjet pas vdekjes se Skenderbeut dergoj Sulejmán Pashen kunder Shkodres, po pa nonjé fitim, se Shkodra qendroj burrerisht.

3. Me 1477, Mehmeti II u-nis vete me 150,000 ushtare, dhe pas 13 muajsh rrethimi Kruja, e cila mprohej prej Leke Dukagjinit e prej Venetikasve, rá ne duart e tij. Per te mprojtur kryeqytetin vajti dhe Princ Gjoni, po arrijti teper von.

4. Pas Krujes ra edhe Loshi, e q' andej Turqit hoqne per ne Shkodre te cilen e rrethuan. Pas dhjete muajsh kundershtimi trimeror, Shkodra u-dha me kondite qe mprojtesit te dalin jashte me armet e tyre (1479). Renia e Shkodres eshte dhe renia e tere Shqiperise ne duart e Turqve, te cilet muntne Gjon Muzakun e Myzeqese, te funtmin prine qe qendroj kunder tyre.

5. Po Mirdita, Dukagjini dhe Himara s' u dhane gjersa fituan te drejtat qe kerkonin: te kishin liri te brendeshme e te mos u binin me qafe Turqit. Keté te drejta i rojtne gjer diten q' iku Turku nga Shqiperia.

6. Sulltani goditi qytetet e Shqiperise qe kish Venetia nené zoterimin e saj, dhe Republika u-shtrengua qe te bente paqe me 1501, me anen e se ciles hiqte dore si kryezonje e Shqiperise dhe e linte keté vent ne dore te Sulltanit.

PYETJE PER STERVITJE

1. Ç' ish shkaku qe Skenderbeu ia la Venetise kryezotnimin e Shqiperise?—Cili ish Princ Gjoni?—A kish shprese qe te qendronte pasketáj Shqiperia kunder Turqve, dhe persé kish osé s' kish?—Persé Sulltani s' e goditi me nje here Shqiperine pas vdekjes se

Skenderbeut?—Persé Shqiptarët nuk perfitnan qe t' organizóheshin n' até kohe?—Cili ish Leke Dukagjini?

2. Ç' beri Sulejmán Pasha me 1474 dhe sa ushteri kish?—Cilin qytet rethoj?—Persé s' hiqte dorë nga Shqipëria Sulltan Mehmeti ndonjé pati aqe humbje?—Ç' beri me 1477?—Kush e mpronte Krujen?—Cili tjeter erdhi qe të ndihmonte kryeqytetin?—Sa kohë mbajti rrethimi i Krujës?—Kur rá Leshi?—Ku vane Turqit q' andéj?—Sa ushtarë turq rrethnan Shkodren?—Cili ish Fra Bartholomeu e ç' beri?—Ç' gjera të permendura ngjanë në rrethimin e Shkodrës, e kur e qysh rá ky qytet?—Ç' kuptim ka rënia e Shkodrës?—Cili ish Gjon Muzaku dhe ç' beri?—Ç' tregón viti 1480 per Shqipërinë?

3. Ç' bënë Mirdita, Dukagjini e kahinat rreth Himarrës dhe ç' fitnan?—Sa kohë i mbajtnë ató të drejta?—Ç' ngjau me 1501?

KËNDIME

RRETHIMI I SHKODRËS MË 1479—Rrethimi i dytë i Shkodrës eshtë një nga ngjarjet e medhá t' asáj kohe, jo vetem se po-thuaj tërë ushteria turke mori pjesë n' até rrethim nenë komanden e Sulltán Mehmetit II, i cili kish me vete edhé gjeneralet mé të mirë e mé të provuar, po edhé se u-perdorë n' até rrethim topat e gjylet mé të medhá t' asáj kohe. Ketú mé poshtë po perkthejmë pershkrimin qe ben një historián inglís i asáj kohe të një sulme të Turqve kunder qytetit të rrethuar:

.....Turqit, dyke ditur se leftonin perpara Sulltanit e perpara kumandareve mé të medhénj të Turqisë, u-munduan me fuqi e me forcë qe të merrnin muret e qytetit, veçanerisht një vënt

ku muri ish rrezuar fare, dyke u-trenditur, perpara se të bchej sulma, prej 2539 gjyleſh topi. Po edhé të rrethúarit, dyke mprojtur veten e tyre dhe qytetin, kundershtonin sulmat turke me trimerí pa shembell, keshtú që *s' ish parë gjer ahere nonjë luftë mé e terbuar se kjo që po bchej rreth Shkodres;* njeres të deshperuar leftonin kunder një nshterie që turrej me deshperim dyke u-mundnar që të hynte në qytét. Dhe ajó q' e shtonte mé teper tmerin e dítes ishin gjylet që kercisnin si rrufé, bashkë me klithmat e njérenve dhe me poterren e véglave të luftes; që të gjitha këtó të bashkúara kishin aqe forcë sa dukej sikursé qielli e dheu po perpíqeshin njeri me tjetrin. Dhe shigjetat që hinin në qytét si rrebésh shíu, shumë here e zinin driten e diellit. Në këté lufte të tmeruar shumë nga mprójtesit e qytetit u-vranë, po Turqit vriteshin njezét per një.

Afer portes së múreve ku bchej kjo perpjekje e tmeruar, gjéndeshin disá gure të medhénj, të keputur nga shkembi që rrethón qytetin nga kjo anë. Këtá gure të rrethúarit i perdorin si arme dyke i rrekellyer kundra Turqve. E me gjithë këtó, pashallaret e fuqishmë e kapedanet e medhénj, disá dyke i bindur me fjalë, disá dyke perdorur kanosje, i shtynin perpara ushtaret e tyre, dhe po të prápseshin i vrisnin, keshtú që ushtaret turq, dyke parë se prapsja s' ish mé pak e rezíkeshme se sulma, túrreshin si njeres të deshperuar e të shtytur perpara me pahír, dhe

vrîteshin pa numur. Dhe dyke u-afruar múreve gjersa s' u mbetej gjak nε trup, binin poshtε dhe tε tjerεt kaperxenin mi kufomat e tyre, dhe kεshtú zunε tε fitonin kunder tε rrethúarve, (tε eilεt, nε kετέ kohε, ishin mέ shumε tε plagosur e tε vrarε), dhe, mέ nε funt, shtinε nε dorε njε copε tε murit ku ngritnε flámurin e Turqisε. Dhe aherε Sulltani zuri tε ngrinte lart koken, dyke ndjerε vetεn tε shigurt qε qyteti do tε binte nε duart e tij. Po tε rrethúarit benε njε sulmε tε rreptε qε brenda nga qyteti, e muar prapε atέ copε tε murit, unjnε flámurin e Turkut dhe nε vent tε tij ngritnε flámurin e tyre.....Nε kετέ sulmε u-vranε 12,000 Turq, dhe shumε u-plagosnε. Nga tε rrethúarit u-vranε 400.....

Historin' e plottε tε rrethimit tε Shkodrες e ka shkrojtur historiani shqiptár *Marin Barleti*, i cili ka shkrojtur, gjith' ashtú, edhé historin' e Skenderbeut. Marin Barleti rronte gjith' n' atέ kohε qε ngjasnin ngjarjet qε pershkruan.

PJESA E KATËRTË
(1501-1878)
I
SHQIPËRIA NËNË PUSHTIMIN TURK
1.—Rrjedhjet e Pushtimit

Ashtú siç kini parë edhé vetë në faqet e shkúara të kësáj historie, kombi shqiptár shkoj përmés shumë rrezikesh të tmerrúar në jetën e tij të gjatë. Një numur kombesh e popujsh të huaj, si Romanët, Bizantinët, Gotbët, Sllavët, e të tjerë, muntnë kohë më kohë që të shtínin në dorë Shqipërinë ku qendruan cili mé tepër cili mé pak; disá prej tyre qendruan shekuj të tërë në vendin tonë. Që të gjithë suall mjerim dhe shkatërrim në Shqipëri, veçanërisht popujt barbarë që rrumbojnë vendin me shkeljet e tyre, siç pamë mé siper.

E me gjith' këtó, jo vetëm asnjé nga atá shkelës e pushtonjës po edhé që të gjithë tok s' i bënë kombit tonë nonjé dem mé të math se sa i bënë vetëm Turqit, të cilët erdhë barbarë t' egër nga Asia dhe barbarë ikënë nga vendi ynë më 1912. Siç do të shohim mé poshtë, Turqit ishin atá që nga një anë u futnin vetë thika Shqiptárëve dhe nga tjetra i jepnin shpatën e kamën njerit Shqiptár të vriste vellán' e tij, keshtú që vrasja e pópullit Shqiptár punohej nga dy anë kurdohërë.

Barbaria e paqytetëria e Turqve shojtnë krejt

edhé ató pak shkendija qe kishin mbetur ne Shqipeni nga qyteteria e saj e vjeter. Me keté menyre, vendi yne i mjere mbet n' erresire e pothua ne barbari, aqe sa bota e jashtme s' e numeronte asfare si nje nga popujt e Evropes, sidó qe pópulli yne eshte nje nga mé te vjetrit t' Evropes se tere. Vetem nje gje te mire gjente bota e jashtme ne karakterin e Shqiptarit nené Turqine: trimerine dhe pafrikesin' e tij me anen e se ciles Shqiptari tregohej qe ish i vétemi qe munt t' i bente balle Turkut barbár. Po edhé keté te mire bota e jashtme s' e çmonte aqe shume, dyke kujtuar qe trimeria e Shqiptarit i detyrohej padijes e paqyteterise se tij.

Po ketó s' ishin demet e vétema q' i bene Turqit kombit tone.

Nje nga rrjedhjet e para te pushtimit turk ish qe femijet mé te degjúara te Shqiperise, ató femije qe kishin qendruar besnikerisht rreth Gjergj Kastriotit, femijet e gjenerâleve dhe te kapedâneve te tij, ikne nga Shqiperia dhe vane te vendosen ne vende te huaj, e mé teper n' Itali, ku sot ka mé teper se 200,000 Shqiptare, dyke mos mundur te duronin zgjedhen dhe roberin' e huaj.

(Shiko Kendimin: SHQIPTARET E ITALISE, faqe 131).

Sterniprit e Skenderbeut vete hyne ne sherbimin ushteriák te Perandorit t' Austrise. Nga ana tjeter, ushtaret mé te mire te vendit hyne ne sherbimin e mbréterve te huaj, si te Francez, t' Inglise,

t' Austrisc e tc Republikes Venetike. Me kctć menyrc, pōpulli shqiptár mbet i shkretc, pa kapedanc e pa udhehoqes.

(Shko Kendimin: USHTARE SHQIPTARE NC DHERA TE HUAJA, faqe 133).

Veç ketyre, siç do tc shohim mć poshtc, Sulltani i vuri Shqiptarct tc vriteshin vellá me vellá, Gegc me Toskc, Gegc me Gegc, Toskc me Toskc, q' ashtú Shqiptarct tc mos muntnin tc bashkóheshin nonjć herc kunder armikut tc bashkct: Turkut.

E pak mć von iu-dha rasja Turqve qc t' i ndanin Shqiptaret ca mć keq, siç do tc shohim tanć.

2.—Kryengritjet Kunder Turqve

Me gjithc mundimet e tyre, Turqit s' muntnc kurrc qc t' a shtronin Shqiperinc. Kurdohere qc zgjedha turke hehej e rendc, Shqiptaret rroknin armct, dhe nerrnin malet e larta ku s' i arrinte dora e Sulltanit, se me gjithc ndarjet e tyre s' muntnin tc harronin shijen e lirisc. Keshtú, pra, kohc me kohc ngjisnin kryengritje tc modhá. Nga ató kryengritje do tc shcnojme ketú vetem ató mć tc shcnúarat qc ngjanc qc mc 1500 gjer mc 1740; tc tjerat do t' i shohim kur t' u vinjc radha. Po njc gjc duhet mbajtur ment qc Shqiptaret benc 20 kryengritje kundra Turqve qc mc kohcn e pushtimit e gjer mc 1912.

E para kryengritje e madhe u-bc mc 1571. Shqiptarct ngritnc krye porsá degjuan qc Turqit ishin mundur nc njc beteje tc madhe prej Austriákcve, dyke u-mundsur qc tc hiqnin vcrejtjen

e tɛ kerkonin ndihmɛ nga popujt e tjerɛ t' Evropɛs. Po dykɛ mos marrɛ nonjɛ ndihmɛ nga jashtɛ u-unjnɛ perserí mɛ deshpɛrim.

Mɛ 1592 u-ngritnɛ perserí mɛ qellim qɛ tɛ shpetonin njɛ herɛ e mirɛ nga zgjedha e Sulltanit, dhe i falɛ kuroren e Shqiperisɛ *Karol Emanuelit* tɛ Savoisɛ. Po Karoli kish tɛ tjera halle ni kokɛ, e as kuroren e pranój as u dha nonjɛ ndihmɛ Shqiptárevɛ tɛ mjerɛ.

Mɛ 1606, Shqiptarɛt bɛnɛ edhé njɛ kryengritje tɛ rɛ, e kɛté radhɛ ia falɛ kuroren e Shqipɛrisɛ perandorit t' Austrisɛ, po edhé kjo kryengritje vajti mɛ kot, dhe vendi u-mbyt nɛ gjak. Pak mé von, Shqiptarɛt iu-drejtuan perserí disá princɛrve t' Italisɛ e pastáj Spanjɛs dhe Papɛs vetɛ, po s' gjetnɛ asgjékundi nonjé perkrahje.

Po mɛ 1689, u-duk sikur me tɛ vertét kish erdhur dita e lirisɛ pɛr Shqipɛrinɛ. Turqia gjendej n' até kohɛ nɛ luftɛ me Austrinɛ, dhe njɛ trupɛ e ushtɛrisɛ austriake arrijti nɛ kufirɛt e Shqipɛrisɛ. Shqiptarɛt u-ngritnɛ njɛmenjɛ e u-bashknuan mɛ Austriakɛt kundra Turqvɛ, po, pɛr fat tɛ keq, kumandari austriák nukɛ dijti qysh tɛ sillej kundréjt Shqiptárevɛ, tɛ cilɛt u-zemruan dhe i vunɛ pushkɛn.

Mɛ 1737, Austriakɛt hynɛ prapɛ nɛ Shqipɛrí, dhe Shqiptarɛt zemɛr-djegur pɛr lirí harruan tɛ shkúarat e vrapuan qɛ tɛ bashkóheshin mɛ 'tá. Po kumandari austriák i kesáj fushatɛ jo vetɛm qɛ s' i ndihmój dot Shqiptarɛt po edhé i la nɛ mɛ-

shiren e Turqve. Me gjith' até, Turqit bene dy vjet plot qe t'a mbytnin kryengritjen e Shqiptáreve me menyrat mé barbare, dyke shkaterruar vendin e dyke farosur njérezit.

Ketó kryengritje, e veçán te dyja te fundit, patne nje perfundim fort te math per Shqiperine. Pasí u-mbytne kryengritjet, Turqit nisne te mandonin rende atá qe ishin bere shkak e atá qe kishin marre pjese ne ketó kryengritje, dhe atá te mjerct s' pane nonjé udhe tjeter per te zbutur zemren gjakpirese te Turqve veçsé dyke perqafuar fene myslimane. Turqit kishin vene qe nje here force per keté pune, po mbarimi i kryengritjeve u dha rasjen mé te mire, e Shqiptaret e mundur s' pane dot tjeter udhe shpetimi. Me keté menyre nisi te perhapet fea mohamedane ne Shqipeni ner luftetaret e kryengritjeve kundra Turqve. Per fat te keq kjo ngjarje u-be shkak per nje ndarje te rezikeshme ne mes te pópullit shqiptár, dyke qene se Sulltani e perdori até ndarje per fitim te Turqise e per te perçare ca mé teper Shqiptaret. Po ajó qe duhet shenuar ketú eshte qe, me gjithe dhelperite qe perdorte dhe me gjithe fitet qe futi Sulltani per te mbajtur lark nga njerijatri Shqiptaret mohamedane dhe Shqiptaret e krishtere, idea dhe dashuria e kombit i beri Shqiptaret qe te lefton in se bashku, pa ndryshim feje, kunder Turqve dhe armiqve te tjere, Sllaveve dhe Grékeve.

3.—Qeverimi i Shqiperisë Nenë Turqinë

Me të zenë Shqiperinë, qeveria turke vendosi që t'a qeveriste këtë vent ashtú siç qeveriste vendet e tjera të pushtuar më parë, domethenë me anë qeveritaresht turq. Po nuke shkoj shumë kohë kur pa gabimin e saj, se Shqiptaret kryelarter nuke deshin me asnjë menyrë t' u perunjeshin Páshevе që dergonte Sultlani, e disá here kryengritjet nisnë nga shkaku i urrejtjes që ndjenin vëndesit kunder këtyre qeveritáreve Anadollakë.

Këtó traxira e veçán kryengritjet që kujtuam mi siper e benë qeverinë turke që të ndronte qendrimin e saj kundréjt pópullit të Shqiperisë. Dyke parë se s' munt t'a qeveriste vendin me zyrtare të derguar nga Stambolli e që të mos ngjisnin më ngatrime dhe traxira, qeveria turke vendosi që t'a linte qeverimin e Shqiperisë në duart e parësisë së re të vendit, e cila zuri vendin e príncerve dhe zótërve që ishin më parë në Shqiperi, po me kondite që këtá të paret t' ishin të bindur tek Sulltani.

Me këtë menyrë, qeveria turke desh të vriste dy zoq me një gur. Nga njëra anë, Shqiptaret do të kenáqeshin me këtë zgjidhje, dyke qenë se nuke do të kishin më mi krye qeveritare anadollakë e keshtú do të mesóheshin të rrinin të qetë e të bindur nenë Sulltanin, dhe, nga ana tjetër, qeveria turke mbaronte punen e saj me lehtësi se sa të viste të ndiqte Shqiptaret nenë malet e egër

nɛ kryengritje e siper. Po per shiguri mé tɛ madhe, Sulltani perdori nɛ qeverimin e Shqiperisɛ njɛ menyrɛ e cila e ndau dhe e perçau pópullin pa shprese qɛ tɛ bashkohej perserí, se nɛ vent tɛ vinte njɛ qeveritár tɛ fortɛ, Sulltani i la Shqiptaret tɛ ndahen, siç kishin qenɛ edhé mé parɛ, nɛ principata tɛ vogla, dhe nɛ mes tɛ kréreve tɛ shumɛ tɛ tyre futte fite kohɛ mɛ kohɛ dhe i vinte tɛ ziheshin njeri me tjetrin, keshtú qɛ Shqiperia s' ish mé tjeter gjɛ veç se njɛ fushɛ lufte ku njeri bej leftonte kunder tjetrit, dhe njeri pashá kunder tjetrit. Dhe Sulltani bente *seir* qɛ nga Stambolli dyke ferkuar duart me kenaqesi kur shekonte se si vríteshin Shqiptaret nɛ mes tɛ tyre, keshtú qɛ s' u mbetej as kohɛ, as fuqi, as deshirɛ qɛ tɛ bashkóheshin kunder qeverisɛ se tij.

Ketó lúftera tɛ bréndeshme mbajtnɛ po-thua sa mbajti edhé zoterimi turk nɛ Shqiperí. Pak nga pak, Shqiptaret zunɛ tɛ harronin se sa e rendɛ ish zgjedha turke, e mé teper kur Sulltani djallezísht i la qɛ tɛ vetɛqeveríseshin, dhe me kohɛ shumica e pópullit shqiptár, nɛ mos pópulli i terɛ, mesój qɛ t' i bindej Sulltanit e tɛ leftonte per té sikursé t' ish aý mbreti i vertetɛ i Shqiperisɛ. Keté bindje kundréjt tij, Sulltani u-perpóq qɛ t'a shtonte dyke i marrɛ me tɛ mirɛ kreret e Shqiperisɛ, tɛ cileve u hapi dyert e shkálleve mé tɛ larta tɛ qeverisɛ sɛ tij, dhe i mbushi me ndere e me dhurata. Keshtú, shumɛ Shqiptarɛ arrijtin tɛ béheshin kryeminister, minister, ambasadorɛ,

gjenerale, admirale e te tjera, me perfundimin qe sa shkonte koha aqe mé teper Shqiptaret perçáneshin ne mes te tyre dhe harronin Shqiperine qe t' i ngjiteshin Turqise dhe Sulltanit.

PERMBLEDHJE

(Te mesohet me goje)

1. Pushtimi turk ish aý mé i rendi e mé i demshmi nga pushtimet qe ka pare Shqiperia, se Turqit barbare shojtne krejt edhé ató shkendijat e paka qe kishin mbetur nga qyteteria e saj e vjeter. Turqit perçane pópullin shqiptar dhe e lane prapa nga popujt e tjere. —dyké qene se me pushtimin e tyre femijet mé te mira te Shqiperise ikne nga vendi i tyre, dyke mos duruar dot zgjedhen turke.

2. Me gjithe mundimet e tyre, Turqit s' muntne kurre t'a shtronin Shqiperine, e kohe me kohe Shqiptaret ngrinin krye per te shpetuar nga zgjedha turke. Ne kohen qe qendroj Turqia ne Shqiperi, Shqiptaret bene 52 kryengritje, te vogla e te medha. Qe me 1501 gjer me 1740 ngjane pese kryengritje te medha, veç te voglave.

3. Dyké pare se s'i shtronte dot Shqiptaret, qeveria turke i la qe te qeveriseshin prej krereve vendes, me kondite qe ketá t' ishin te bindur tek Sulltani, i cili nga ana tjeter, e beri zakon qe te futte fite ne mes te ketyre kréreve, dyké ndersyer njerin kundra tjetrit. keshtu qe te mos muntnin te merreshin vesh ne mes te tyre per te leftuar bashkerisht kunder Sulltanit. Nga ana tjeter, Sulltani u-perpoq qe t' i bente Shqiptaret me anen e tij, dyké u dhene zyra dhe shkalle te medhá ne qeverin' e tij.

PYETJE PER STERVITJE

1. Ç' te keq i beri Shqiperise pushtimi turk e persé?—Cili eshte ndryshimi midis pushtimit turk e te pushtimeve te tjere, fjala vjen te Gotheve e te Sllaveve? —Cili pushtim ka qene me i demshem e perse?—

Ç' pesoj qyteteria e vjeter e Shqiperise ne duart e Turqve?—Ç' mejtonte Europa per popullin tone?—Kish te drejta apo jo?—Cila ish rrjedhja e pare e pushtimit turk?—Perse ikne dhe ku vane femijet e vjetra te Shqiperise?—Ç' u-bene sterniprit e Skenderbeut?—Ne ç' sherbim hyne ushtaret shqiptare pas vdekjes se tij?—Persé Sulltani i vuri Shqiptaret te vriteshin ne mes te tyre?

2. A u-shtruan Shqiptaret prej Turqve?—Ç' benin Shqiptaret kur u rendonte zgjedha turke?—A e kishin harruar shijen e lirise?—Sa kryengritje bene gjithesej Shqiptaret kunder Turqve?—Sa kryengritje te medhá ngjane qe me 1501 gjer me 1740?—Kur e si ngjane keto kryengritje?—Cili ish perfundimi i tyre?—Kush leftonte kunder Turqve, Sllaveve dhe Grekeve, vetem Shqiptaret Mohamedane apo Shqiptaret e Krishtere?

3. Qysh desh t' a qeveriste Sulltani me pare Shqiperine?—Ç' u-ngjiste qeveritareve turq?—Perse Shqiptaret s' deshin te kishin qeveritare anadollake?—Cili ish shume here shkaku i kryengritjeve?—Ç' vendosi te bente pastaj qeveria turke?—Si do te qeverisej pasketaj Shqiperia?—Si e perse do te kenaqeshin Shqiptaret me menyren e ré te qeverimit?—Si e persé ish e kenaqur qeveria turke?—Cilit ishin te dy zoqte qe desh te vriste me nje gur qeveria turke?

4. Qysh i mbante Shqiptaret te bindur nene veten e tij Sulltani?—Me ç' menyre futte fite ner kreret e Shqiperise dhe i bente te leftonin njeri me tjetrin?—Ish gje e mire ajo per Shqiperine?— Si perpiqej, nga ana tjeter, Sulltani qe t' i bente Shqiptaret me vete?—Ç' shkalla te larta arrijtin Shqiptaret ne sherbim te Sulltanit?—A kish nonje fitim Shqiperia nga keto shkalla te larta te bijve te saj?

KENDIME

SHQIPTARET E ITALISE—Shqiptaret e Italise, per te cilet thame mé siper qe perbejne sot nje numur prej mé teper se 200,000 shpirt, ikne nga Shqiperia pas vdekjes se Skenderbeut, ne kohen kur Turqit kishin zene keté vent. Shkaku

i ikjes sc tyre eshtc se s' rronin dot nenc zgjedhen turke dhe deshin vent tc lire. Nc mes t' atyre q' iknc ishin femijet mé tc mira tc Shqiperisc, ató femijc qc kishin qendruar besnike rreth Skenderbeut, keshtú qc atyre u-dukej mé e rendc zgjedha turke se sa pópullit tjeter pergjitherisht. Gjeneralet, keshilltaret dhe njérezit mé tc larter tc mbreterisc u-hothnc pertéj Adriatikut bashkc me pasaniket e tyre tc shumc, dhe n' Itali hync nc sherbimin e mbreterve tc vendit. Shumc nga atá u-mirerpitnc prej Ferdinandit, mbretit tc Napolit dhe u-vendosnc nc plenget q' ay mbret i kish dhenc Skenderbeut si shperblim per ndihmen qc pati nga mbreti shqiptár kundra Angjevinevc.

Edhé çuditerisht, mé tc shumct e Shqiptarevc t' Italisc u-vendosnc n' ató krahina per tc cilat kish vajtur tc leftontc mé parc Aleksandri i Molosisc dhe Pirrua dhe tc cilat nc kohen e ketyre dy mbréterve ishin tc ndenjur prej njercs tc racës pellasgjike.

Shqiptaret e Italisc janc tc vétcmit qc kanc patur liri tc plottc qc tc perdornin gjuhen shqipe, pa nonjé ndalim nga nonjé anc, nc shkrim, nc kendim e nc kishat e tyre, dhe kanc nxierr disá shkrimtare tc mpsuar, mé i madhi nga tc cilet eshtc *Girolamo da Rada*, i cili i ka bere shumc sherbime letretyres shqipe.

Gjith' ashtú Shqiptaret e Italisc s' e kanc haruar mcmcn e tyre tc bashket, Shqiperinc, dhe nc kenget e tyre tc búkura e kujtojnc kurdohere

me mall të math. Ditët e Páshkëve, Shqiptarkat e Italisë lozin një valle, e cila quhet *Vallja e Skenderbeut*.

Po veten e tyre s' e qúajnë "Shqiptarë", po e qúajnë "Arbreshë", dhe Shqiperinë e qûajnë "Arberi".

Nga ana tjeter, Shqiptaret e Italisë i kanë dhënë atdheut të tyre të ri një numur burrash të shënuar, në mes të cilëve eshtë *Francesco Crispi*, (shqip kendohet: Françesko Krispi), që bëri dy herë si kryeminister i Italisë.

USHTARË SHQIPTARË NË DHERA TË HUAJA—Pas pushtimit të Shqiperisë prej Turqve ikën nga vendi yne shumë burra, veç femíjeve që u-vendosën n' Itali, të cilët hynë në sherbím të mbréterve t' Evropes, si ushtarë me rrogë, dyke qënë se s' duronin dot zgjedhën e rendë turke.

Trupa të tera ushtaresh shqiptarë hynë në sherbím të Francës, dhe të tjera trupa u-bashkuan me ushterín' e mbretëreshes s' Inglisë, *Elisabeth*, për të cilen lëftuan në Belgji e në Francë.

Buja e madhe që kishin bërë n' Evropë fitimet e Skenderbeut kunder Turqve i bënte mbretërit e Evropes që të pagúanin rroga të medhá për të marrë në sherbímin e tyre ushtarë shqiptarë që kishin çuditur botën me trimërín' e tyre.

Mé von, Shqiptaret lëftuan edhé në sherbím të Rusisë.

Po veç ushtárëve, edhé robat e Shqiptarit ishin bërë si *modë* até kohë n' Evropë. Kur bënë

një pejkje në mes të tyre, në krye të shékullit 16të, mbreti i Francës me até të Inglisë, që të dy ishin veshur me roba Shqiptare.

Sikunder thamë mé siper, sternipríit e Skenderbeut kishin hyrë në sherbim të perandorit t' Austrisë, dhe mé i funtmi nga atá, i cili quhej *Don Ferrando Skenderbéj*, u-vra në betejën e *Pavise*, 1525, q' u-be në mes të perandorit t' Austrisë e të mbretit të Francës.

Kjo ikje e búrave nga Shqipëria e la pópullin si të shkretë dhe solli një dëm shumë të math.

II
KRYEQEVERITARËT E LIRË TË SHQIPËRISË

Mé siper pamë menyrën djallezore me të cilen qeveria turke vendosi që t'a qeveriste Shqipërinë dhe t'a mbante nenë úrdhërin e Sulltanit, dyke e perçarë pópullin me themelimin e një número të math principatash të lira shqiptare të cilat i vinte të zíheshin njera me tjetren gjithmonë. Për të forcuar mé mirë këté sistém qeverimi, sicili nga qeveritarët e Shqipërisë ish i shtrenguar që të merrej vesh drejt për drejt me qeverín' e Stambollit e të mos kish të bënte gjë prej gjeje me qeveritarët e tjerë të vendit.

Po nukë shkoj shumë kohë kur duall disá ngatresa të papritura për qeverín' e Sulltanit. Sadó të perçarë e të ndarë q' ishin Shqiptarët,

sadó dhelperí qe perdorte qeveria turke qe t' i mbante besnike te Sulltani, sadó shkalla te larta qe u jepte, prape Shqiptaret s' e kishin humbur as muntnin te humbisnin embelsín' e lirise e dashurine per kombin e vete, keshtú qe erdhi nje kohe kur vete veglat e pregatitura prej qeverise turke per te mposhtur pópullin shqiptár u-kthyen kundra Turqise e Sulltanit.

Dy nga qeveritaret e Shqiperise, njeri ne veri dhe tjetri ne juge, u-mundúan dhe gjer me nje pike fituan qe te çkepúteshin nga kontrolli i Sultlanit, dyke themeluar dy principata te medhá, te cilat, çuditerisht, u-shembellenin fort mbretërive te vjetra t' Ilirise e t' Epirit. Ketá qeveritare te çquar emrat e te cílëve s' duhen harruar prej Shqiptáreve jane: *Bushatasit* e Shkodres, dhe *Ali Tepelena* i Janines.

Le te shohim tani ç' bene ketá burra te çquar.

1.—Bushatasit e Shkodres

Perjashta Shkodres ish nje katúnt i vogel i qúajtur *Bushat* ku bejleret e pashallaret e Shqiperise se siperme kishin çifligjet e tyre. Mé e para nga ató femije ish shtepia e Bushatasve te cilet mundi keté emer nga ay katúnt. Ne krye te kesáj shtepie ish *Mehmét Bushati*, i cili ne mezin e shékullit te 18te iku nga fshati e u-vendós ne Shkodre. Mehmeti ish nje njeri fort i zgjuar e dinák, dhe dyke u-vendosur ne Shkodre nisi te

punonte per te vene ne dore qeverimin e asáj krahine. E para pune qe beri ish qe te bente anetare dhe te formonte nje partí te forte, dyke mbledhur pópullin, te Krishtere e Mohamedane. Mé von zuri te qeronte nje nga nje bejleret dhe bejushet e vegjel q' ishin mun si gjemba per Shqiperine dhe per 'té, dyke qene se qeveria turke futte gjithenjé spica ne mes te tyre e s' i linte qe te mérreshin vesh.

Masat e rrepta qe po merrte Mehmét Bej Bushátasi arrijtin ne vesh te qeverise turke, e cila u-tremp fort nga nje gje e tille dhe dergój me nje here nga Stambolli nje Pashe turk qe te mesonte se ç' ngjiste. Po finoku Mehmét jo vetem q' e genjeu pashen anadollák po edhé e bindi qe t' i çonte fjale Sulltanit qe, per te miren e Turqise, kryeqeverimi i Shkodres duhej t' i jepej Mehmét Bushatasit. Me keté menyre, Mehmét Bushátasi fitój kryeqeverimin e Shkodres per shtepín' e tij, bres pas brezi, dhe taní u-be *Mehmét Pashe*, osé mé mire *Mehmét Pashe Plaku*, siç e qúanin Shqiptaret.

Me ndihmen e djemve te tij, nje nga te cilet ish *Kará Mahmuti* i degjuar, siç do te shohim mé poshte, Mehmét Pasha iu vu me kujdés te math punes se farosjes se bejléreve te tjere q' ashtú te mos i mbéteshin nocá kundreshtare, e ne pak kohe krahina e Shkodres u-be posí nje principate e lire shqiptare, e cila zgjatej qe ne Tivár e Ulqín gjer n' Elbasán.

Kur vdiq Mehmét Pashe Plaku vendin e tij e zuri i biri i tij *Karà Mahmuti*, i cili u-tregua shumë mé i zoti se i ati. Pasha i ri i krahines se Shkodres ish një burrë fort trim e i mentsbem, liberál dhe ventdashes, luftetár i math sa mundi me radhe Turqit, Malziasit, Venetikasit, Greket e të tjerë.

E para punë e tij ish që të forconte bashkimin e pópullit, dyke afruar Mohamedanet me të Krishterét, dyke nderuar e forcuar kanunet e vendit, si kanunin e Leke Dukagjinit që ky gjenerál i Skenderbeut e ka patur lenë per trashegím nè malesit' e Shqiperisë së siperme. Kjo tregón se Karà Mahmuti mendohej si Shqiptár i kthjellte.

(Shkó kendimin: KARA MAHMUD PASHA, faq. 152).

Në krye, ný defiehej si i bnidur tek Sulltani, dhe kur plasi kryengritja e parë greke më 1770, Karà Mahmuti u-hoth në Greqi, me porosí të Sulltanit, dhe e mbyti kryengritjen. Po kur e forcój vendin e tij s' ia vinte nspák veshin qeverisë turke.

Karà Mahmuti hyri në Mal të Zi dy herë me Shqiptaret e tij. Më 1785, i ndihmuar edhé prej Mirditasve, arrijti gjer brenda në Cetinë, e kur po kthehej q' andéj prishi disá vende q' i perkisnin Republikes Venetike, e eila u-qa në Stamböll kunder tij. Per të mposhtur keté Shqiptár kaqe të kuxuar, qeveria turke dergój një ushtrí kunder tij, dhe një betejë e madhe u-bë në fushen

e Kosovës, ku Turqit u-thyen ploterisht prej Shqiptárëve të Karà Mahmút Pashës.

Per të patur një krah të fortë në luftën kundër Sulltanit, Karà Mahmuti hyri në marrëveshje me perandorin e Austrisë, *Josefin II*, dhe kjo gjë e terbój Sulltanin e Turqisë, i cili mblodhi një ushtërí tjetër e u dha zë pashallúkëve të tjerë të Shqipërisë të bëheshin gatí e të vinin kundër Pashës së Shkodrës. Me këtë menyrë u-mblodh një ushtërí prej 60,000 burrash e cila vajti dhe rrethój Karà Mahmutin në Shkodrë. Në këtë ushtërí ish edhé *Ali Pashë Tepelena* me Toskët e tij. Pasha i Shkodrës bëri disá sulma të rrepta kundër kesáj ushtërie, po dyke parë që s' ia dilte dot número të saj të math u-mbyll vetëm me 80 shpirt në Keshtjellën *Rosafá* dhe mbet atjé i rrethuar. Po até që s' mundi të bënte më fuqí, Karà Mahmuti e fitój me ngjuarësi. Që prej Keshtjellës Rosafá dergój njerës tek Ali Pasha Tepelena, dhe u-muar vesh më 'të që t' i linte një shtëk të hapur për të dalë jashtë nga keshtjella.

Kur erdhi dita e caktuar, Karà Mahmuti dolli jashtë me shokët e tij të paket, dhe, në mes të turbullimit të papritur që ngjau, u-hoth dhe zuri topat e Turqve. Ushtëria turkë iku e shkaterruar, dhe Shqiptarët e fituan luftën ploterisht. Pak më von, Karà Mahmuti mundi dhe dermój tri ushtërí të tjera turkë të cilat kishin erdhur për ndihmë të ushtërisë së parë.

Ky fitim i dha kurajë perandorit t' Austrisë

i cili i çoj dhurata dhe ambasadore per te lidhur besen ne mes t' Austrise e te Karâ Mahmutit kunder Sulltanit. Po per fat te keq, ambasadoret e Austrise u-vrane ne te pabese, e gjer sot s' dihet se kush i vrau.

Mé von, Karâ Mahmuti u-sul kunder Malziasve, po, dyké mos fituar gjc m' até krah, u-kthye tani nga ana e Toskerise te cilen aý desh qe t'a shtinte ne dore dhe te bashkonte tere Shqiperine nenć qeverimin e tij. Me keté qellim parasýsh, Karâ Mahmuti u-hoth qe te merrte *Beratin*, i cili ish ahere kryeqytét i Shqiperise se poshtme, e me keté menyre ndezi, per fat te keq, armiqesine ne mes te Gégeve e te Tóskeve. Ne nje beteje te madhe q' u-be ne mes te Gégeve e te Tóskeve u-vrane mijera nga te dy anet, po Karâ Mahmuti e fitój luften, e tani ndha ish e hapur per 'té qe te zinte edhé Toskerine, po u-shtrengua qe te kthehej ne Shkodre nga shkaku i disâ trazirave qe kishin ngjare atjé.

Me 1796, Karâ Mahmuti hyri perseri ne Mal te Zi ku edhé u-vra dyke leftuar trimerisht.

Pas vdekjes se tij, qeverimi i Shkodres mbet ne duart e vellájt te tij, *Ibrahim Pashes*, i cili mbajti nje politike krejt te ndryshme nga ajó e Karâ Mahmutit. Ibrahimi u-be vegle e Sulltanit, i perçau te Krishteret e Mohamedanet, e ndau Mirditen nga qeverimi i Shkodres dyke vrare nje nga kapedanet e saj, dhe shtypi çdo levizje per

lirí. Po Ibrahimi nuke rrojti shumc, dhe vendin e tij e zuri pas pak *Mustafá Pasha*, me 1810.

Mustafá Pasha lojti një roll shumc të math në ngjarjet e kesáj kohe. E para punc e tij ish që të bashkonte perseri pópulin, dhe u-pajtua me një here edhé me Mirditen. Me keté menyre, e forcój vendin e tij, dhe me forcen e madhe që kish s' eshte as fare çudi që vuri ndermént të bashkonte tere Shqiperinc nené qeverimin e tij. Po Mustafá Pasha s' ish i vétemi që kerkonte të shtinte në keté kohe në dore tere Shqiperine; në Shqiperin' e poshtme kish dalë tani një Pashe tjeter, Alí Tepelena, dhe mé parc se të shohim se ç' beri Pasha i Shkodres, le të vështrojmc se ç' po bente Alí Pasha në Toskerí, i cili kish zene të punonte që në kohen e Kará Mahmút Pashes.

2.—Alí Pashe Tepelena

Alí Pasha lenu me 1741 në Tepelenc, dhe ish i biri i Velí Beut dhe i Hamkos. Nga prinderit e tij s' kish asnjé shprese që të merrte nocá mesime të mira Alia, sepsé i ati, Veliu, ish një njeri i eger që kish shkuar jeten e tij me kuserí. Në keté kohe kish nisur në Toskerí e në Greqí një levizje gjysme-kryengritese dhe gjysme-kusare; njérezit e lodhur nga zgjedha turke dilnin maleve si komita e keshtú shpetonin, me një fare menyre nga zgjedha turke; po që të muntnin të rronin nepér malet ishin të shtrenguar që të vithnin e të rrembenin.

Ketá njeres ishin te njojtur n' até kohe nené fjalen greqísht *kleftai*, qe dó te thote kusare, hajdute. Nje nga atá, pra, ish edhé Veliu, i ati i Alí Tepelenes, dhe nje nga mé te liqte kusare. E ema e Aliut, *Hamkua*, ish nje grua e eger, shpirt-keqe e zemer-gur, e cila e mesój Aline qe ne voglí qe te mos kishte meshire per armík dhe kundershtár. Gjith' ajó e bashkój Aline, qe kur ish djalósh, me nje çete kusaresh, dhe mé von e dergój qe te prishte *Hormoven* e *Gardhiqin*, me qe ndénjesit e ketyre dy fshátrave i kishin punuar nje renk te turpshem Hamkos. Aliu i goditi ketó fshatra, po u-munt dhe u-kthye prape, dhe Hamkua e priti me te shara e me te peshtyra ne fytyre.

Nje rritje kaqe te keqe pati Aliu, e kur u-madhua u-suall si njerí fare pa shpirt e pa zemer. Per te fituar até qe desheronte, Aliu s' e kish per gje qe te genjente, te dilte nga fjala, te shkelte besen, te vriste e te priste. Po me gjithe ketó, s' munt te mohohet qe Aliu ish me te vertét nje njerí i math, i zgjuar, dhe i zoti per púnera te medhá.

Deshira e tij mé e madhe, kur u-rrit, ish qe te merrte qeverimin e nonjé krahine, mé teper até te Beratit, per te cilin thame q' ish kryeqyteti i Toskerise. E per te fituar até gje, Aliu nisi nga vrasjet e nga pabesite dyke i sherbyer Sulltanit q' ashtú ky t' i mbushte deshiren e zemres. Mé ne funt, si shperblim te ketyre sherbimeve, qeveria turke e emerój *Derven-Age* te grýkave te má-

leve tɛ Shqiperisɛ sɛ poshtme e tɛ Thesalisɛ, domethenɛ *Rúajtes t' Udheve*, dhe me q' Aliu kish berɛ edhé vetɛ kusár, i dinte fare mirɛ vɛndet se ku mblídheshin kusarɛt e tjerɛ; u ra, pra, edhé nɛ njɛ kohe tɛ shkurtɛr i perfshiu qɛ tɛ gjithɛ, dyke shtruar, me kɛté menyrɛ, ató vise nɛ kɛmbɛ tɛ Sulltanit.

Mɛ 1788, Alí Tepelena hyri me pahír nɛ Janinɛ dhe vuri qeverimin e tij, dyké ngrehur njɛ sɛrɛ fortesash brɛnda e rreth liqenit t' atí qyteti. Gjith' até vit, u-njojt zyrtarísht prej Sulltanit si Pashɛ i Janines. Pak mé von, u-thirr prej Sulltanit qɛ tɛ vinte kundɛr Kará Mahmutit tɛ Shkodres, dhe, siç pamɛ mé siper, u-muar vesh fshéhurazi me té. Dyké ikur nga Shkodra, Alí Pasha zuri Ohrinɛ dhe tɛrɛ grykat qɛ shpien prej Maqedonisɛ nɛ Shqiperí qɛ tɛ mos linte nonjé ushtɛri turke tɛ hynte nɛ vɛndet e tij, me qɛnɛ se aý kish vɛndosur prej kohe qɛ tɛ çkɛputej nga Turqia.

Pllani i Alí Pashes ish qɛ tɛ bɛnte me vete jó vetɛm Shqiperinɛ po edhé tɛ bashkonte me té edhé Greqin' e veriut, dhe nisitɛ ioniane, Korfuzin, Kefalonínɛ, etj. Porsa e forcoj, pra, vɛndin e tij si qeveritár i Janines, nisi tɛ bɛnte ató qɛ kish berɛ edhé Mehmet Pashɛ Plaku, domethenɛ tɛ mposhte osé tɛ faroste krejt bejlerɛt e tjerɛ, pɛr tɛ cilet nukɛ tregoj kurrɛ mɛshiren mé tɛ paktɛ. Kur i zinte e i vriste me tɛ pabesɛ, kur i burgoste nɛ burgjet e tmeruar tɛ Janines e atjé dɛrgonte Evgjitɛt qɛ t' i mundonin me njɛ mijɛ mɛnyra mizore.

Veç bejlércve, Ali Pasha pa qe kish edhé nje armik tjeter, i cili nuk' unjej nenć qeverimin e tij: *Fshatrat e Sulit.* Ketó fshatra, te ndénjura prej Shqiptaresh te Krishtere, kishin rúajtur lirin' e tyre maje máleve dhe greminave qe ne koben qe Toskeria e tere ra ne duart e Turqve, dhe perbenin republika te vogla qe veteqeverísheshin, pa n-ngarc nga qeveria turke. E tani Ali Pasha vendosi qe t' ua merrte até liri, mbasi deshira e tij ish qe çdo pellembe vent qe gjendej nenć qeverimin e tij duhej t' ish krejt i bindur n' órdherin e tij. Po Suli s' ish mesnar qe t' i bindej nonjé tjetri veç pleqve te fshátrave qe zgjidheshin prej pópullit. Ali Pasha beri tri fushata te medhá, kurdohere me mé tepcr se 10,000 ushtarc kunder atyre fshatrave te vogla qe nuk' ishin mé teper se 500 shtepí gjithsej. Po Suliotet s' e kishin harruar trimerine shqiptare me te cilen i kishin bere balle mé parc Turqise se tere, dhe ushterit' e Alí Pashes múndeshin ne çdo sulme qe benin. Ne fushaten e dyte, dermimi i ushterise se tij ish aqe i math sa edhé vete Aliu ment rá rop né duart e Suliótcve. Shume here armuarr vesh ne mes te tyre Suliotet dhe bejleret per te leftuar se bashku kunder Ali Pashes, po Tepelénasi gjente kurdohere menyre qe t' i ndante e t' i perçante. Dhe kur pa qe s' ua dilte dot Suliótcve me ushterí, Ali Pasha vendosi qe te perdorte edhé nje here pabesine ne te cilen nuk kish shoq. Me te holla e me djallezí te tjera, dhe me tradhetin' e *Pilo Gushit*, i cili ish Suliot edhé

vete, mundi qe te largonte nga *Suli Foto Xhavellen*, qe ish shpirti i trimerise suliote, si edhé disá nga kapedanet mé te mire, dhe ahere Alin in turr Sulit pa pandehur, dhe pas nje lufte te rrepte ku shkelqen trimeria shqiptare, po, per fat te keq, me vellavrasje, Suli ra ne duart e Ali Pashes ne Dhjetör 1803. Nje murg, i qúajtur *Samuél*, i cili ish édhe si kapedán i Suliótéve, u-vari zjarr vózeve te barutit dhe ay me gjith' shoke u-hoth n' ere.

Nje ngjarje tjeter, e tmerruar po e lavderúarshme, ish vdekja e grave te *Zalongut*. Dyké pare se po vinte ushteria e Ali Pashes, dhe qe te mos binin ne duart e tyre, grat' e ketij fshati u-zune prej dore, sikur do te losnin valle, e dyké mbajtur fcmijet e tyre pas dore osé ne gji, u-leshuan tatepjete nga maja e bregut dhe u-vrane te gjitha me até menyre. Sa keq dubet te na vinje e sa lot dubet te derdhim kur shekojme se sá me kot ka vajtur kjó trimeri e shkelqyer dhe pa shembell ne nje lufte ku Shqiptari vriste Shqiptarin!

Njérezit qe rane ne dore t' Ali Pashes u-vrane me menyrat dhe mundimet mé te tmerúara. Ali pasha nuk' fa as gur mi gur ne vendet ku ishin fshatrat e Sulit. Suliotet qe shpetuan u-hothne ne Korfus ku hyne ne sherbim te Rusise e pastáj te Francés e cila perberi me atá nje trup te veçante qe u-quajt *Regjiment Shqiptar*. Ne mes t' oficércve te ketij regjimenti ishin dhe kapedanet e vjeter te Suliótéve *Marko Boçari* e *Foto Xhavella*.

(Shkó kendimin: KENGA E SULIOTÉVE, faq. 154).

Ne këtë kohe, Ali Pasha kish arritur ne kulmin e fuqisë se tij. Po pak më von, bejleret ngritne krye perseri e u-lithne ne mes te tyre qe te leftonin Ali Pashen, e me até rasje Aliu zuri atá më te shenuarit dhe i vrau qe te gjithe.

E tere Shqiperia e poshtme osé Toskeria, qe n' Elbasán e gjer n' Arte, si edhé Thesalia ishin tanî ploterisht nenë qeverimin e forte t' Ali Pashes, i cili kish nisur ne këtë kohe qe te lonte me Shtetet e medhenj t' Evropes, me Francen, me Inglinc, me Rusinc, e me te tjerc. Ne këtë kohe, gjith' ashtú leftonte lúfterat e medhá e te çuditeshme burrî më i shkelqyer i kóheruve te rea, *Napoleoni i Math.* me te cilin pati shume te benje Ali Pasha.

Me 1789 u-be nje kryengritje e madhe ne Francë, e mbretit te saj *Louis XVI* iu pre koka, dykë marre vete pópulli qeverimin e vendit. Po me 1799 dolli burri i çuditeshme, *Napoleon Bonoparti*, i cili mposhti pópullin kryengrites dhe kater vjet më von u-kurorezua *Permadór i Frances*, passi mundi dhe shtirí ne kembet e tij pothua se tere Evropen, perveç Inglise. Tere ushterit' e bashkúara t' Evropes s' munatne t' ia prishin hovin ketij gjenerali te math. Finoku Ali Pashe veshgonte me verejtje te madhe ndryshimet e fatit te luftes qe po mbytte Evropen, e kur shekonte qe fitonte Napoleoni vraponte te merrej vesh me té; perkúndrazi, kur shekonte qe fitonin armiqt'e tij Aliu hidhej me nje here nga ana e tyre. Dhe kur Napoleoni po bente paqe me Rusinc me 1807, Ali Pasha i dergoj pe-

randorit të Francës një nga ministrit e tij që t'a kujtonte për sherbimet q' i kish sjellë e për shperblimin që priste nga Napoleoni.

Po me tërë lartesinë që fitoj, Alí Pasha s' harroj mallkimin q' i kish lënë e ema, Hankua, e cila kur do të vdiste, i la si porosí që të merrte gjakun nga Hormova e Gardhiqit. Kur i rane, pra, këtó fshatra në dorë, Alí Pasha mori gjakun plotësísht dykë prishur fshatrat nga themelet e dykë therrur të gjithë ndénjesit e tyre.

Sidó që të jetë, në vitin 1812 Alí Pasha kish mbushur deshirat e zemres dhe taní ish mé i fortë se një mbret. Desh, pra që t' a shtrinte mé tepër fuqin' e tij dykë vënë në dorë tërë Shqipërinë. Po aý ish mjaft i zgjuar sa të shihte se Bushátasit e Shkodrës ishin tepër të fortë në Shqipërin' e siperme, e muk desh që të hynte në luftë të hapur me 'tá. Po kur pá që Ibrahim Pasha i Shkodrës po bënte armiq me sjelljet e tij dhe q' aý e kish zemëruar Mirditën, Aliu vrapoj të ndihmonte terthori armiqt' e Ibrahimit, dykë i dhënë prekrahje të veçantë Mirditës. Kur e zuri vendin e Ibrahimit Mustafá Pasha, i cili, siç thamë, u-pajtua me Mirditën, Aliu kërkoj të merrej vesh me Pashën e Shkodrës që të rronin të dy në miqesí e mos i binin më qafë njëri-jatrit. Për të formuar këté miqesí, Aliu i dhá Mustafá Pashës për grua të mbesën e tij.

Sikunder shihet lehtë, në këté kohë, Shqipëria e tërë ish e lirë, po e ndarë më dysh; njërën pje-

se e kish Mustafá Pasha, dhe tjetren Alí Pasha. Sikur te mund te mërreshin vesh ketá dy, Shqiperia do te kish shpetuar pa dyshim nga dora e Sulltanit qe n' até kohe. Po per fat te keq, ndjenja e kombesise s' ish perhapur mjaft ne pópullin n' até kohe, sa t' i shtrengonte te dy pashallaret qe te benin nje bashkim, ndonese deshira per liri e veteqeverim kish fituar me te gjithe anet. Bashkimi i nje kombi vjen kur pópulli vete e ndjen nevojen e tij.

Pas ketyre fitimeve, Ali Pashes i kishin mbetur syte mi *Pregen*, e cila ish i vetemi qytet jashte zoterimit te tij. Po edhe Pargen e mori me 1818, dyke e blere nga Englezet; po njerezit e saj ikne qe te gjithe qe te mos binin ne duart e tij.

Nderkohe, Alí Pasha i ish vene punes s' organizimit te Shtetit te tij. Kish sjelle nga Evropa organizatore per deget e ndryshme te qeverimit; formoj ushteri pas sistemit evropián, kembesí, kaloresí, artilerí; ngriti fortesa e keshtjella me te gjitha anet; miresoj bujqesine e tregetine; hapi shkolla, e themeloj edhé nje biblioteke. Me nje fjale, Alí Pasha mundohej qe t' a bente nje vent krejt evropián Shqiperine qe kish nené zoterimin e tij, e sikur te kish mbajtur édhe ca kohe qeverimi i tij, Shqiperia do te kish dale e fituar ne qyteterí e perparim. Ketó riforma qé numeruam mé siper tregojne madheshtin' e vertete t' Alí Pashes dhe pakesojne gjer me nje pike ligesit' e medhá qe beri. Gjith' ashtú tregojne q' Alí Pasha ish njeriu

qe munt te ngjallte Shqiperine e t'a bente nje komp me ane te mesimit e te qyteterise.

Per fat te keq, puna e Ali Pashes mbet gjer n' até pike, se me 1820 Sulltani, i cili kish shpetuar prej kobe nga trazirat e tjera, vendosi tani qe te shtronte edhé Ali Pashen, dhe vitin tjeter, dy ushteri turke u-nisne kunder Janines. Dyke u-gjendur perpara ketij reziku te tmeruar Ali Pasha u-tregua njeménd nje njeri krejt i ndryshme nga aý q' e dinin bota gjer ahere, *nje njeri i kohes se re*. Thirri me nje here nje mbledhje te madhe ne Janine, ku ftoj tere kreret e Shqiperise, Mohamedane e te Krishtere, me anen e te cileve desh te ngrinte *pópullin* qe te leftonte *per lirin'* e tij. Te gjitheve u-zotohej qe paskétáj do te qeveriste me butesí e drejtesí, e nuke do te merrte nepér kembe te drejtat e askújt. I ftoj Suliotet e mjere, dyke kerkuar ndjese per te keqiat q' u kish punuar. Grekve iu zotua qe t' u jepte liri te plotte po t'a ndihmonin kunder Turqise. Me nje fjale, Ali Pasha u-mundua qe te zgjonte ne zemrat e pópullit *ndjenjen e kombesise e dashurin' e atdheut*, ne vent te hindjes se verber ne kreret e tyre. Me ketó thirrje, Ali Pasha ndezi nje kryengritje te madhe, po per fat te keq, Shqiperia s' fitój gje nga ajo. Suliotet, liridashes te vertete, u-kthyen perseri ne Sul dhe leftuan nenë kumanden e Marko Bocharit si lunne per krah t' Ali Pashes kunder Turkut. Po Mustafá Pasha i Shkodres dhe Mirdita qe duhej t' ishin bashkuar ne ketë

rasje, ndenjne, per fat te keq, besnike tek Sulltani, dhe Shqiperia humbi rasjen mé te mire qe te shpetonte nga Turqia.

Pas dy vjetsh lufte te rrepte ne te cilen Shqiptaret e Toskerise, te Krishtere e Mohamedane, leftuan trimerisht, Turqit hyne me te pabese ne Janine dhe therre Ali Pashen, koka e te cilit u-dergua ne Stamboll (1822).

(Shiko kendimin: VDEKJA E ALI PASHES, faq. 154.)

PERMBLEDHJE

(Te mesohet me goje)

1. Qe te moe kishin nonje rasje te merreshin vesh ne mes te tyre, qeveritaret e Shqiperise jshin t' urdheruar qe te merreshin vesh drejt per drejt me qeverin' e Stambollit. Po ne gjysmen e shekullit te 18te, dy qeveritare Shqiptare, Mehmet Bushatasi ne Shkodre, dhe Ali Tepelena ne Janine, arijtin qe te themelonin principata te lira shqiptare.

2. Mehmet Bushatasi nisi nga puna dyke mposhtur bejleret e tjere te cilet qeveria turke i perdorte si vegla per te mbajtur Shqiperine nens Sulltanin. Por te pare traximet qe ngjisnin ne Shkodre, qeverin turke dergoj nje Pashe anadollak, po Mehmet Bushatasi e genjeu dhe e beri qe Sulltani t' a emeronte Pashe te Shkodres, dyke marre emerin *Mehmet Pashe Plaku*.

3. Pas vdekjes se tij, qeverimin e Shkodres e nori i biri Kara Mahmuti, i cili e bashkoj popullin, pa ndryshim feje, dhe forcoj vendin. Leftoj tri here me Malin e Zi, e kur kthehej nga nje prej ketyre fushatave prishi disa vende te Venetise.

4. Venetia in-qah Sulltanit, i cili dergoj nje ushteri te madhe, po Kara Mahmuti e mundi ne fushen e Kosoves, dhe per te fituar krah hyri ne marreveshje me Josefin II, perandorin e Austrise. Sulltani dergoj

ahere një ushtëri tjeter, në të cilen muar pjesë dhe shumë pashallarë shqiptarë. Kara Mahmuti u-errethua në Shkodër, po u-mbar vesh me Ali Pashë Tepelenën, fshehurazi, e dyke dalë nga fortesa zuri topat e Turqve dhe shpërndau ushtërin' e tyre. Josefi II dërgoj ambasadorë me dhurata, po ambasadorët u-vranë.

5. Dykë dashur që të shtrihej edhé në Toskëri. Kara Mahmuti goditi Beratin, e keshtu u-bë shkak për armiqësi në mes të Gegëvë e Toskëvë. Më 1796 hyri në Mal të Zi ku edhe u-vra. Vendin e tij e zuri Ibrahim Pasha, i cili u-bë veglë e Sulltanit, e pas tij erdhi Mustafa Pasha, i cili mbajti udhën e Kara Mahmutit.

6. Ali Pashë Tepelena nisi punën e tij si kusár ose *klleft*, dyke u-shtyrë prej prinderve të tij, të cilët i dhanë një rritje fort të keqe. Hyri në shërbim të Sulltanit me parë si *Derbenage*, dhe më 1788 u-bë Pashë i Janinës.

7. Qellimi i tij ish që të bënte një principatë të madhe shqiptare, ku të hynte dhe një pjesë e Greqisë. Nisi, pra të faroste bojlerët e vendit e të shtypte Sulliotët me të cilët lëftoj kater herë, dyke u-mundur. Më në funt e zuri Sulin me tradhëti e pabesi. Murgu Samuel bodhi veten n' erë bashkë me ushtarët që ïu-afruan, dhe grat' e Zalongut u-hodhë nga bregu tatëpjetë me femijët e tyre që të mos binin në duart e Alisë.

8. Ali Pasha nisi tanë që të bënte intriga me Shtetet e mëdhenj t' Evropës, e cila gjendej në këtë kohë në trazirë të madhe nga shkaku i mundjevë të Napoleonit të Mathi, me të cilin Aliu bënte marrëveshje, që të dridhte fjalën kur fitonin armiqt' e tij.

9. Ali Pasha desh të bashkonte tërë Shqipërinë, po s' desh të hynte në lëftë me Bushatasit e Shkodrës, e sikur t' ishin marrë vesh në mes të tyre të dy këta pashallarë, Ali Pasha dhe Mustafa Pasha, Shqipëria do t' ish liruar që n' atë kohë. Po për fat të keq, ëpulli s' ish zgjuar edhe.

10. Mëdhështia e Ali Pashës tregohet në riformat dhe n' organizimin e Shqipërisë të cilën ay desh t'a përparonte e t' a bënte si një Shtet Evropian, me anë të nevojës e të qytetërimit. Po puna e tij mbet e pë-

mbaruar se me 1820 Sulltani vendosi qe t'a shtypte Ali Pashen.

11. Dyké u-gjendur ne rrezik te math, Ali Pasha u-mundua qe te ngrinte popullin me iden' e lirise dhe ndezi flagen e kryengritjes ne te gjith' anet. Po me 1822, ushtetia turke e zuri Janinen dhe Ali Pashen me tradheti, dhe me kete menyre mori fut puna e tij.

PYETJE PËR STËRVITJE

1. Si mundohej qeveria turke t' a mbante popullin shqiptar nene urdherin e Sulltanit?—Nga cili varreshin qeveritaret e kreret e ndryshme te Shqiperise?— E perse ashtu?—Me ç' menyre po mundoheshin kryeqeveritaret e Shqiperise qe te çkaputeshin nga Turqia?

2. Cili ish Mehmet Bushatasi?—Ç' ish Bushati?—Ç' fare njeri ish Mehmeti, e ç' deshi te bente?—Persé kerkoute te mposhte bejleret?—Ç' beri qeveria turke kur degjoj veprimin e Mehmet Pashes?— Ç' i ngjan te derguarit te qeverise?—Gjer ku zgjatej qeverimi i Mehmet Pashe Plakut?

3. Cili e zuri vendin e tij?—Ç' fare njeri ish Kara Mahmuti?—Ç' beri?—Ç' eshte Kanuni i Leke Dukagjinit?—Ká vajti Kara Mahmuti me 1770?—Pershkrúani lufterat e tij me Malin e Zi?—Persé u-zu me Venetine dhe ç' beri kjo?—Ç' beri qeveria turke?—Ç' ngaju ne fushen e Kosoves?—Cili ish Josefi II?—Ç' ka te benje Ali Pashe Tepelena me Kara Mahmutin?—Ç' ish Rosafati?—Si shpetoj Kara Mahmuti?—Kush i vrau ambasadoret e Austrise?

4. Perse Kara Mahmuti ndezi armiqesine ne mes te Gegeve e Toskeve?—Si, kur, e ku u-vra Kara Mahmuti?—Cili e zuri vendin e tij e ç' fare lloj njeriu ish ay?—Perse u-zemerua Mirdita me Pashen e Shkodres?—Cili ish Mustafa Pasha dhe ç' politike mbajti?

Ç' rritje pati Ali Tepelena?—Cili ish Veli Beu, Hamkua, dhe Kleftet?— Ç' kish te benje Alliu me Kleftet?—Persé kishin dale méleve ketá njeres?—Ç' fare njeriu ish Ali Pasha?—Ç' deshironte te bente?— C' gje eshte Dervenaga?

6. Kur u-be Pashe i Janines Alliu?—Cili ish pllani i tij?—Si sillej kundrejt bejléreve?—Si qeverisheshin fshatrat e Sulit?—Persé kerkoute t' i mposhte

Ali Pasha?—Sa fushata beri Aliu kunder Sulit?—Si e mori Sulin Ali Pasha?—Cili ish Pilo Gushi, Samueli?—Ç' bene grat' e Zalongut?—Ç' u-bene Suliotet pasi rá Suli?—Ç' pesaan njérzit qe rane ne dore t' Ali Marko Boçari e Foto Xhavella?

7. Qe kú e gjer kú zgjatej qeverimi i Alli Pashes?—Ç' kish te bente Aliu me Shtetet e Evropes?—Cili ish Napoleoni, si hipi e u-be peandór i Francës, ç' beri n' Evrope, dhe ç' kish te bente Aliu me të?—Ç' ngjau ne France me 1789?

8. Ç' pesaan Hormova e Gardhiqi?—Cilat ishin maredheniet e Ali Pashes me Mustafá Pashen e Shkodres?—Persé s' u-muar vesh te dy qe t' a bashkonin e t'a lironin Shqiperine nga Sulltani?—Ç' mejtonte pópulli?—Kur e si e mori Pargen Aliu?

9. Ç' te mira desh t' i bente Shqiperise Ali Pasha?—Si e organizoj vendin e tij?—A e mbaroj keté punë?—Persé jó?—Sj e tregojne Ali Pashen keté riforma?—Cili ish mé i zoti qe t'a shpetonte e t' a perparonte Shqiperine: Ali Pasha apó Bushátsëit e Shkodres, e persé?

10. Cilat janë provat qe Ali Pasha ish nje njeri i kohes se vé?—Ç' rendesí ka mbledhja e Janines?—Si e gjykoni sjelljen e Mustafá Pashes e te Mirdites?—A mundej, qysh mundej, e persé s' mundi Shqiperia te lirohej qe n' até kohe?—Si e kur rá Janina e Ali Pasha ne duart e Turqve?

KËNDIME

KARA MAHMUT PASHA—Pas Ali Pashe Tepelenes, Kará Mahmút Pasha eshte, me te vertét, burri mé i shenuar i Shqiperise ne funt te shékullit te 18te, e gjith' ashtú eshte nje nga fytyrat mé t' interésceshme e te verejshme te historise se re shqiptare.

Pas kujtimeve t' asáj kohe, Kará Marmuti tregohet q' ish nje njeri fisnik e i sjelle, ner te medhénj e te vegjel trim pa shoq dhe i drejte.

Një nga púnerat e tij më të shenúara eshtë jo vetëm se aý çpalli lirin' e fesë në Shkodrë e në përqárk po edhé arrijti që të sillte një bashkim të plotë në mes të Mohamedánëve e të Krishtérëve, e kur i erdhi një herë një rasje që të mpronte até lirí fetare dhe bashkim nuk' e beri punen për gjysmë po i dha funt të prerë.

Një herë një tregetár katholík prej Shkodre kish vajtur për tregeti në Gjakovë ku e kisihn ngarë disá njerës. Dyke u-kthyer në Shkodrë, tregetari in-qa Karâ Mahmút Pashës. Pa humbur kohë, Pasha i Shkodres nxori zerin e kushtrimit —i cili ish tre topa nga kështjella—, mblodhi ushtrin' e tij dhe u-nis për në Gjakovë për të vënë në vent nderin e Shkodranit katholík.

Kur arrijti në Prisrën gjeti që vëndesit po zíheshin në mes të tyre. Karâ Mahmuti qendrój atjé tri dit, e shtroj vendin, í denój fajtorët, griu shkaktarët e ngatresave, dhe, dyke arrijtur në Gjakovë denój atjé pa meshirë fajtorët e keqsjelljes kundréjt Shkodranit tregetár, dyke u dhënë vëndesve një mesim që s' munt t'a harronin për shumë kohë.

Në vendin e veçantë shënuam se Karâ Mahmuti forcój kanunet e zakonet e vendit dyke i dhënë një fuqí të madhe Kanunit të Leke Dukagjinit, dhe kjo provón që Karâ Mahmuti kish ndjenja të kthjellta për vendin e tij. Me këtë mënyrë, Pasha i Shkodres zgjoj në qarkun e tij ndjenjat e dashurisë për kombesí.

Nga ana tjeter, esht' e ditur se sikúr te rronte Karí Mahmuti ne kohen e Mustafá Pashes pa dyshim do t' ish marre vesh me Alí Pashen per te bere Shqiperine me vete qe n' até kohe.

KENGA E SULIOTEVE—Pas rénies se Sulit ne duar te Alí Pashes, Suliotet u-hodhe ne Korfús, siç thame mé siper, dhe atjé hyne ne sherbim te Rusise e cila, dyke qene ne lufte até kohe me Turqine e me Francen, u ish zotuar qe t' i ndihmonte te kthéheshin ne vendet e tyre. Kujtimi i këtyre ngjárjeve pershkruhet bukur ne kenget e poshtme qe kendonin vete Suliotet:

Ti, more Foto Xhavella,
Seç na bere me kapella,
Seç u-prem' e seç u-vrame,
Sul' e shkrete ku e lame?
Alí Páshese ia dhame,
Nat' e dite rrim' e qajme.
Fati ne Korfús na hodhi,
Zame dore te Moskovi.
Me Moskovin lith kuvendin
Te vem' e te marrim vendin,
Vem' e vdesim ne dhé t' ene
Atjé tek e patem thene,
Vdesim me dyfék ne dore
Si dhendure me kurore.

VDEKJA E ALI PASHES—Nje nga ngjarjet mé tragjike te historise shqiptare eshte pa fjale

vdekja e Alí Pashes, se ne këtë ngjarje perpiqet trimcria me tradhetinë.

Armiqt' e tij kishin kohë që po kallëzonin Alí Pashën tek Sulltani, dhe një nga atá armiq ish Ismaíl Pasho beu të cilit Aliu i kish marrë vendin disá kohë mé parë. Për një kohë të gjatë, Alí Pasha mundi që të hithte poshtë ató kallëzime dyke u paguar suma të medhá, si *ryshfét*, keshilltáreve të Sultlanit. Po, mé ne fund, kallëzimet zunë vend dhe Sulltani vendosi t'a çbonte Pashën e Janinës. E para punë e tij ish që e nxori Alí Pashen jo vetëm nga pashallëku i Janinës po edhé nga feja mohamedane, dhe si Pasha të Janinës emerój Ismaíl Pasho beun. Ahere u-nisnë dhe ushtërít' e medhá kundër Aliut.

Lufta mbajti dy vjet të tërë, pa rreshtur, po Turqit e shumë po i merrnin një nga një qytetet dhe po i afróheshin Janínes. Djemt' e Alí Pashes, Muhtari, Veliu dhe Salíu, s' qendruan dot në vendet që u kish dhënë i atí që t' i mpronin, dhe jo vetëm që i lanë vendet po edhe u-dhanë vetë në duart e Turqve.

Kur pa se armiqtë po afróheshin, Alí Pasha u-mbyll në keshtjellën e *Lithavicës*, po edhé në këtë keshtjellë hynë Turqit me tradhetí, dhe Aliu u-mbyll tanì në një nga kullat e keshtjellës me një numur të vogël ushtaresh dhe me *Vasiliqinë*, shoqen e tij besnike. Me nj' anë të kullës kish vënë një numur të math varelash me barút që, fundi i fundit, po të dukej se s' kish shpëtim t' i

vinte zjarr barutit e qe te gjithe te vdisnin me nje here. Tek porta e qilarit ku ish baruti, Ali Pasha kish vene nje nga me besniket e tij, i cili do t' i vinte zjarrin barutit porsa qe t' i jepte urdher Pasha.

Po Turqit lakmonjes nuk' deshin te zinin vetem Ali Pashen po edhe pasurin' e tij te madhe te cilen ay e kish mbledhur dhe e kish vendosur afer varelave te barutit qe kur t' i vihej zjarri te humbiste edhe pasuria. Tere puna e Turqve ish qe te muntnin t'a nxirrnin Ali Pashen nga ajo kulle e keshtu te mos e linin t' i jepte urdher njajtesit qe t' i vinte zjarr barutit. Per t' arrijtur kete qellim, *Hurshid Pasha*, kumandari i ushtrive turke, u-kujtua qe te perdorte nje pabesi te evjerdhur e te tmerruar. Hurshid Pasha i dergoj Aliut njerez me ancn e te cilcve i zotohej qe t'a pajtonte me Sulltanin, dhe per kete qellim kerkonte nje pjekje goja-gojes me Ali Pashen, ne nje vent te liqenit te Janines. Ali Pasha e mbesoj, dhe dolli nga kulla, po porsa in-afrua vendit te caktuar, ushtaret qe kish fshehur Hurshid Pasha u-derdhe nje me nje mi Aline, i cili, dyke kuptuar tradhetine nxori koburen, dhe, sido qe ish 81 vjetsh, shtriu perdhe ushtarin q' i dolli perpara.

Dhe tani nisi lufta ne mes te besnikeve te tij e t' ushtareve Turq, nje lufte trup per trup e gryke per gryke. Po, me ne funt, Ali Pasha u-mposht dyke u-plagosur me nje thike, dhe porosin' e funtme qe la ish ajo q' i dha *Kostandin Boçarit* qe kish marre me vehte: "Nga, e therre Vasili-

qinc, qe te mos bjere ne duart e ketyre njëreseve te ndyre!"

Koka e tij u-pre e u-dergua ne Stamboll qe te shihte Sulltani vete me syt' e tij se mori funt jeta e qeverimi i armikut te tij mé te math. Per shume kohe, koka ndenj e varrur jashte Pallatit per gezim te math te halldûpeve.

Me te rene Aliu, Turqit therre nje nga nje djemte dhe nipret e tij, po kur i erdhi radha Muhtarit, ay u-kundershtua me trimeri te madhe dyke thene qe "nje Shqiptár nuk' vdes dyke u-therrur si kec!", dhe me te thene keto fjale iu afrua kulles se barutit dhe i vuri zjarrin, dyke u-perenduar n' ere ay bashke me te tjeret e me pasurin' e madhe t' Ali Pashes.

Keshtú mori funt jeta e Ali Pashes te degjuar qe kish te bente me njérezit mé te medhénj te kohes se tij. Me tere te keqiat qe punój ne jeten e tij, Shqiptaret e qane me lote te zjarrte pas vdekjes, se bashke me vdekjen e tij u-çduk dhe liria qe kishin enderruar dhe bashkimi ne mes te tyre, se Ali Pasha i kish afruar te Krishteret me Mohamedanet ne nje shkalle qe s' ia merr dot mendja njeriut ne kohen e sotme.

III

RRJEDHJET E POLITIKЄS S' ALI PASHЄS

1.—Gjendja e Turqisє

Qє tє kuptohen mé mirє ngjarjet e Shqiperisє nє kєté kohє, єshtє nevojє qє tє hedhim njє sy e tє shєkojmє se ç' ngjiste nє Turqí, se ashtú do tє vєshtrojmє mé kthjelltє rєndєsín' e rásjeve tє veçanta e fort tє volitshme qє humbi Shqiperia nga shkaku se Gegєria s' i dha dorє ndíhmєse Alí Pashєs.

Nє krye tє shékullit tє 19tє hipi nє fronin e Osmánєve Sulltán *Mahmuti II*, i cili u-quajt *Mahmút Riformatori*. Ky Sulltán rrahu qє tє çkєputte Turqinє nga barbaria e saj, dyke futur nє perandorín' e tij kanunet e sistemin politík t' Evropєs. Pas njє kryengritje tє madhe qє kishin bєrє *Jeniçeret*, qє pєrbєnin ushtєrín' e parrégullshme tє Turqisє, Sulltán Mahmuti i prishi krejt trupat e tyre, dhe nє vєnt tє tyre vєndosi qє tє ngrinte mє kєmbє njє ushtєrí tє régullshme, ashtú siç kish Evropa e tєrє.

Po kєtó kryengritje e trazira tє bréndєshme e kishin tronditur an' e mb' anє perandorinє turke,

dhe gjendja e saj u-rrezikua mé tepër se pópullì i paditur e fanatík turk u-ngrit kundër Sulltanit qe po mundohej t'a bente Dovletin "një mbretëri frenge dhe kaure", keshtú qe Turqia kish arrijtur në buzën e varrit.

Dyke perfituar nga ketó trubullime te Turqisë, kombesít' e húaja qe rronin nenë Turqinë, Shqiptarët, Serbët, Grekët Bullgarët, Rumanët, Malziasit, u-çuan me kembe qe te çkepúteshin nga Sulltani një herë e mirë. E kjo ish koha, siç pame mé siper, qe Pashet e Shkodres e te Janines muntne te fitonin veteqeverimin e tyre. Po dyke qenë se te dy Pashet s' u muar dot vesh me mes te tyre qe te bashkepunonin per te shpetuar Shqiperinë, vendi yne mbeti perseri nenë Sulltanin, kurse Grekët, Serbët e Malziasit e vazhduan luften e tyre dhe arrijtin qe te fitonin veteqeverimin e tyre, sidó qe s' muntne te fitonin lirí te plotte. Sikúr te qé nonjé tjeter njeri ne vent te Mustafá Pashes se Shkodres, s' ka dyshim q' edhé Shqiperia do te kish perfituar nga ketó rasje kaqe te mira e do te kish fituar veteqeverimin e saj. Po Mustafá Pasha u-kujtua qe te ndiqte até qellím kur ish tepër von, siç do te shohim mé poshte.

2.—Kryengritja Greke

Mé siper pame se Alí Pasha u ish zotuar lirí Grékeve po t' ish qe t'a ndihmonin kundër Turqve. Nga ana tjeter, Pasha i Janines s' la menyre

pa perdorur qe t' i ngrinte e t' u jepte kuraje Grékeve, me pará edhé me njeres. Ne Mars, 1821, pra, Greket u-ngritne kunder Sulltanit, si pas shtytjes qe patne nga Alí Pasha,, domethene ne kohen kur ushteria turke i kish duart te zena me fushaten kunder Pashes se Janines.

Pas vdekjes s' Alí Pashes (1822), Shqiptaret qe leftonin ne Toskerí per lirín' e tyre nuk' i hodhe armet me nje here, po e mbajtne kryengritjen te gjalle edhé per ca kohe. Ner kapedanet e kesáj kryengritje mé te degjúarit ishin *Marko Boçari* i Sulióteve, dhe *Zylyftár Poda* i Kolonjes, e qe te dy ketá, dyke bashkepunuar vellazerísht, u-munduan qe te mbanin te ndezur zjarrin e lirise ne Toskerí, dyke patur per shoke edhé kapedanet e tjere te Sulit e disá nga bejleret.

Po kur pane qe s' ia dilnin dot luftes me Turqine, dhe qe pópulli i Toskerise s' u binte pas, kapedanet e Krishtere, *Marko Boçari*, me kusherínjt' e tij, *Lambro Bejkua*, *Xhavellajt*, *Zervat*, e shume te tjere, t' etuar per lirí, u-hodhe nga ana e Greqise, dhe dyke u-bashkuar me Greket e mbajtne kryengritjen te gjalle. Nga ana tjeter, Greket patne ndihmen e paçmuar te detáreve te nisive shqiptare, *Hydra*, *Spetse*, *Kulluri*, per te cilat thame mé pare se si u-ndenjne prej Shqiptaret.

Nga mé te degjúarit e ketyre detáreve ish *Admirál Miauli*, *Kapedanesha Bubuline*, e shume te tjere. Tere ketá njeres leftuan aqe trimerísht sa habitne tere boten, dhe sot dihet prej te gji-

theve qe po te mos ishin ketá Shqiptare, Greqia nuk' do te mundej te fitonte lirin' e saj. Po ç' fitój Shqiperia e mjerë? Gje prej gjeje, veç me ikjen e ketyre kapedáneve te shkelqyer vendi yne ra prape n' errësire e ne roberí dhe qe Greket u-liruan ne kurrís e per dem te Shqiperise.

Dhe fajin mé te math per keté gjeme kaqe te madhe qe pesój Shqiperia, e cila jo vetem qe s' u-lirua po edhé dha njérezit e saj mé te mire per te liruar nje armik te terbuar te saj, Greqine, e ka Mustafá Pasha i Shkoders dhe Kapedani i Mirditës, te cilet, jo vetem q' e lane keté rasje te shkelqyer t' u ikte nga dora po edhé u-vune ne sherbim te Sulltanit per te mbytur kryengritjen greke. Dhe ish e shkruar qe trimi Shqiptár Marko Boçari, qe kish enderuar nje Shqiperí te lire dhe leftój per té, u-vra prej dores se Kapedanit te Mirditës, ne kohen kur Mustafá Pasha dhe Mirditasit kishin arrijtur gjer ne *Karpenis*, Greqí dyke leftuar kryengritesit q' ishin nené kumanden e Marko Boçarit (1823).

3.—Mbarimi i Qeverimit te Bushátasve

Kryengritja greke mbajti qe me 1821 gjer me 1829. Po, sikunder thame mé siper, flaga e kryengritjes qe ndezi Ali Pasha u-perháp ne tere Ballkanin, dyke qene se Aliu iu çoj fjale qe te gjitheve, Grékeve, Bullgáreve, Malziasve, Sérbeve, Rumanëve, qe te ngriheshin e te leftonin per lirin' e tyre kombetare, dhe me disá nga atá beri marreveshje

drejt per drejt. Qe te gjithe ketá popuj u-ngritne me kembe e rrokne armet dyke hyre ne lufte kunder Turkut, passi u-shiguruan qe do t' u ndihmonte edhé Rusia, e eila kish dale ne keté kohe si mprójtese e tyre. Ky zjarr i math q' u-ndes ne Ballkán, an' e mb' ane Shqiperise, ndezi edhé nje here zemrat e Shqiptáreve per liri, passi Alí Pasha e kish mbjelle faren e saj ne te kater anet e vendit tone.

Dhe tani u-kujtua edhé Mustafá Pasha i Shkodres qe te çkeputej nga Sulltani e te bohej ploterisht me vehte, veçán tani q' Ali Pasha ish çdukur dhe Pasha i Shkodres mund te bashkonte tere Shqiperine nenė qeverimin e tij. Popujt e Ballkanit, q' ishin dyke leftuar kunder Turqve, i dergúan njeres per te kerkuar ndihmen e tij, e i zotóheshin qe t'a njihnin si mbret te Shqiperise me kondicen e vetem qe te mos leftonte per Sulltanin po te qendronte me nj' ane.

Ne mes t' atyre qe kerkonin marreveshje me 'té ish edhé *Mehmét Alí Pasha* i Egjyptit, bir i nje Shqiptari nga *Mesarea*, i eili kish mundur te shtinte ne dore Egjyptin ku themelój nje principate te veteqeverisur. Mehmét Aliu ish tani ne lufte me Sulltanin dhe dyke patur nevoje per ndihme iu kethye Pashes se Shkodres, pas vdekjes se Alí Pashes me te cilin kish patur nje miqesí te ngushte.

(Shkó kendimin: MEHMET ALI PASHA I EGJYPTIT, faq. 168.)

Mustafá Pasha u-bint abere qe te rrinte me nj' anc, e t' i linte popujt e tjere te Ballkanit qe te liróheshin. Po e ndénjura me nj' anc i kushtój shtrenjt, se ne nje rasje t' atille s' duhej te rrinte me nj' anc po duhej te kish dalc hapur e te leftonte.

Me 1827, Rusia i çpalli lufte Turqise qe te lironte popujt e Ballkanit. Mustafá Pasha s' leftój as per veten e tij as per Sulltanin, dhe kur u-be pasja me 1829, me ancn e te eilcs Greqia fitój lirin' e saj, Pasha i Shkodres mbet tani i vetem balle per balle me ushterin' e Sulltanit t' egersuar kunder tij. Nje ushteri e madhe nené *Reshid Pashen* u-nis qe te shtronte tere Shqipérine.

Po ne keté kohe, me 1831, nje kryengritje e re kish plasur ne Toskeri. *Zylyftar Poda* i Kolonjes e kish bashkuar pópullin, te Krishtere e Mohamedane, dhe nisi nje lufte te rrepte kundra Turqve per te fituar lirin' e Shqiperise. Qeveria turke dergój kunder tij nje ushteri te régullshme. Perpjekjet e para u-bene ne kullat e Qarit, afer Korçes, dhe dyke u-thyer q' andéj Zylyftar Poda u-mbyll ne fortesat e *Melesinit*, maje nje mali te forte. Atjé u-rrethua per tete muaj e qendrój me trimeri te çquar, dyke pritur ndihme nga Mustafá Pasha i Shkodres. Po kur pa qe s' vinte nonjé ndimme, u-dha mé ne funt ne duart e Turqve te eilet e shpune ne Stamboll ku edhé e vrane. Shoket e tjere te tij shpetuan e muarrne malet ku e mbajtne kryengritjen te gjalle disá kohe.

Me te marre funt kjo kryengritje, Reshid Pa-

sha hoqi drejt kundra Mustafá Pashes, i cili mblodhi keté radhe një ushteri të madhe dhe dolli në gryken e *Babunes*, afer *Monastirit*, që të priste hovin e ushterisë turke. Atjé u-perpoqnë të dy ushterite; Mustafá Pasha u-mund prej Turqve e ra rop në duart të tyre (1832).

Q' andéj, Reshíd Pasha hoqi brenda në tokat e Shqiperisë të cilat i shtroj njeren pas tjetres. Mirdita iu kundershtua disá kohë rreptesisht, po edhé ajó u-mposht mé në fund, dhe Reshíd Pasha hyri me triúmf në Shkodrë.

Veteqeverimi i Shqiperisë mori fund, me keté menyre, pasi Shqipería e tere u-nbyt në gjak fare më kot.

4.—Qeveritarë Turq në Shqipëri

Për të mos lene me nonjé shtek per kryengritje, Reshíd Pasha iu-vu punes për të çdukur të gjithë gjyrmat që kish lene qeverimi i Bushatasve dhe i Ali Pashes. Një nga një, të gjithë vendet e forte, keshtjellat, fortesat, kullat u-sheshuan rrafshë me dhenë. Nga ana tjeter, qeveria turke s' mund të kish mé besím ner Shqiptarët, siç kish bere mé parë, dhe tani e tutje dergonte në Shqipëri qeveritarë anadollakë.

Shumë here pópulli e çfaqte zemerimin e tij kunder Turqisë dyke iu-kundershtuar qeveritáreve, dhe një numur i math kryengritjesh vendiake ngjanë nga ky shkak. Po ketú qeveria turke

perdori nje dinakerí te holle. Kurdohere qe dilnin kundershtime kunder qeveritáreve, Sulltani ua hithte fajin ketyre, i hiqte nga vendi e dergonte te tjere, keshtú qe Shqiptaret nisne te nderonin Sulltanin i cili perpiqej, ne syt' e tyre, per t' i bere mire vendit dyke hequr me nje here zyrtaret e papelqyer.

Veç ketyre másave, qeveria turke mori tani dhe disá te tjera. Dyke pare se ne kryengritjet e shkúara Shqiptaret ishin te bashkuar, pa ndryshim feje, Sulltani futi tani nje propagande fetare per te perçare Mohamedanet nga te Krishteret, dyke u thene Mohamedáneve qe s' u kishte hie te bashkóheshin me te Krishteret. Keté propagande e hente mé teper, dyke derguar hoxhallare anadollake osé dyke perdorur fanatiket vendes. Me keté menyre, u-shojt jo vetem bashkimi i bukur qe mbreteronte mé pare ne mes te Shqiptáreve po edhé shija e etja per liri kombetare, dhe shumica ra e iu-be besnike e Sulltanit.

Kohe me kohe dikú ngjisnin disá trubullime, po levizjet béheshin vetem ne nje krahine dhe s' kishin nonjé rendesi. Nga ana e Gegerise trazimet béheshin mé teper nga shkaku i qeveritáreve anadollake, dhe, siç thame mé siper, qeveria turke i ndronte me nje here atá zyrtare dhe pópulli mbetej i kenaqur.

Po nga ana e Toskerise s' ishin shojtur krejt iskrat e zjarit te lufterave te shkúara per lirí, dhe nga ana tjeter, fqinjesia e Greqise se liruar ia

kujtonte gjithenjé pópullit lirinc qe kish patur mé parc e te cilen e humbi mé von. Keshtú, pra, kohc me kohc dilte nonjé kapedán, si *Çelo Picari*, *Gjon Leka*, *Krapo Hekali*, dhe e ndiste pópullin kunder Turqve. Dy tri herc u-ngritnc me kembc disá krahina te Toskerisc me shtytjen e Grekcve, po me qe ishin vetem levizje vetiake, dhe, nga ana tjeter, Greket e pabesc e te dobet s' u jepnin nonjé ndihmc kryengritesve, Turqit e shtronin vendin pa mundime te medhá.

(Shkó kendimin: SI SHPETOJ ÇELO PICARI, faq. 170.)

É vetema levizje qe vlen te shenohet eshte ajó e vitit 1835. Levizja nisi ne Skodre ku anetaret e Mustafá Pashes ngritnc Malcsoret dhe rrethuan Pashen mnadollák te Shkodres. Q' andéj u-perháp levizja ne Toskeri, ku *Çelo Picari*, njc trim i forte dhe i vjetcr i Ali Pashes, ngriti pópullin kunder Turqve, dhe nje beteje e gjákeshme u-bc ne *fushen e Dedvines*. Po keté levizje Turqit e mbytnc me lehtesi. Kryekumandari Turk, Hurshíl Pasha, ftoj per dreke nja tre qint njerc, nga te parct e kryengritjes, dyke u thenc qe i kish falur Sulltani, e kur po hanin buke rane permi 'tá ushtaret turq dhe i therre qe te gjithc, siç thote fjala, me buke ne goje.

Q' ahere, pra, e gjer ne vitin 1878, Shqiperia u-shtrua plotcrisht nenć Sulltanin. Shqiptaret, te lodhur nga kryengritjet e te keputur nga gjaku i shumc q' u-derth, unjnc koken nenć qeverinc turke.

PERMBLEDHJE

(Te mesohet me goje)

1. Sultani Mahmut II Riformatori desh t' a qyteteronte Turqine, po iu-kundershtua populli, dhe, ne mes te trazirave qe ngjane, popujt e Ballkanit u-ngritne kunder Turqise per te fituar lirin' e tyre. Po Shqiptaret e humpne ate rasje te mire.

2. Ali Pasha ndezi kryengritjen greke, dhe pas vdekjes se tij kapedanet e Krishtere u-hodhe nga ana e Greqise dhe leftuan per lirin' e saj. Greqia nuk do te mundej te lirohej pa ndihmen e Shqiptareve, ne mes te cileve me te degjúarit ishin Boçarenjte, Xhavellat, Miauli dhe Bubulina. Mustafá Pasha i Shkodres vajti te mbytte kryengritjen greke me urdher te Sulltanit, ne vent qe te leftonte per lirin' e Shqiperise.

3. Flaga e kryengritjes u-perhap ne tere Ballkanin, dhe popujt e ndryshme, te cilet kishin edhe ndihmen e Rusise, kerkuan marreveshje me Mustafa Pashen, po ay ndenji me nj' ane, dhe kur u-mbarua lufta rusoturke me 1829, Pasha i Shkodres mbet i vetem balle per balle me Sulltanin e egersuar. Reshid Pasha u-nis kunder Shkodres, po u-ndalua gjersa u-shojt kryengritja e Zylyftar Podes. Me 1832, Reshid Pasha mundi Mustafa Pashen ne Babune dhe hyri ne Shkodre dyke i dhene funt qeverimit te Bushatasve.

4. Reshid Pasha e shtroj vendin krejt, dyke sheshuar keshtjellat dhe fortesat e Shqiperise, dhe me qe Sulltani s' munt t'u vinte mé bese qeveritáreve Shqiptare, ne vent te tyre çoj qeveritare anadollake. Nga ana tjeter, me propaganda fetare e perçau populin shqiptar.

5. Ketu e atje beheshin disa levizje ketej e tutje, po levizjet ishin vendiake dhe Turqit i mposhtnin pa mundime te medha. Me e shenuara levizje ish ajo e vitit 1835 kur Burshid Pasha therri me te pabese kryetare, ne vent te tyre çoj qeveritare anadallake. Nga ana mbet e bindur tek Sulltani.

PYETJE PER STERVITJE

1. Ç' kerkonte te bente Mahmuti II?—Perse u-quajt Riformator?—Ç' ishin Jeniçeret?— Ç' ndalime

gjeti Mahmuti II?—Ç' shkaketuan keto trubullime te Turqisc?—Ç' bene popujt e Ballkanit?

2. Kush e ndezi kryengritjen greke?— Ç' ka te benje Ali Pasha me ate kryengritje?—Cili e mbajti kryengritjen te gjalle ne Toskeri?—Ç' bene kapedanet e Sulit pas renies s' Ali Pashes?—Si u-lirua Greqia?—Ç' fitoj Shqiperia nga kryengritja greke?—Perse?—Ç' beri Mustafa Pasha e Kapedani i Mirdites dhe ç' duhej te bente?—Ç' ngjau ne Karpenis me 1823?

3. Ç' kish te benje Ali Pasha me popujt e tjere te Ballkanit?—Kush i ndihmonte keta popuj?—Ç' desh te bente Mustafa Pasha?—Cili ish Mehmet Ali Pasha e nga ish?—Ç' i ngjau Pashes se Shkodres?—Cili ish Reshid Pasha e ku u-nis te vinte?—Perse u-ndalua?—Cili ish Zylyftar Poda e ç' beri?—Ç' ngjau ne Bahtne e ne ç' vit?— Ç' rendesi ka kjo beteje?

4. Si e shtroj Shqiperine Reshid Pasha?—Si nisi t'a qeveriste Shqiperine Sulltani?—Ç' benin Shqipetaret kunder qeveritareve turq?—Si mundohej t' a zbute popullin qeveria turke?—Si u-mundua t' a porçante?—Ngjasnin kryengritje tani ne Shqiperi?—Ç' ngjau me 1835?

KËNDIME

MEHMET ALI PASHA I EGJYPTIT—Mehmét Ali Pasha eshte edhé nje tjeter njeri i math qe nxori Shqiperia ne keté periudc kaqe pjellore per njeres te medhénj e per ngjarje te shenúara.

Mehmét Aliu leu ne *Kavalle* te Maqedonise, dhe ish bir i nje Shqiptari nga *Mesarea* e Leskovikut. Me zotesin' e tij vuri ne dore tere Egjyptin te cilin e qeveriste vetem per faqe te botes n' emer te Sulltanit, se aý ish vete Sulltán n' até vent, dhe kish arrijtur nje fuqi aqe te madhe sa Sulltani, dyke mos mundur vete qe te mbytte kryengritjen greke, i lutej Mehmét Aliut qe t'a merrte

keté pune persiper, dhe si per shperblím do t' i jepte nisin' e *Kretes*. Mehmét Aliu dergój ahere te birin, trimin *Ibrahím Pashe*, i cili, me trupat e tij egjyptiane-shqiptare po t' organizúara pas sistemit evropián, u vuri dore Grékeve dhe me 1827 kryengritja greke po-thua se ish shojtur krejt. Po n' até kohe, hyne ne mes Franca, Inglia dhe Rusia, te cilat doqne flloten e Ibrahimit ne *Navarino* te Greqise, dhe Ibrahimi u-shtrengua qe t'a pushonte luften.

Po Mehmét Aliu s' qendrój vetem gjer ne keté pike. Me 1839 u-zu me Sulltanin e Stambollit dhe ushteria e tij, nené kumanden e Ibrahimit, shkeli Anadollin e iu-afrua edhé Stambollit vete. Reshid Pasha qe pame mé siper te dergohej per te shtruar Shqiperine u-hoq me vrap prej Sulltanit q' andéj e u-emerua kryekumandár i ushterise turke kundra Ibrahim Pashes s' Egjyptit, po u-munt e ra rop ne duart e tij. Tere Evropa kish mbetur tani me goje hapur dyke pritur rénien e Stambollit ne duart e Mehmét Alí Pashes. Dhe me te vertét, Stambolli do te binte pa dyshím ne duart e keti Shqiptari te çuditshem po te mos ish qe tri Fuqira te Medhá t' Evropes, Rusia, Franca, Inglia, báshkoheshin e benin nje lidhje per te mprojtur Turqine nga Mehmét Aliu, e keshtú Stambolli dhe Turqia e tere shpetój. Ne konditat e aliances ish vendosur qe ketéj e tutje Egjypti do te qeverisej prej shtepise se Mehmét Alí

Pashes. Edhé sot e kesáj dite sterniprit e tij qeverisin Egjyptin.

SI SHPETOJ ÇELO PICARI—Chelo Picari ish nga besniket e Ali Pashes. Pas vdekjes s' Aliut, Turqit zune te gjithe kreret e Shqiperise qe kishin qene te lidhur me Pashen e Janines dhe i shpune ne Stambóll ku u-mbloth nje Keshille e Madhe qe t' u kendonte *ilamin*, siç thuhet fjala, se gjyq s' kish per 'tá. Po per faqe te botes, u bíheshin disá pyetje te denúarve, dhe porsá dilte perpara Keshilles cilidó nga atá, gjykátcsit e rreme i benin keté pyetje:

"Ty te ka falur Sulltani me te math te tij! Sa njeres ke patur osé munt te besh me vete?"

Njeriu i zene pergjigje i gezuar, si pas númurit te shókeve qe munt te kish osé te bente me vete. Njeri thosh: "Nje qint!", dhe Turqit i pergjigjeshin dyke i thene: "Ahere do te jesh i pari permí nje qint!" dhe nga ana tjeter e nxirnin jashte dhe ia prisnin kryet. Tjetrit qe thosh se kish osé munt te bente nje mije, i thoshin qe do te bchej i pari permí nje mije, dhe nga ana tjeter e nxirnin jashte, gjith' ashtú dhe ia prisnin koken, e keshtú me radhe.

Kur e pyetne Çelo Picarin, qe kish qene nga kapedanet mé te mire te Ali Pashes, Labi i zgjuar u-pergjégj:

"Une, zoterinj, kam vetem dy djem te mij, po edhé atá s' m' a vene veshin fare, dhe s' dua te jem i pari as permí nje qint as permí nje mije,

veq se te me lini te rronj i qete ne nje çip te ketij dheu q' eshte nenë hijen e jetegjatit tone Sulltán!"

Kjo pergjigje u pelqeu teper Turqve dhe jo vetem q' e lane te lire Çelon po edhé e porositne qe te vinte ne Shqiperi e t'a shtroute vendin nenë Sulltanin. Po Çelua, me t' u-kthyer ne vendin e tij, u-bashkua me nje here me kryengrîtesit.

KENGA E GJON LEKES—Per kujtim te trimerise e sherbimeve te Gjon Lekes, populli i Laberise i kendón kengen e poshtme trimit te çquar:

Malet tona po renkojne,
Kurvoleshet po leftojne,
Me pashane ç' u-perpoqne.
Dil' e shifi Korçallite,
Te kam' zene gure-zine.
O Pashá, o t' ungjatt' jeta,
Pse leshtú te dridhet ujekra?
S' ka par' plumba nga Gjon Leka!

Gjon Lek' o mandilezin,
Kater qint pas vetetin,
Kur leftón si shishanllin,
Gjon Lek' o, te kegen o,
Hipi baloshit dhe shko,
N' ató male me qendró,
Pashallaret m' i shkarró
Dhe nizamet m' i leshó.

KËNGA E RRAPO HEKALIT—Gjith' ashtú, pópulli kendón kengen e poshtme për kujtim të trimërive të Rrapo Hekalit:

Hajde, mor Rrapo Hekali,
Kur therrét sa tundet mali!
Hajde, mor Rrapo e lule,
Lumthi ti bilbil që zure
Një Pashá me shtate tuje.
Topi "bam" e ti po tutje,
Plumbat të binin ni supe,
As u-trembe, as u-tute.
Kofshen derrit ia dermój,
Ngrehu flámurin të kroj.

—Pse lëftón, o derëzi?
—As për mua as për ti
Po për gjithë Shqipëri.
O im-zot, o kordhë-shpata,
U-degjove në rigata.

SHËNIME—*Korçallíte*, janë Korçarët; *mandíle*, cshtë shumia e zezë që mbanin ni kokë kryengritësit; *balósh*, kalë balúsh; *vetëtíu*, vetiu; *tutje*, janë bishtrínjt' e kúajve që mbanin si për nder pashallarët; *rigata*, domethënë mbretërira.

PIESA E PESTË
(1878-1912)

I
FILLIMI I ZGJIMIT KOMBËTAR

1.–Traximet e 1875ës dhe Kongresi i Berlinit

Sikunder thamë më siper, Shqiptaret ndenjnë, pak a shumë të qetë, që kursë e shtroj Shqipërinë Reshid Pasha e gjer në vitin 1875.

Po në këtë vit nisnë disá traxira të medhá, jo në Shqipëri po në tërë Ballkanin, të cilat e ndryshuan shumë fatin e Shqipërisë. Serbet, Malziasit dhe Bullgaret u-ngritnë në këtë kohë kundër Turqisë, dyke kërkuar lirín' e tyre kombetare të plotë, dhe Ballkani i tërë u-mbyt në flagë, përvëç Shqipërisë, e cila, për fat të keq, e humbi edhé këtë rasje që të fitonte lirín' e saj së bashku me kombet e tjerë fqinj, se në vjetet që shkuan qeveria turke e kish vënë në gjumë tërë pópullin.

Truballimet, traxirat, e kryengritjet e pópujve të tjerë vazhduan gjer më 1877, dhe menyrat barbarë e mizore që përdori Turqia për të mbytur

ketó kryengritje e bene Evropen qe te ngrihej me kembe kunder barbarise turke. Mé ne funt, Rusia, per te cilen thame qe kish dale mprojtese e pópujve te krishtere te Ballkanit, i çpalli lufte Turqise me 1877 qe te lironte nga Turqia popujt qe kishin ngritur krye. Me keté rasje, u-ftuan edhé Shqiptaret qe te ngriheshin e te fitonin lirin' e tyre, po atá jo vetem qe s' lojtne nga vendi po edhé i ndihmuan Turqise.

Ne nje sere betejash te medhá, ushteria ruse i dermój Turqit, dhe arrijti gjer ne *Shen-Stefán*, pak ore jashte Stambollit. Turqia e mundur krejt pranój te gjitha konditat e paqes q' i vuri Rusia. Dy nga ketó kondita ishin qe Sulltani te hiqte dore nga Mali i Zi e Serbia, te cilat béheshin mbreterí te lira, dhe Bullgaria, Maqedonia e Thraka te bashkóheshin e te benin nje mbreterí te madhe bullgare. Siç shekoni, Shqiperia, ndonesé keputej nga Turqia, do te mbetej perserí nené Sulltanin.

Po kjo paqe s' u pelqeu qeverive te tjera t' Evropes, te cilat dinin qe qellimi i Rusise s' ish qe te lironte popujt e Ballkanit po vetem t' i çkeputte nga Turqia e t' i bente pastáj veglat e saj, dhe u-vendós qe perfaqesónjesit e gjashte Fuqive te Medhá, te cilat ishin Inglia, Franca, Rusia, Gjermania, Austria dhe Italia, te mblidheshin ne kryeqytetin e Gjermanise, *Berlín*, e atjé te perbenin nje mbledhje q' u-quajt *Kongresi i Berlinit*.

Puna e ketij Kongresi ish qe te rregullonte punerat e Ballkanit.

Kongersi u-mbloth ne Qershór, 1878, dhe pas shume bisedimesh vendosi keto: *Mal i Zi* te behej nje principate e lire; Serbia te njihej si mbretori e lire ploterisht, dhe *Bullgaria* te behej nje principate e lire, po me kufire mé te ngushta se ato qe desh Rusia. Ne keté Kongres u-bisedua per te paren here edhé *çeshtja shqiptare*, pas nje memorande q' i ish derguar Kongresit prej nje Komiteti Shqiptar, i cili kerkonte qe t' i jipej *liri* edhé Shqiperise. Po me qe Shqiptaret s' leftuan asfare keté here, kerkimi i tyre s' u-mnar ne sy.

Perkúndrazi, Kongresi u-kujtua qe te zgjeronte tokat e Malit te Zi, te Serbise e te Greqise, dyké u dhene toka te Shqiperise. Mal i Zi do te merte, pas vendimit te Kongresit, *Gusinjen* e *Plaven*, dhe *Triepshin*; Serbia do te merrte *Kurshumline* dhe *Vranjen*; *Greqise* iu-njoft e drejta qe te merrte pjesen mé te madhe te Toskerise.

2. Formimi i Liges se Prisrenit

Vetem kur degjuan se Kongresi i Berlinit kish vendosur qe te zgjeroute kufiret e Sllaveve e te Grekeve me toka shqiptare, Shqiptaret u-zgjuan nga gjumi i thelle qe po flinin dhe i rane mendjes pas qe te mpronin te drejtat e tyre.

Per te gjetur menyrat mé te shigurta te mprojtjes se ketyre te drejtave si dhe per te bashkuar pó-

pullin nε mprojtjen e atdheut, u-bε nε Prisren nε verε tε 1878εs njε mbledhje e madhe, nε tε cilen kishin marε pjesε perfaqesonjes nga çdo krahinε e Shqiperisε. Nε kεtε mbledhje tε madhe u-lith *besa shqiptare* per mprojtjen e tókave tε Shqiperisε qε *Kongresi i Berlinit* u kish njojtur Sllaveve e Grekeve, e keshtú u-formaua *Liga e Prisrenit*, kryetarεt e sε cilεs ishin, *Bibdoda*, Kapedan' i Mirdites, dhe Hodo Pasha Bushátasi. Liga kish tri qendra: *Prisren, Elbasan dhe Gjinokastre.*

Formimi i kesáj ligε ka njε rendesi teper tε madhe per kombesinε shqiptare, se formimi i saj tregón qε pópulli e ndjeu nevojen qε tε lidhej e tε bashkohej per tε mprojtur tε drejtat e Shqiperisε. Nga ana tjeter, kjo ish e para herε qε perfaqesónjesit e *pópullit* pergjitherisht, dhe jo vetem disá krerε, mblídheshin per tε miren e vendit. Veç asáj, kjo lidhje e besεs shqiptare εshtε nisja e *levizjes sε kthjellte kombetare.*

Munt tε pyesε nonjε persé qeveria turke i la Shqiptaret tε mblídheshin e tε benin njε gjε tε ketille? Pergjigja εshtε e lehtε: se edhé qeverisε turke i vinte mirε qε tε leftonin Shqiptaret ketć herε e tε mos linin tε çkepúteshin nga Turqia vende qε ishin nenć Sulltanin.

E para punε qε beri Liga Shqiptare ish njε lajmerim qε u dha qeverive t' Evropes qε Shqiptaret s'i pelqenin vendimet e Kongresit tε Berlinit qε perkisnin leshimin e tókave shqiptare nε duart e Sllaveve e tε Grékeve. Po Evropa beri veshin e

shurdher, dhe nε múajin e Dhjetorit, 1879, Mal i Zi dergoj ushterí qε tε zinte vendet q' i kish njojtur Kongresi. Po ushteria qε kish mbledhur dhe gatitur ndérkohε Liga u dolli perpara Malziasve dhe s' i lá qε tε benin kembε. Mal i Zi u-qa ahere tek Evropa dhe kjo e porositi Turqinε qε tε dergonte ushterí turke per tε shtrenguar Shqiptaret t' i leshonin vendin Malit tε Zi. Qeveria turke dergoj *Mukhtár Pashen* me ushterí, dhe trupat e bashkúara turke e malzías goditnε perserí ushterinε shqiptare tε Liges, e perserí nukε benε dot gjε.

Dyké u-gjetur ballε per ballε me keté kundreshtím tε papritur e tε patundur tε Shqiptárεve, Evropa e madhe, qε s' desh tε merrte nε sy kerkimet e tyre, u-shtrenguα tani qε t' a ndryshonte vendimin e parε. Nε vent tε Gusinjes, Plaves dhe Triepshit, Mal i Zi do tε merrte tani njε ryp t' anedetit bashkε me limanin e Ulqinit. Po edhé keté vendím tε rí e luftuαn Shqiptaret. Tε mbyllur brenda n' Ulqin iu-kundreshtuαn jo vetem Malziasve po edhé Turqve qε kishin erdhur per ndihmε. Ahere, Fuqit' e Medhá t' Evropes patnε paturpesinε qε tε dergonin luftaniet e tyre tε bombardonin até grusht Shqiptaresh trima qε mpronte Ulqinin. Pas njε bombardimi tε rrepte, kundreshtimi i Shqiptárεve u-thye, dhe brenda nε Ulqin byri ushteria turke e cila ia dorezoj qytetin Malit tε Zi (1880).

Númuri i math i armiqve i mundi Shqiptaret, po atá keté here patnε rasjen qε tε leftonin kunder Evropes sε tere.

Nga ana e Serbisë s' u-bë gjë, nga shkaku se Serbia zuri Vranjen dhe Kurshumlinë përpara se të formohej Liga e Prizrenit. Po nga ana e Toskërisë, Shqiptarët s' e lanë Greqinë që të merrte gjë tjatër veç se Artën, e cila, më në fund, s' ish thjesht shqipëtare.

Këtó ngjarje, këtó luftëra më fqinjët dhe më Evropën, e ndezë, natyrísht, pópullin shqiptar e i dhanë të kuptonjë që jeta e tij ish në rrezik, po të mos zgjohej e të mpronte vetë të drejtat e tij dhe jo të mbështetej në fuqin' e Turqisë së krimbur, të cilen e kish marrë që një herë nëpër kambë Evropa.

Dhe ahere u-përsërít e u-ngjall dëshira për lirí, e cila s' u-shojt më, po nisi të shtohej dita më ditën, më gjithë masat e rrepta që mërrí qeveria turke për të mbytur até ndjenjë të kombësisë.

Porsa u-mbarua lufta e kufirëve, qeveria turke vendosi që të çlukte Ligen Shqiptare, e cila ish përhapur dhe kish bërë anëtarë në tërë Shqipërinë. Po jo vetëm atë, se Liga kish shtënë në dorë edhé pjesën më të madhe të Shqipërisë së sipërmë të cilën e qeveriste me zyrtarë shqiptarë. Nga ana tjetër, kryetarët e Ligës kishin nisur taní e po benin pllanë për të fituar lirin' e Shqipërisë, në mos lirí të plotë po të paktën *autonomí*, që dó të thotë vetëqeverim nënë Sulltanin. Më këtë mënyrë, u-ndës përsërí zjarrí i kryengritjes. Turqia morí një frikë të madhe kur pá se sí u-ndryshuan punërat në Shqipërí, e më një herë dërgoj *Dervish Pashën* më një ushtërí të madhe që të shúante zjarrin. Më tra-

dheti, Turqit shtine ne duar te tyre Bibdoden e Hodo Pashen dhe i arratisne n' Anadoll. Kryetaret e tjere ca i vrane me te pabese, ca i burgosne e ca i derguan n' arrati. Me gjith' até, forcat e Liges iukundreshtuan nje vit te tere Dervish Pashes, dhe, vetem pas perpjekjesh te shuma e te gjákeshme, vendi u-shtrua nené Turqine. Po ky shtrím ish i ndryshme nga atá te paret.

3. Perhapja e Mesimit

Formimi dhe lufterat e Liges kishin ndezur ne zemrat e Shqiptareve nje zjarr qe s' shuhej dot mé: *dashurine per atdhe e per kombesi.* Taní zuri te kuptohej, mé mire se mé pare, qe pópulli duhej te bashkohej "me nje deshir' e nje qellim" per shpetimin e Shqiperise, jo vetem nga Turqia po edhé nga lakmimi i fqinjeve. Taní dúall burra me ment qe shekonin se Turqia e kalbur s' munt te rronte shume kohe e qe Shqiptaret duhej te perpíqeshin per veten e tyre.

Dhe nje shtyrje e madhe per te perhapur ndjenjat kombetare ner pópullin u-be ne keté kohe me anen e *mesimit.* Gjer ahere, jo vetem qe shkolla shqiptare nuk kish patur po as qe ish perdorur gjuha shqipe ne shkrím e ne kendím. Ne vent te shkóllave shqipe gjendeshin shkolla turke ne te eilat Shqiptaret mesóheshin Turq, dhe shkolla greke ku mesóheshin qe duhej te béheshin Greke.

Shekó kendimin: SHKRIMI I GJUHES SHQIPE; faqe 183.

Me 1879, pra, dolli nё drite "Abetarja" e parё shqipe, e cila urdhtyp nё Stambol me perkujdesjen e patriótёve tё shenuar shqiptarё, *Pashko Vasa Shkodrani* (Vasa Pasha), *Sami bej Frasheri*, dhe *Jovan Vreto*. Gjithё n' até kohё, u-themelua nё Stamboll njё shoqёri pёr tё botuar libra shqip, dhe mё 1884 u-hap shkolla e parё shqipe nё Korçё.

Nga ana tjetёr, gjithё nё ketё kohё nisnё tё botóheshin gazeta shqipe, me anёn e tё cilave perhápeshin ndjenjat kombёtare nё pópullin.

Po ky zgjim i pópullit shqiptar gjeti dy armiq tё medhenj: Sulltanin Turk dhe Patrikun Grek. Qё tё dy ketú e shekonin me frikё perparimin e diturisё nёr Shqiptarёt, se me anёn e mёsimit do tё zgjohej pópulli e do tё mos bёhej mé vegl' e tyre, se me anёn e mёsimit Shqiptarёt Myslimanё do tё kuptonin qё s' ishin Turq, siç i desh Sulltani qё t' ishin, dhe Shqiptarёt e Krishterё do tё shekonin dhelpёrin' e Patrikut Grek, i cili u thosh q' ishin Greke. Keshtú, pra, nukё shkoj shumё kohё, qё kursé nisi perhapja e diturisё nё gjuhёn shqipe, dhe Sulltani dha urdhёr qё tё mbýlleshin shkollat shqipe e tё digjeshin librat. Nga ana e tij, Patriku nxori njё *mallkim* me tё cilin denonte gjith' atá qё mёrreshin me gjuhёn "e mallkuar" shqipe.

Dyké mos mbetur tjetёr udhё, Shqiptarёt e mёsuar qё perpiqeshin tё perhapnin diturinё me anёn e gjuhes shqipe u-shtrenguan t' ikin nga Shqipёria e nga Turqia e tё vinin nё Rumani, nё Egjypt, nё Bullgari e n' Amerikё ku gjetnё lirí tё plotё qё

të punonin për kombesí. Tere dituria e sotme shqipe u detyrohet këtyre punëtóreve të palodhur të çeshtjes kombëtare që shkuan jeten e tyre në mergím për të ndrituar pópullin shqiptar me anë të diturisë.

E tere këtó ngjarje kaqe të shënúara për istorin' e Shqiperisë u-bënë në kohen që mbretëronte Sulltan *Abdul Hamiti II*, një nga mbretrit mé të keqinj që ka patur Turqia. Abdul Hamiti i ndoqi patriotët Shqiptarë sa asnjé tjetër mbret dhe rrahu, nga ana tjetër, që t' a përmbyste tere punën e tyre dykë futur fanatizmen në zemrat e pópullit të paditur. Po me gjithë ndjekjet e tij të terbúara, levizja shqiptare u-mbajt e gjallë e po madhohej dita me ditën gjer në ditët tona.

Me të vertet, udha mé e shigurtë për të fituar lirin' e Shqiperisë ish që të hapte pópulli syte me anë të diturisë e të kerkonte vetë atë lirí, me të mirë osé me gjak.

Me këtë mënyrë nisi puna e shenjtë e rilindjes së kombit Shqiptar.

PËRMBLEDHJE

(Të mësohet me gojë)

1. Më 1875, Ballkani u-ndez përsëri dhe Rusia i çpalli luftë Turqisë dy vjet mé von për të lëruar popujt e Krishterë. Turqia u-mund krejt dhe pranoj paqen e Shën-Stefanit. Po Shqiptarët s' lojtën nga vendi.

2. Fuqit' e Medhá s' e pelqejne paqen ruso-turke dhe Kongresi i Berlinit u-mbloth me 1878 qe t' a ndreqte punen. Kongresi njojti lirin' e Serbise, Malit te Zi e Bullgarise, dhe vendosi qe t' u jepte toka shqiptare Serbeve, Malziasve e Grékeve. Edhé Shqipperia kerkoj qe te njiheshin te drejtat e saj, po me qe s' léftoj u-muar neper kombe.

3. Per te ndaluar leshimin e tókave shqiptare ne duart e Sllaveve dhe Grékeve u-formua Liga e Prisrenit, e para organizate e kóherave te rea. Trupat q' organizoj Liga iu-kundershtuan me armc vendimit te Kongresit, e bene Evropen qe te ndryshonte vendimin e te dergonte luftaniet e saj qe te vinte ne veprim vendimin e ri. Me ketć menyre, Mal i Zi nuk Ulqinin, po Greqia s' fitoj nonjé gjc te madhe.

4. Veperimet e Liges ngjalle ndjenjen e kombesise ne popullin shqiptar dhe kur desh qe t' a prishte Turqia Ligen, Shqiptarct iu-kundershtuan me armc e deshmin qe te ekspúteshin nga Turqia. Dervish Pasha u-dergua te mbytte kryengritjen, te cilen Turqit e shuan dyké zenc me pabesi kryetarct shqiptarc.

5. Po formimi i Leges pati edhé nje rrjedhje tjeter te shenuar: u-be shkak qe Shqiptarct te zgjóheshin e te shtíheshin pas mesimit. Gjuha shqipe nisi te perdorej ne libra, gazeta, dhe shkolla. Pak mé von, Sulltan Hamiti desh t' a shúante kete levizje kombetare, se bashku me Patrikun grek, dhe shkollat u-mbylle.

6. Po punetorct e qeshtjes kombetare u-hodhe ne vendet e huaj te lire e atjé vazhduan punen e ndritimit te popullit Shqiptar me anen e mesimit. Qe ne ketć kohe nisi udha e mbare e perparimit te kombit tone, i cili pak nga pak po zgjohej, dhe me kete menyre u-ngjall deshira e kthjellte per liri.

PYETJE PER STERVITJE

1. Ç' ngjau me 1875 dhe ç' rendesi kane ató ngjarje per Shqiperine? Cilat ishin shkaket e ketyre trazimeve?— Cili ish prapa tyre?—Persé Rusia i cpalli luftc Turqise?—A duhej Shqiptarct t' ishin ngritur ne kete kohe?—Si u-mbarua lufta ruso-turke?—Kú u-be

paqa e cilat ishin konditat e saj?—U-vendos gjc per Shqiperine n' até paqe?

2. Cili ish, prej kujt perbchej dhe per ç' punc u-mbloth Kongresi i Berlinit?—Ç' vendosi ky Kongres?—Persé nuk i mori ne sy te drejtat e Shqiperisc ky Kongres?—Ç' gjc beri Kongresi q' i ndezi Shqiptaret?—Ç' vendo u dhá fqinjeve te Shqiperisc?

3. Ç' benc Shqiptaret ahere?—Cila ish, si dhe per ç' qellim u-formua Liga e Prisrenit?—Shpjegoni hollesisht rendesin' e kesaj Lige per Shqiperinc?—Sa qendra e ku kish Liga?—Cilet ishin kryetaret e parc te saj?—Persé Turqia s' e ndaloj ne krye keté levizje shqiptare?

4. Shpjegoni hollesisht se ç' beri Liga per mprojtjen e Shqiperisc. Persé u-bashkua me trupat malazisse Muhtár Pasha?—Ç' beri Evropa ahere?—Shpjegoni ngjarjet e Ulqinit?

5. Shpjegoni hollesisht se ç' neshtypje benc ner pópullin shqiptar keto ngjarje?—Ç' frymc mori mé ne funt Liga?—Ç' kerkonte te bente?—Ç' do te thote fjala autonomi?—Persé u-dergua Dervish Pasha ne Shqiperi?—Si u-mbyt kryengritja?—

6. A u-mbyt levizja kombetare me te shójturit e kryengritjes? Ç' gjc i dha shtytje te madhe zgjimit te ndjénjave kombetare?—Qysh nisi te perparonje mesimi?—Cilet njerza ishin qe botuan abetaren e parc shqipe dhe ne ç' vit?—Ku u-hap shkolla e parc shqipe?—

7. Cilet ishin ata q' e kundershtuan keté perparim te Shqiperisc dhe persé?—Ç' beri Sulltani dhe Patriku?—Ç' benc Shqiptaret ahere?—Cila ish udha mé e shigurte per te fitnar lirin' e Shqiperisc?—Ç' kuptohet me fjalet "rilindja e kombit shqiptar?"

KËNDIME

SHKRIMI I GJUHËS SHQIPE—Ne disá historira te vjetra thuhet qe gjuha shqipe perdorej ne shkrim qe ne kohet e mbreterisc t' Ilirisc e te Mollosisc, po per fat te keq gjer sot s' ka dale ne drite

nonjé shkrim i atille, e duket qe ató shkrime do te jene prishur ne koben e shkeljeve barbare, a kush e di se si dhe kur.

Librat mé të vjetra qe kemi sot janë shkrojtur dhe janë shtypur ne krye te shékullit 17, dhe mé e para nga ató eshte nje libre fetare prej *Pjeter Budes*, shtypur me 1621, dhe pastáj vjen FJALË-TORJA LATINE-SHQIPE e *Imzót Preng Bardhit*, e cila dolli ne drite me 1685, ne gjuhe shqipe dhe italishte.

Me 1770, *Theodor Kavalioti*, nga Elbasani botoj nje fjalctore me kater gjuhe: shqip, latinisht, greqisht dhe vellahisht. Kavalioti ka perdorur nje abecé fare te ndryshme nga te tjerct, per te cilen besohet q' eshte abeceja e vjeter iliriane. Deshira mé e madhe e kétij burri te çquar ish qe te hapet nje shtypeshkronje shqiptare dhe me anen e saj te perhapte libra shqip.

Me 1844, *Naum Vegilarxhi*, nga Vithkuqi, botoj nje abetare te ré te gjuhes shqipe dhe me até mundohej qe te perhapte mesimin ne gjuhen e vendit, po ra i semure e dyké hyre ne hospitalin grek te Stambollit per sherim, u-helmua prej Grékeve.

E vétema pjese e pópullit shqiptar qe ka patur pothua se gjithenjé qe te shkrúante e te perdorte gjuhen shqipe per mesime kane qene Katolikct e Shqiperise se siperme, dhe prifteria e tyre kane qene mesonjes te pópullit ne gjuhen amtare. Po, kétá prifter nuke shkrúanin neca libra te tjera

veç fetare e kështú s' i dhanc nonjé ndihmc mcsimit tc pergjithcshmc tc pópullit shqiptar.

II. KUSHTUTA TURKE

1. Mbretcrimi i Sulltan Abdul Hamitit II

Sikunder thamc mé siper, Sulltan Abdul Hamiti II ka qcnc njc nga mbréterit mé tc liq qc ka patur Turqia. Nenć qeverimin e tij tc dobet, perandoria turke erdhi nc buzcn e varrit. Abdul Hamiti ish njc njerí qc mundohej vetcm per njc gjc: si e si tc rronte mé mirc, dhe dreqi mount t'a merte mbreterin' e tij. Zyrtarct dhe ncpúnesit e tij vithnin e rripnin pópullin vetcm e vetcm qc tc rronin mirc atá edhé Sulltani i tyre. Drejtesia ish e vdekur nc tcrc Turqinc, dhe kanunet s' kishin asnjé fuqí. Qeveria e Sulltanit, nc vent qc tc perkujdesej qysh t'i bcnte nonjé tc mirc pópullit, siç cshtc detyra e çdo qeverie, ajo perkúndrazi loste nc kurris tc pópullit. Me njc fjalc, nenć mbretcrimin e Sulltan Hamitit, Turqia ish bcrc mé tepcr se kurdohcrc njc Shtet barbar, ku jeta, malli dhe nderi i njeriut s' kish asnjé shiguri. Sa per lirí, asáj s' i dcgjohej emrí nc tcrc Turqinc, se sikur tc kuxonte nonjé njerí vetcm e vetcm qc tc thosh me gojcn e tij fjalcn "lirí" dergohej me njc hcrc nc burg osé n' arratí, osé mé lehtc vritej fabéburasi.

Qendrimi i Abdul Hamitit kundrejt Shqiptárcve ish qc ndiqte pa mcshirc çdo Shqiptar qc kuxonte e tc hapte gojcn per tc kerknar nonjé tc

drejtë për vendin e tij. Nga ana tjetër, Sulltani ndiste fanatizmin e pópullit të paditur, dhe u pagúante roga të medhá e të majme gjith' atyre që bëheshin vegla të tij.

Kjo gjendje kaqe e dobët e Turqisë po hiqte dita me diten verejtjen e Evropës, e cila nisí të mejtohej që Turqia e kalbur binte ére si kërmë dhe që do t' ish mé mirë sikur të varrosej që të mos qelpte botën. Me këtó fjalë kuptohej q' Evropa po i mbushej mendja që t'a coptonte Turqinë, dykë marë sicili nga Shtetet e Evropës e të Ballkanit nga një copë.

Mé në fund, më 1908, zunë të bëheshin pregatitje n' Evropë për coptimin e Turqisë. Këtó pregatitje u rranë fort rendë disá njérësve të cilët kishin disá kohë që po shëkonin më frikë e me tmer ndhën e keqe që kish marë Turqia nenć mbretërimin e Sulltan Hamitit. Këtá njerës ishin mé të-për Turq q' i kish ndjekur si armiq Sulltani, dhe atá kishin dalë n' Evropë e atjé kishin formuar një Komitet të qúajtur "Bashkim e Perparim", dhe veten e tyre e qúanin "Turq të Rinj." Ky Komitét kish shumë kohë që bënte propagandë në Turqí për rrezimin e Abdul Hamitit, dhe kur u-duk më 1908 q' Evropa ish në pikën që t'a coptonte Turqinë, Turqit e Rinj e ngritnë ushtërinë turkë kundër Sulltanit.

Më 10 Korrik, 1908, Abdul Hamiti u-shtrëngua që të gjallte *Kushtuten e Perandorisë Turke*, dykë u-shtrenguar mé tepër prej Shqiptárëve të ci-

let u-bashkuan me Turqit e Rinj. *Kushtuta* permbleth njε sεrε urdhresh e kanunesh tε cilat janε mé tε larta se Sulltani dhe qeveria e tij. Me anεn e kεtyre úrdhreve e kanúneve u shiguróheshin popujve qε rronin nεné Turqinε njε tok tε drejta qε s' i kishin mé parε. Njε nga ató tε drejta ish qε pópulli i bashkuar do tε dεrgonte nε Stamboll njε numur pεrfaqεsonjεs qε do tε zgjithte aý vetε, lirísht e pa shtrengim, qε tε kontrollonin veprimin e qeverisε turke e tε Sulltanit, me fjalε tε tjera Sulltani e qeveria e tij nuk do tε ishin mé tε lirε qε tε punonin pas deshirεs sε tyre, se pasketáj qeverimi i tyre duhej tε pεlqehej edhé prej pεrfaqεsónjεsve tε pópullit. Trupi i bashkuar i kεtyre pεrfaqεsónjεsve quhej *Parllament*. Parllamenti ish i ndarε mε dysh, q' ashtú tε kontrollohej mé mirε puna e qeverisε. Njεra copε quhej *Dhomε e Deputáteve*, dhe pεrbεhej prej pεrfaqεsónjεsve tε zgjedhur prej pópullit drejt pεr drejt, dhe tjetra quhej *Senat* dhe pεrbεhej prej njε númuri zyrtarεsh tε larter qε kishin dijε nga púnεrat e qeverisε. Taní pra, qε tε bεntε gjε Sulltani duhej tε pεlqehej mé parε prej Dhomεs sε Deputáteve e prej Senatit, kεshtú qε Sulltani i kish duart tε lidhura e s' munt tε merrte nεpεr kεmbε tε drejtat e pópullit.

Kjo ish kushtuta Turke. Qεllimi i ępalljes sε saj ish qε tε mεsonte Evropa qε Turqia do tε hynte pasketáj nε njε udhε tε ré e do tε qeverisej pas sistemit evropián, kεshtú qε s' mbetej mé nonjé shkak pεr coptimin e saj. Me fjalε tε tjera Turqit e

Rinj deshin t' i frynin jetë të ré asáj kerme që qelbej, të paken per syt' e botes.

2. Shqiptarët e Turqit e Rinj

Në të gjitha perpjekjet e tyre, Turqit e Rinj kishin Shqiptarët për dore të djathtë, dhe, kur në Mars 1909, Sulltan Hamiti u-mat që të rrëzonte kushtuten e t' i çporrte Turqit e Rinj, perseri dúall Shqiptaret hynë në Stamboll, dërmuan ushterin' e Sulltanit prapanik, i eili tani u-zbrit fare nga froni dhe në vënt të tij u-vu një plak i rëgjuar dhe i dobesuar nga e pira, në trup e në mendje, Sulltan *Mehmet Reshati V*.

Po persé Shqiptaret u-bashkuan me Turqit e Rinj? Përgjigja eshtë e lehtë: se po të coptohej Turqia n' até kohë, edhé Shqipëria do të gjendej në rrezik të math nga që nukë kish nonjé Shtet të math të jashtme që t'a mpronte, kursé të gjithë Shtetet e tjerë të Ballkanit kishin mprojtës të forte: Sllavet kishin Rusinë, dhe Grekët Francën e Inglinë.

Nga ana tjatër, çpallja e kushtutes turke pritej që t' i hapte Shqipërisë udhën mé të shígurtë të përparimit. Gjer n' até kohë, Shqiptarët kishin fituar vendin e parë në Turqi me zotësin' e tyre. Qeveritarë, të medhenj e të vegjel, kishin qëverisur Turqinë për shumë kohë; oficerë të ushtërisë e të flotës kishin kumanduar kohë më kohë forcat ushtëriake të Turqisë; diplomatë dhe ambasadorë shqiptarë e

kishin nderuar Turqinc me punen e tyre nc vende tc huaj, keshtú qc tani, me kushtuten, ish shpresc shumc e madhe qc Shqiptaret tc lonin rollin mé tc math nc Turqi, dyqé qenc se me anen e mesimit, i cili do t' ish i lirc pasketáj, Shqiptaret do tc tregóbeshin edhé mé tc zotrit se mé pare. Ketó s' ishin endera po ishin gjcra tc verteta qc munt t' i zinte me dorc aý qc s' besonte nc vertetesin' e tyre.

Dhe me tc vertet, me çpalljen e kushtutes turke, nisi njc kohc e ré mesimi dhe arcsimi per Shqiperinc. Gazeta dhe libra shqip zunc tc botóheshin nc çdo vent, shkolla shqip n-hapnc, dhe njc deshirc e madhe per perparim n-ngjall ner Shqiptaret, keshtú qc dita e lirisc sc plottc, nga ana tjetcr, s' ish e larkme.

Po nukc shkoj shumc kohc kur n-vertetua qc qellimet e Turqve tc rinj ishin mé tc démeshmc se ató tc Sulltan Hamitit. Turqit e Rinj e çpallnc kushtuten vetem per syt' e botes, dhe, nga ana tjeter, nisnc qc t' a qeverisnin Turqinc persecrí pas sistemit tc Hamitit. Nc vent qc t' a linin pópullin tc zgjithte lirisht perfaqesónjesit e tij per nc Parllament, Turqit e Rinj emcronin disá nga shokct e tyre, osé vegla tc tyre, e i dergonin nc Stamboll sikursé t' i kish zgjedhur pópulli me tc vertete! Pastáj, nisnc tc merrnin nepcr kembc tc drejtat e popujve tc ndryshmc. Deshin tc mbyllin shkollat shqipe, po dyké pare deshiren e pópullit per mesim nc gjuhcn e vetc, i ranc pas mendjes sc çuditeshme qc tc ndronin shkronjat shqipe e nc vent tc tyre tc vinin

shkronja turqishte! Gjith' ashtú, nisnc tc futin spica per tc perçarc Shqiptaret nc tc Krishterc e Mohamedanc. Mé nc funt, vendosnc, si pa gjc tc keqe, qc tc *turqezonin* tc gjitha racat jo-turke tc Ballkanit, domethenc t' i benin Turq qc tc gjithe, dhe me qc raca mé e forte jo-turke ishin Shqiptaret, Turqit e Rinj vendosnc qc tc ziheshin per-sc mbari nga puna dyké turqezuar Shqiptaret.

Disá faqe mé siper thamc se nc Shqiperi kishin mbetur, qc nc kohen e pushtimit turk, dy vende tc eilet gezonin njc *gjysmc lirí*, Mirdita nc Gegcrí, dhe Himara nc Toskerí. Turqit e Rinj deshin, pra, qc t' ua merrnin ktyre vendeve edhé até gjysmc-lirí qc kishin ruajtur me aqe mundimse nc tere kohen e shkuar nené Turqinc. Gjith' ashtú u-kujtuan qc t'a mposhtnin krejt tere Shqiperinc e t'a benin njc krahinc thjesht turke. Dhe per t' arrijtur ketó qellime u duhej mé pare qc t'u merrnin armet Shqiptareve.

3. Kryengritjet e 1910cs dhe 1912cs

Ketó mendime tc Turqve tc Rinj çqetesuan teper Shqiptaret, tc eilet shekonin tani se jeta e Shqiperisc, si kombesí e veçante, ish nc rezik. Mbledhje tc medhá u-benc me njc herc prej kryetárcve Shqiptarc dhe u-vendos qc njc kundreshtím i rrepte t' u bchej Turqve tc Rinj, tc eilet, pa marrc nc sy gjendjen e rezikeshme tc Turqisc, nisnc me 1910 *Shefket Turgut* Pashen me njc ushterí

të madhe që të shtronte Shqipërinë në kembet e tyre, dykë çarmatosur Shqiptarët.

Shefket Turguti hyri në Shqipëri dhe u-përpoq me Shqiptarët në grykat e *Kaçanikut*, Kosove. Shqiptarët qëndruan me trimëri të madhe, po u-duk që s' munt t'a ndërrnin kundreshtimin e tyre në krye me një ushtërí aqë të fortë sa kish Shefket Turgut Pasha. Pas shumë betejash të rrepta, kundreshtimi i tyre u-ep, dhe Shefket Turguti e shkeli Shqipërinë ku u-suall me barbarinë më të madhe. Vrau, preu, rrahu pa meshirë, e me këtë mënyrë mundi të mbledhë armët e Shqipërisë së sipërme.

Tani Shqipëria dukej sikur ish shtruar, dhe Turqit e Rinj po ferkonin duart me kënaqësí. Po ódhe s' kish ikur mirë Shefket Turguti nga Shqipëria, kur Shqiptarët u-ngritnë përsëri në prendverë të vitit 1912, e këtë radhë u-ngritnë me qëllím të njëshmë që t' a çkëputnin Shqipërinë nga Turqia. Qeveria turke dërgoj *Xhavit Pashën* me një ushtërí tjetër, po Shqiptarët e vunë përpara ushtërinë turke, pushtuan Shkupin dhe po i afróheshin Monastirit. Edhé Shqipëria e poshtme u-ngrit tani në këmbë, dhë nga të gjith' anët degjohej fjala "lirí."

Fitimet e Shqiptárëve e trondítnë Turqinë, qëveria e së cilës shpejtoj që të bënte paqe me kryengrítësit. Paqa u-bë me këtó kondita të shënúara:

1. Shqipëria fitonte *autonominë* e saj. Qeveritarët dhe zyrtarët e lartë do t' ishin Shqiptarë pas kanúneve dhe zakóneve të vendit.

2. Të katër vilajetet, *Shkodra, Monastiri, Ja-*

sinë dhe *Kosovë*, do të përbënin Shqipërinë autonome.

3. Shqiptarët do të shërbenin si ushtarë vetëm në vendin e tyre, përveç në kohë lufte.

4. Mesimi do t' ish këtëj e tutje i lirë dhe do të bëhej në gjuhën shqipe.

Kjó autonomi s' ish lirí e plotë, po hëpërhë ish gjëja mé e mirë për Shqipërinë, së ëilës iu hap kështú udha për një jetë kombëtare.

4. Lufta ballkanike e çpallja e Lirisë

Shtetëve të Ballkanit u-mbet në grykë e s' ish e mundur që t' i gëlltitnin fitimet e Shqiptárëve, së atá u-trëmpnë që në krye kur panë që po themëlohej një Shqipërí e madhe me kater vilajetet, në të cilat u-kishin mbetur syte që prej shumë kohë.

Vrapuan, pra, të mërrëshin vesh në mes të tyre, dhe, në Gusht, 1912, formuan *Aliáncën* (osé beselidhjen) *Ballkanike*, në të cilën hyrí Serbia Bullgaria, Mal i Zí dhe Greqia. Qëllimi i tyre ish që, me njëren anë, t'a goditnin sa kaqe Turqinë e trondítur nga lufta që kish bërë me Shqiptarët përpara se të përkëmbej përsërí, dhe, me tjetrën anë, të mos e linin Shqipërinë të forcohej si një Shtet autonóm.

Në mes të mújajit të Tetorit, 1912, Shtetet Ballkanike i çpallnë luftë Turqisë. Ushtëria turke, e papregatitur mirë dhe me plagët e hápura nga armët e Shqiptárëve, u-munt e u-dërmua më të gjithë

anet, dhe trupat ballkanike shkelne pothua tere Turqin' e Evropes, dyké hyre edhé ne tokat shqiptare.

Ketó ngjarje i sóalle Shqiperise ni krye rezikun mé te math, sikunder shihet vet-vetiu.

Nga ana tjeter, kjo ish dhe nje rasje e mire qe te fitonte Shqiperia lirin' e saj te plotte.

Me 28 Nentór, 1912, pra, u-ngrit flámuri i Shqiperise, flámuri i Skenderbeut te math, ne Vlore, dhe Shqiperia u-be me vete.

Ne múajin e Dhjetorit, u-mbloth ne Londre nje Kongres tjeter, si aý i Berlinit, *Konferenca e Londres*, siq u-quajt, dhe me 20 t' atij múaji e njojti Shqiperine si nje shtet te lire e te pavarrur nga Turqia e nga gdo Shtet tjeter.

Q' até dite filloj jeta e Shqiperise se lire, e cila nisi te qeverisej prej nje Qeverie Shqiptare q' ish nené kryesin' e *Ismail Qemal Bej Vlores*, i cili ish shkakturi i ngritjes se flámurit. Po per fat te keq, Shqiperia, dyké fituar lirin' e saj, humbi afró gjysmen e tokes se saj qe mbet ne duart e Serbeve, Malzíasve dhe Grékeve. Ketó toka presin qe mema e tyre, Shqiperia, t' i lironje me besnikerine dhe trimerin' e bijve te saj.

Qeveria e Ismail Qemal Beut, e cila u-quajt e *Perkóhezhme osé e Pertanishme*, ish vetem per pak kohe, dhe vendin e saj e zuri qeveria e perfuntme mbretnore.

PËRMBLEDHJE

(Te mesohet me goje)

1. Me qeverimin e tij te keq, Sulltan Abdul Hamiti II e solli Turqine ne buze te varrit, dhe Evropa po pregatitej qe t' a coptonte perandorine turke, kur dualle Turqit e Rinj qe t' a shpetonin dyke shtrenguar, me ndihmen e Shqiptareve, Sulltanin qe te çpallte *kushtuten*. (1908). Kushtuta eshte kanuni me i larter se mbreti vete, i cili vihet nene kontrollin e perafqesonjesve te pópullit qe perbejne *Parllamentin*.

2. Shqiptaret u-bashkuan me Turqit e Rinj, se kushtuta i hapte Shqiperise udhen e perparimit e te shvillimit kombetar, dhe se ish shprese, qe edhe sikur te mos çkeputej Shqiperia me nje here nga Turqia, te fitonte vendin e pare ne perandorine turke.

3. Me çpalljen e kushtutes, nisi me te vertet nje kohe perparimi per Shqiperine me ane te lirise se mesimit, po nuke shkoj shume kohe kur Turqit e Rinj nisne te silleshin me keq se Abdul Hamiti dhe vune nerment qe te tuqezonin gjithe racat e Turqise, dyke nisur nga Shqiptaret.

4. Per te vene ne veprim qellimet e tyre, Turqit e Rinj nisne per ne Shqiperi Shefket Turgut Pashen i cili me barbari te madhe mundi te çarmatoste Shqiperin' e siperme me 1910, po pak me von Shqiptaret ungritne perseri dhe e vune perpara ushterine turke. Turqia u-shtrengua qe te bente paqe dyke njojtur *autonomin'* e *Shqiperise* me kater vilajete: Shkodre, Manastir, Kosove, Janine.

5. Po keto fitime te Shqipetareve frikesuan fort kombet e tjere te Ballkanit, te cilet formuan *Aliancen* Ballkanike ne Gusht 1912, pak muaj vetem pas fitimit te Shqiptareve, per te goditur Turqin' e shojtur nga lufta me Shqiptaret, dhe per te ndaluar perparimin e Shqiperise si kombesi.

6. Ushteria turke u-munt ne te gjith' anet, dhe trupat ballkanike shkele tokat e saj dyke hyre edhe ne Shqiperi, e cila çpalli tani lirin' e saj te plotte, me 28 Nentór, dhe u-be me vete. *Konferenca e Londres* e njohu lirin' e Shqiperise me 20 te Dhjetorit.

PYETJE PËR STËRVITJE

1. Përshkruani me pak fjalë, sibtu siç e kuptoni juve, mbretërimin e Abdul Hamitit II, dyke pyetur prindërit tuaj përmi mënyrën e qeverimit të këtij Sulltani.—Shpiegoni hollësisht se ç' ishin shkaket që Evropa desh t' a coptonte Turqinë.—A do të fitonte gjë Shqipëria me coptimin e Turqisë e përsé?—Shpjegoni me pak fjalë ç' ishte *Kushtuta*, *Parllamenti* dhe *Senati*?—Mbani mënt se cili Shtet i vjetër kish *Senat*?

2. Përse Turqit e Rinj i kundrështoheshin Sulltan Hamitit?—Shpiegoni se qyh mejtonin Turqit e Rinj që t' a shpëtonin Turqinë dyke çpallur kushtuten?—Përshkruani me fjalët tuaja fitimet që do të kish Shqipëria nga kushtuta turke?—Ç' ngjau në Mars 1909?—Kush e shpëtoj kushtuten?—Shpiegoni arsyet e zihjes në mes të Shqiptarëve e të Turqve të Rinj?—Cili ish qëllimi i vërtetë i Turqve të Rinj dhe ç' mënyra përdorë që të ndalonin përparimin e bashkimin e popullit shqiptar?

3. Përshkruani me fjalët tuaja ç' ngjau në 1910 e 1912?—Përshkruani një nga një të drejtat që fitoj Shqipëria më kryengritjen e 1912-ës?—Cila e drejtë padehni që kish rendësinë më të madhe e përse?

4. Shpiegoni hollësisht arsyet që shtynë popujt e Ballkanit të formonin Aliancën e të luftonin kundër Turqisë?—Cili ish rreziku i Shqipërisë nga fitimi i Shteteve të Ballkanit?—Ç' ngjau më 28 Nëntor, dhe 20 Dhjetor, 1912?—Ç' vendë humbi Shqipëria dyke fituar lirín' e saj?—Si munt t' i marrë prapë këto toka?

BKSH

FJALORTH

A

admiral,-i, kryekumandari i fllotes; oficeri mé i larter i detit.

Adrianopoje (Adrianople), Edirné, kryevendi i Thrakes.

Akaia (Ahaia), krahine e Morese.

akaik,-e, qe i perket akaise.

Akeron,-i lume i Çamerise, neper te cilin, pas besimit te Pellasgeve, shkonin shpirtrat e te vdékurve. Sot quhet *Bistrice* osé lum' i Butritntes.

akerusian,-e, qe i perket Akeronit. *Liqeni i Akerusise* eshte gjoli i Butrintos.

Akilé, nje trim i prallave te vjetra q' ikte shume ne te rendur. N' Epir quhej *Shpejt*.

Akarnani,-a, krahine e Greqise se veriut me

alianee,-a nje lidhje qe behet ne mes dy osé mé shume shtetesh qe te kryevent Mesollongjin. leftojne se bashku; thuhet edhé *beselidhje*.

ambasador,-i, njeriu qe dergohet prej nje qeverie te nje tjater qeverí.

amtare, qe perket nenen; *amtare*, quhet gjuha e nenes. Gjuha amtare e Shqiptarit eshte shqipja.

anetar,-i, aý qe mban ane ne nje çeshtje, njeriu i lidhur me nje shoqerí.

anesi,-a, tarafllek.

anie,-a gjemí.

anietar,-i, gjemixhi, aý qe merret me anie.

Apollonia, kolloni e vjeter greke n' Epir; *Bolena* e sotme e Kurveleshit.

aresim,-i, mesim, stervitje.

ar,-i, flori.

aresye,-a, mendim i drejte, fjale e drejte.

Argos, qytet i Morese, ku u-vra Pirrua.

arrati,-a, syrgjynllek.

arratis, benj syrgjyn.

arte,-i,-a, i florinjte.

artileri,-a, dega e ushterise qe merret me topat.

áte,-i, babá.

aterór, qe perket babane.

Athamane, fis i Epirit qe rronte ne viset e Konitzes.

August, titull i perandorit román.

autonomi,-a, te qeverisurit e nje vendi me vete, po nené hijen e nje mbreti te huaj.

Avare, popull barbar, i erdhur nga Asia qe shkeli Shqiperine.

B

Babylone,-a, qytet shume i vjeter, afer Bagdatit te sotme, ku vdiq Aleksandri i Math.

Ballkan,-i, vendi ku rrine Shqiptaret, Serbet, Bullgaret, Greket dhe Rumanet. Shtetet e ketyre kombeve quhen "Shtete te Ballkanit" me nje emer.

begati,-a, pasuri.

beselidhje,-a, lidhja e beses qe bejne dy osé me shume shtete qe te leftojne se bashku. Thuhet dhe "alianee."

besnik, njeri i beses; aý qe mbesón ne fene.

besnikeri,-a, te mbajturit e beses.

beteje,-a, perpjekje me arme ne mes dy ushterirash.

biblioteke,-a, vendi ku mbahen librat osé shume libra.

bishe,-a, bageti osé kafshe e eger.

Bizant,-i, qyteti i vjeter ne vendin e te cilit u-ngrit Kostantinopoja osé Stambolli.

bizantin, qe perket Bizantin.

bombardim,-i, te rráhurit me top q' i behet nje vendi.

buje,-a, nam.

bujár, njeri me nam te mire e te math.

bujqesi,-a, çifçillek.

bujk, çifçi.

burk, burgu, hapsane.

C

caktonj, i ve sinór nje gjeje.

cuktuar,-i,-e, i vene me sinór.

cilesi,-a, vetie e mire; fuqia qe ka nje njeri per te bere nje pune.

civil,-e, qe ka te benje me púnerat e nje qyteti osé te nje qeverie.

lufterat civile jane lufterat qe behen ne mes te nje kombi, fjala vjen kur leftón nje pjese e Shqiperise kunder tjetres.

çmuar,-i,-é, gje me kimét.

çonj, dergonj.

D

Dardhane, osé Dradhare, fis i Ilirise qe rronte ne viset e Kosoves se sotme.

Dasharet, fis i Epirit qe rronte ne krahinen e

Korçes, Prespes dhe Ohrise.
dhelperi,-a, djallezi si prej dhelpre.
dhurate,-a, peshqesh.
delegat,-i, njeriu qe dergohet per te mbaruar nje pune.
deshperim,-i, te humburit e shpreses, te humburit e hymyzit.
despotat,-i, principate me vete, ne kryen e se ciles eshte nje *despot* (kryezot). Fjala shqipe per Despotat eshte "kryezotní."
detár,-i, aý qe merret me detin osé me gjemí.
detyre,-a, çdo qe nje njerí eshte i shtrenguar t'a benje: borç.
detyruar,-i,-e, i borçlitur, i shtrenguar.
Dimitri, i quajtur i *Farit*, gjenerał ilirian.
dinák, njeriu qe dí shume, po diturin' e tij e perdor per liksht, shejtán i mallkuar.
dinakeri,-a, shejtanllek.
dipllomat,-i, osé diplomat, aý qe merret me dipllomatí.
dipllomati,-a, osé diplomatí, dega e qeverise qe merret me púnerat e jashtme; zotesí ne fjale.
dobet,-i,-e, zaíf, i pafuqishme, i lik.
dorezonj, jap ne dore.
Duke,-a, titull fisnikerie: *Duke* quhej edhé kryetari i Republikes Venetike.
dyshim,-i, shuphé.
dyshimte,-i, shuphellí.

E

Eak,-a, babaj i Pirros.
Eakido osé Eakaj, qúheshin djemt' e Eakut, nje nga te cilet ish Pirrua.
Egjypt, osé Egjipt, Misiri.
Egnatia, osé Aegitana, udha qe ndertuan Romanet qe ne Shqiperi gjer ne Bizant.
Epidamne, quhej Dúrresi ne kohet e vjetra kur ish kolloní greke.
Epir,-i, Toskerí osé Shqiperi e poshtme a e Jugea.
étje,-a, deshire per te pire nje.
expert,-i, osé ekspert, njerí i provuar ne nje pune te çquar.

F

fame,-a, nam i math, buje.
fámeshem,-i-e, qe ka te benje me fame, i degjuar.
fanatik, njerí i shtene pas fese verberisht.
Far,-i, nisí e Adriatikut te siperme, n' anedetin e Dalmatise.
fat,-i, kesmet.
fatthene,-a, gje e thene prej fatit; e shkruar prej kesmetit qe te ngjase.

fé,-a, bese, din, imán.
fedak, njerí i shtenc verberisht pas fese.
fetár, aý qe merret me besen; prift, hoxhe.
feudalism, (shekó faqe 76).
Filip,-i, i Maqedonise, i áti i Aleksandrit te Math.
fillim,-i, nisje, themelim.
filosof,-i, osé fillosof, njeriu qe merret me diturí.
fillosofi,-a, te márrunit me diturí.
finók, i holle nga mendja, kurnás.
fis,-i, soj prej nje gjaku.
fisník, prej fisi osé soji te mire.
fisme,-i,-e, fisník, prej fisi te mire.
fitimisht, me fitim te plotte.
filote,-a, osé flote, nje tok luftaniesh osé gjemirash te luftes.
Foenike, fshati Sopot i sotme, qytet i Epirit; kolloní greke ne kohet e vjetra.
formonj, perbenj, benj.
fortese,-a, vent i forte per lufte, kalá.
fqi,-ri, *komshí*.
fqinjesi,-a, komshillek.
fushate,-a, dalja e ushterise per te vajtur ne lufte; nje pjese e luftes ne nje vent te çquar.
fytyre,-a, surát; pamja e suratit te njeriut a te kafshes.

G

gabim,-i, lajthim, jangllesh.
gabohem, genjehem, benj jangllesh.
Gale-et, ndénjesit e pare te Frances e cila quhej ahere *Gali*.
galere,-a, gjemi-lufte, luftanie.
garde,-a, ruajtese, trupa ushteriake qe mpron nje vent osé qe rrí pas mbretit.
garde pretoriane, quhej garda qe rrinte pas perandorit te Romes.
gati, hazér.
gjenerál,-i, pashá, kumandár i ushterise.
gjépura, fjale te kotta, fjale bosh.
gjigant,-i, njeri me trup te math.
gjigantik,-e, qe ka te benje me gjigantne, osé gje e tmerruar dhe e madhe.
Granik, (Granikós), lum' i Asise se Vogel ku Aleksandri i Math mundi Persianet.
Goth, osé Gotth, fis Gjerman qe zuri Romen e hyri edhé ne Shqiperi.

H

helme,-a, ksula osé qylafi qe mbanin te vjetrit mi koke. Pirrua kish dy brire cjapi ne helmen e

tij, dhe Skenderbeu kish dy brire sorkadhe.
helmonj, farmakós.
Herakel,-i, perandori i Kostantinopojes.
hijeshem,-i,-e, i bukur, i embel ne te pamet.
historián, aý qe merret me histori, osé shkruan histori
hospital, spitale, semuretore.
hov,-i, sulme, yrysh, huxhum.
Hun,-et, popull i eger dhe gjakpires i erdhur nga Asia, i cili shkeli Shqiperine.
Hyll,-i, mbreti i pare i Ilirise.

I

idé,-a, mejtim.
ideal, mejtim osé deshire e kthjellte.
Imzot, titull q' i jepet nje peshkopi.
independence,-a, pavarrimi, veteqeverim i plotte.
interés,-i, fitim.
interesme,-e, gje qe heq verejtjen.
intrige,-a, djallezillek i fshehur.
intrigán,-i, njeriu qe merret me intriga.
Ionian, qe ka te benje me detin Ionian i cili eshte pjesa e poshtme e detit Adriatik. Nisite ioniane, jane Korfuzi, Kefalonia dhe nisit' e tjera qe jane ngjitur pas ketyre.
Ips,-i, (Ipsus), vent i Asise se Vogel ku leftuan ne mes te tyre gjeneralet e Aleksandrit te Math.
Iss (Issus),-i, vent i Asise se Vogel ku Aleksandri i Math mundi Persianet.
Itoni,-a, vent i Epirit te vjeter.

K

Kaone, fis i Epirit te vjeter qe rronte ne viset e Kurveleshit te sotme.
kanisk,-u, qé peshqesh dasme.
kanun,-i, nom.
kapedan,-i, osé kapetan, njeriu q' eshte i pari ne nje tok njeres: oficer i ushterise; njeriu qe ka nené urdherin e tij nje gjemi, anie.
Kapitol,-i, vendi ku kish qendren e saj qeveria romane.
kaptine,-a, nje nga coprat ne te cilat ndahet nje libre.
karaktér,-i, çfaqja e sjelljes se nje njeriu; lloji i sjelljes.
Karthagjene,-a, qytet i Afrikes, afer Tunuzit me te cilen leftuan Romanet.
katunt,-ndi, fshat.
keshille,-a, nasiet, mexhelis.

keshillonj, jap nasijete.
keshilltar,-i, njeriu qe jep keshille.
keshtjelle,-a, kalá e forte.
kleftai osé klefte, kusare dhe ieryengrites ne Toskeri dhe ne Greqí.
Kleit,-i, mbret i Ilirise.
kolloní,-a, vent i ndenjur me nje tok njeres qe jane ngritur nga vendi i tyre dhe kane zene nje vent te ri.
komitet,-i, shoqeri qe merret me politike.
kondite,-a, shart.
konference,-a, mbledhje e perbere prej diplomatesh qe te bisedojne qeshtje me rendesi qe perkasin Shtete e kombe.
kongres,-si, mbledhje, konference.
konsull,-uj, kryetarct e republikes se Romes; njeriu qe dergohet prej qeverie ne nje vent te huaj per te mprojtur interesat e saj tregetare.
kontrroll,-i, fuqia qe ka nje njeri osé nje qeveri qe te mos lere nje njeri osé nje poull te punojne pas qefit.
kotte,-i,-e, pune bosh.
kqyrje, veshtrim.
krahesör,-i, veshja e hekurt qe mbanin ushtaret e kóheve te vjetra per te mprojtur trupin e tyre.
krahine,-a, nje cope dhé; kazá.
Krete,-a, nisia e Gjiritit.
krejt, fare edhé fare.
kryegjeneral,-i, serasker.
kryeministor,-tri, sadrazém.
kryengjeshur, njeri qe ngul kembe ne nje gje dhe s' e ndryshón mendjen e tij.
kryeqytet,-i, qyteti i parc i nje vendi, qyteti ku qendrón qeveria e nje kombi.
kryetar,-á, aý q' eshte ne krye te nje toge njerezesh, osé ne krye te nje pópulli a qeverie.
kryevent,-ndi, qyteti ku qendrón qeveria e nje krahine.
kryezór,-i, zot mbi te tjere.
kryezotim, e drejta qe ka nje qeveri qe te njihet si kryezonje e nje qeverie tjeter, qe te jete permí krye te saj.
krhís,-i, mur shtepie; benj shtepí.
kuß,-ve, sinore.
kußonj, ve sinór.
kußome,-a, lipsan, xhenaxe; trup i vdekur.
kulm,-i, maja e majes.
kuroje,-a, garjet, trimeri.
kusór,-i, hajdút, vjedhes.
kusuri,-a, hajdutllek.
kushtón, kostón, kostis.
kushtrim,-i, zeri qe del per te mbledhur trimat osé ushtaret per luftc.

kushtute,-a, kanun themelór; kanuni esas, sintagma.
kuvent,-ndi, fjalet qe behen ne mes nje toga njérezesh per t' i dhene funt nje pune, mbledhje e madhe.

L

lajm,-i, habér.
lajmerim,-i, te berit a te dhenit habér.
lajmetár,-i, aý qe sjell habere.
Lakedemone,-a, krahine e Greqise me kryevent Sparten.
lavderuar,-i,e, plot me lavdi.
legjende,-a, pralle e pangjare.
legjión,-i, pjese e ushterise romane.
lehtesonj, benj kollaj.
letretyre,-a, dega e diturise qe merret me letrat, me shkrimin.
liberal,-i, njeri zemer-hapur dhe zemer-gjere; njeri dorehapur.
Liburne, fis i Ilirise qe ronte n' anedetin e Shkodres.
lige,-a, lidhja e beses per te leftuar.
Lindje,-a, quhen me nje emer viset e Ballkanit e t' Anadollit.
liqen,-i, gjoli.
Lombarde, fis gjermán qe shkeli Italine.
luán,-i, asllán.
luftanie,-a, gjemi e luftes.
lundre,a-, gjemi, varke.

M

madheshti,-a, shkelqimi i ati q' esht' i math, si mbreti; titull qe i jepet mbretit.
mareveshje,-a, lidhje e fjales per te mbaruar nje pune.
memorande,-a, shkrese me te cilen behet e njojtur nje çeshtje.
menyre,-a, tertip.
mergim,-i, kurbet.
mesjete,-a, kohet e mesme, qe me 476 gjer me 1453.
Messollonj,-i, qytet i Greqise, kryevent i Akarnanise.
metale, mademe.
mete,-e, noksanllek, pune eksiq.
miemer,-i, llagáp.
miemronj, jap llagáp.
minister,-stri, nje nga anetaret osé njérezit qe perbejne qeverine.
mishkrim,-i, nje gje qe shkruhet per mi nje gur, mur, osé dhurate.
mizor,-i, qe ka te benje me mizori.
mizori,-a, sjellje e eger dhe e pashpirtshme.
mode,-a, modhe.
Mollos,-i, themelónjesi i mbreterise se Mollosise.

Mollosi,-a, krahina e vjeter e Epirit qe zgjatej qe nga Gjinokastra gjer n' Arte.
mohonj, benj inqár.
moshe,-a, verse.
mungese,-a, noksanllék.
mrekull,-i, çudi, thagme.
mrékullshem,-i,-e, i çuditshem.
mjeshteri,-a, zanát.

N

natyre,-a, quhen te gjitha ató gjera qe kane te bejne me dhéne, Forca te natyres jane éra, uja, e. t. j.
ndalim-i, mbodhi.
ndalonj, vononj, pengonj.
nderkohe, n' até kohe e siper.
ndertese,-a, biná.
ndihmetár,-i, aý qe ndihmón.
ngastre,-a, nje cope dhé.
ngatrese,-a, trazire.
ngatronj, trazonj, nakatós.
nisiative,-a, nisja e nje pune.
njement, até kohe, taní.
njeshme,-i,-e, i bashkuar, i pandare.
Normane, popull i Skandinavise qe shkeli Shqiperine.
obór,-i, vendi i hapur perpara shtepise; pallati i nje mbreti.
oficer,-i, zabit.
ofiq,-i, zyre, rythé.
Olimpi,-a, e éma e Aleksandrit te Math.
organizate,-a, pune e organizuar.
organizim,-i, te venit e nje pune ne regull.
organizonj, ve nje pune n' udhe e ne rregull.
organizatór,-i, njeriu qe ve nje pune ne rregull.
origjinal,-e, gje qe del per te paren here dhe s' eshte kopiuar.
Osman, Sulltani i pare i Turqve, te cilet prandáj quhen Osmanllinj. Fren' i Osmanit eshte froni i mbreterise te Turqise.

P

paje,-a, prike; pasuria q'i jepet nje çupe kur martohet.
Pandosi,-a, qytet i Mollosise. Nje tjeter qytet me keté emer ish edhé n' Italí.
Pape-a, quhet patriku i Katolikeve, i cili eshte dhe peshkóp i Romes.
parade,-a, te shkúarit e ushterise neper rrugat e nje qyteti me rastin e nonjé kremtimi.
parti,-a, taráf, kome.
pasanik,-u, aý q' i vete pás nje tjetri.
penk,-ngu, rehén.
perandór,-i, perandori q' eshte ne krye te nje pe-

randorie.
perandori,-a, mbreterí e madhe.
Perendim,-i, nga perendón dielli; perendim quhet me nje fjale edhé pjesa e Evropes qe permbleth Italine, Austrine, Gjermanine, Francen, Ingline dhe Spanjen.
perfaqesonj, ze vendin e nje togu njeres.
perfitonj, fitonj nga nje ngjarje, s' e le rastin e mire te me ike nga dora.
perfundim,-i, fundi qe del nga nje pune.
pergjitherisht, nga te gjith' anet.
perindhe,-a, nje cope kohe.
perkas, q' esht' i asáj gjeje.
Persi,-a, vent i Asise me te cilin leftoj Aleksandri i Math.
peshkóp,-i, dhespót, kryeprift.
pjese,-a, osé pjese, nje cope.
pjesetár,-i, aý q' eshte nje cope i nje gjeje.
piellór, osé pjellór, gje qe pjell shume.
Pilur-i, fshat afer Korçes.
Pinne, mbret i Ilirise, i biri i Teutes.
plenk,-ngu, mall, mylk, çiflik.
pllan,-i, menyre per te vene ne veperim nje qellím.
plotesonj, mbush, e benj te plotte.
politik, qe ka te benje me púnerat e nje qeverie.
politike,-a, udha qe mban nje qeverí osé nje njerí.
pranonj, benj kabull.
prapanik, njerí qe s' do perparim.
pregatitje,-a, hazerlleke.
prind,-i, soj, farefis.
Princ,-i, bir mbreti, njerí qe ka shume dhéra nené qeverimin e tij.
principate,-a, vendi qe ka nené údherin e tij Princi.
propagande,-a, te perhápurit e mejtimit ner njeres te tjere.
protestonj, çfaq mes-pelqimin tim per nje pune.
prove,-a, çdo gje qe ndihmón per te provuar nje gje.
provonj, benj belí nje gje.
punik,-e, qe ka te benje me Karthagjenen. Lufterat punike jane lufterat ne mes te Romes dhe te Karthagjenes.
pushtet,-i, fuqí e madhe dhe e forte.

Q

qendre,-a, merqés.
qetesí,-a, rahatllek.
qetim,-i, rahatllek.
qintár,-i, oficer roman qe ish ne krye te nje togu prej njeqint ushtaresh: juzbash.
qytet,-i, kasabá.
qytetár,-i, kasaballí.

R

rasje,-a, *rast*.
regjimént,-i, trupe ushteriake prej afró dy mije njeres. Allaj.
regjuar, i bere prape si foshnje.
republike,-a, forma e qeverimit ku pópulli ka ne dore fuqine.
rezerve,-a, redif; pjesa e ushterise qe mbahet prapa vijave te betejes qe te perdoret kur eshte nevoja e madhe.
riforme,-a, forme e ré.
riformatór,-i, aý qe sjell riforma.
rilindje,-a, lindje e ré.
Romul,-i, aý qe kthisi Romen.

RR

rrebésh,-i, furtune e madhe kur fryn ére e forte bashke me shí osé me deboze.
rrem,-e, jallane, e genjeshterte.
rrepte,-i,-e, i ashper.
rriedhe osé rrjedhe, gje qe rrieth nga nje gje tjeter.
rroge, mehásh.

S

Sarakene, fis i Arabistanit.
Selchuke, fis turk i Turqestanit.
Senát,-i, pleqesí.
siperani,-a, fuqia mé e larter e nje Shteti osé qeverie.
sistém,-i, tertip, marifét.
skele,-a, limán ku çgarkojne aniet tregetare.
Sllave, osé Slave, quhen me nje emer Serbet, Maleziasit, Ruset, Pollonezet e disá kombe te tjere.
stergjysh,-i, babagjyshi i babagjýsheve.
sternip,-i, nip i niperve.
stervit, mesonj ne nje kohe te gjate.

SH

shekull,-i, nje cope kohe prej njeqint vjetsh.
shembell,-a, yrnék.
shembellén, i ngjet nje gjeje tjater.
shile,-a, vule, myhýr.
shkak,-u, sebép.
shkaketár, sebepçí.
shkaterim,-i, prishje e madhe.
shkelqyer,-i,-e, qe shkelqén osé ndrit si drita e diellit.
shkence,-a, dituri, mesim.
shkrese,-a, çdo gje e shkrojtur.
short,-i, fat, kesmét.
shpesh, shume here, dendur.
shperblim,-i, çpagim.
shpjegim,-i, çkoqitje.
shpjegonj, çkoqit.
shprese,-a, ymýs.

shtize,-a, shish.
shushit, mbyt, humbás.
shvillim,-i, çperdredhje, çmbeshtjellje, perparim.
shvillonj, çmbeshtjell, perparonj.

T

Tamerllán, osé Timur-Lenk, mbret i Turqestanit qe mundi Turqit.
Tarquin (Tarquinius), mbreti i funtme i Romes. Shqip kendohet: Tarkuín.
Taulante, ndénjesit e vjeter te krahines se Dúrresit dhe te Myzeqese.
teh,-u, ana e shpates qe pret.
tempull,-i, kishe osé faletore e perendive te vjetra.
text,-i, osé tekst, lenda qe permbleth nje libre.
thellim,-i, ére e ftohte.
therrór, aý qe ben veten kurbán.
therrorí,-a, kurbán.
Thesproti,-a, krahina e vjeter e Epirit qe permblithte anedetin e Çamerise.
Tit Flamini (Titus Flaminius), gjenerali román qe shtroj Shqiperine.
titull,-i, nje emer qe jepet per nderim.
tmer,-i, frike e madhe.
tmeruar,-i,-e, i frikshem, i datosur.
toke,-a, dhé, steré.
tragjik,-e, ngjarje e tmerruar.
tregeti,-a, tuxharllek.
tregetár,-i, tuxhár.
Tribun,-i, emeri i gjeneralit román.
trupe,-a, pjese osé cope e ushterise.
triumf,-i, fitim i plotte i nje lufte: nderi qe merte gjenerali román qe fitonte nje lufte.
triumfatór,-i, aý qe fitonte triumfin.
turme,-a, kallaballék.

U

ushterí,-a, askér.
ushteriák,-e, qe ka te benje me ushterí.
udheheqes,-i, aý qe shkon perpara, si dashi me kembore.
urrejtje,-a, armiqesi, hasmeri.

V

veshdonj, i bie pás nje pune.
vendós, i jap karár.
vendim,-i, karár.
vendiák,-e, qe ka te benje me nje vent te çquar.
ventdashes,-i, aý qe do vendin e tij.
veprim,-i, punim.
vere,-a, behár.
veshtire,-i,-e, gje e zorçme.

veshtiresi,-a, zorllck.
vyer,-i,e, me vlere, me kejmet.

Z

zakón,-i, adét.
zbete,-i,-e, i mverdhur ne surát.
zoterim,-i, te qenit si zot i nje gjeje.
zotesi,-a, te qenit i zoti per nje pune.
zyre,-a, memuriét, pune e qeverise osé e nje shoqerie; ndertesa ku punojne zyrtaret.
zyrtár,-i, memúr, aý qe ka te benje me zyra.

FUNT

BKSH

BKSH

BKSH

BKSH

BKSH

BKSH